



# STRATEGJIA KRIMINALISTIKE

**Dr. Ramo Masllesha**

SARAJEVË / PRISTINË 2006  
FSK/S - 16/06



## **1. POLITIKA E SIGURISË DHE STRATEGJIA E SIGURISË**

### **1.1. POLITIKA E SIGURISË**

Para elaborimit të kësaj çështjeje të rëndësishme, është e domosdoshme të përmenden premiset kryesore që kushtëzojnë formësimin e politikës së sigurisë. Në çdo shoqëri të organizuar vend qendror zë pushteti politik. Të gjitha format tjera të organizimit të pushtetit në kuadrin e nënsistemit të një shteti varen nga pushteti politik. Por, „fenomeni i politikës nuk e përfshin vetëm shtetin dhe as nuk përputhet ekskluzivisht me pushtetin politik nga aspektet e tij të brendshme dhe të jashtme. Duke përfshirë pushtetin, edhe si marrëdhënie edhe si strukturë, fenomeni politik përfshin edhe procesin kompleks të marrëdhënieve organike dhe të kundërshtive ndërmjet pushtetit dhe shoqërisë, si edhe të gjitha format spontane e të organizuara që dalin prej tij.“ (J. Gjorgjeviq, në parathënien e Zh. Mejno, 1960, f. 49). Është e njohur se qysh kur është vendosur pushteti dhe ligjet e ndryshme të shtetit ka ekzistuar frika e natyrshme nga arbitrariteti, nga përdorimi i paligjshëm e zgjerimi i autorizimeve dhe formave të ndryshme të paligjshmërisë me ndihmën e forcës politike. Kështu përpjekjet dhe lufta për kufizimin dhe lidhjen e pushtetit politik me ligjin, gjatë gjithë historisë, kanë qenë përcjellës i përhershëm në të gjitha periudhat e zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Së këndejmi është esenciale që në shoqërinë demokratike e civile politika të mos ketë ndikim direkt në strukturën e sigurisë në operacionalizimin gjegjësisht zbatimin e ligjeve, përveç në rastet kur në parlament nxirren ligjet mbi subjektet e sistemit të sigurisë. Në këtë mënyrë, ato fitojnë nga parlamenti legjitimitetin demokratik të aplikimit të pushtetit shtetëror, me qëllim të mbrojtjes së sigurisë së shoqërisë. Askush nuk ka të drejtë të ndikojë direkt si aktor politik dhe të pamundësojë veprimin e nevojshëm të organeve dhe shërbimeve të sigurisë, të cilat janë në funksion të ruajtjes së rendit e të sigurisë në bashkësi. Kjo do të çonte në defunksionalizimin e sistemit politik dhe organizatave të pushtetit shtetëror të sistemit stabil juridik e të sigurisë. Duke analizuar rolin dhe funksionin e sistemit të sigurisë në shoqëri, shtrohet çështja e neutralitetit përkatës politik, i cili duhet të vendoset në kornizat kushtetuese-juridike, gjegjësisht në kryerjen profesionale të detyrave të përcaktuara me ligj. Kusht themelor për këtë është formësimi dhe zbatimi i politikës optimale të sigurisë.

Kemi thënë se politika, në kuptimin e gjerë të fjalës, nënkupton orientimin e veprimtarisë njerëzore në drejtim të caktuar me qëllim të realizimit të objektivave të caktuara. Politika e bën orientimin e shoqërisë me ndihmën e pushtetit shtetëror. Gjithashtu, shumë shpesh mund të dëgjohet se politika është arti i qeverisjes. Në

qoftë se qëndron kjo, atëherë edhe politika e sigurisë implikon nevojën që në mënyrë konsistente, duke u bazuar në rezultatet e hulumtimeve të shkencës së sigurisë dhe të disiplinave të tjera shkencore të sigurisë, të formësohen përmbajtjet globale që duhet të realizohen nëpërmjet subjekteve që përbëjnë sistemin e sigurisë së shoqërisë. Në këtë ndikojnë një sërë faktorësh relevantë definues, pa të cilët nuk është e mundur të realizohen veprimtaritë konkrete që rezultojnë me situatë të mirë të sigurisë nacionale.

Është e rëndësishme të theksohet se çdo shtet i organizuar formëson dhe zhvillon një sërë politikash, si: ekonomike, të jashtme, të mbrojtjes, sociale, shëndetësore, ekologjike, energjetike, kulturore, arsimore etj. Të gjitha këto politika kanë ndikimin e tyre përkatës në gjendjen e sigurisë. Për këtë arsye, ato përbëjnë politikën e sigurisë në nivelin global. Por, edhe politika e sigurisë duhet të përshtatet me nivelin e sfidave dhe kërkesave të civilizimit bashkëkohor. Disa autorë e definojnë politikën e sigurisë si veprimtari për përgatitjen e sigurisë përballë burimeve të ardhshme të rrezikut në natyrë, shoqëri dhe ndërmjet shoqërive. Po ashtu, thuhet se ajo përbën tërësinë e të gjitha masave, veprimtarive, veprimeve të destinuara për vendosjen dhe veprimin e sistemit të sigurisë nacionale. Në kuptimin e ngushtë të fjalës, objektivi i “politikës së sigurisë është krijimi i konceptit të mekanizmave dhe mjeteve me të cilat sigurohen siguria e brendshme dhe e jashtme e shoqërisë dhe paraqet konkretizimin e parimeve politike, organizativo-teknike e të tjera, në kuptimin e gjerë të fjalës”. (A. Grizold, botimi i ri, f. 33). Sipas Rezolutës mbi bazat e politikës së sigurisë nacionale të Republikës së Sllovenisë, politika nacionale e sigurisë është “tërësi e përcaktimeve, aktiviteteve dhe përpjekjeve politike, ekonomike, sociale, juridike, mbrojtëse, të sigurisë etj., nëpërmjet të cilave sigurohet shkallë sa më e lartë e sigurisë nacionale.” (A. Anxhiq, botimi i ri, f. 38). Këtu shihet qartë se shteti, në kuptimin institucional, gjendet në qendër të vëzhgimit.

Lëkundjet e mëdha në marrëdhëniet midis shteteve dhe organizimet transnacionale gjithnjë e më të pranishme në hapësira të ndryshme, konfliktet ndërkombëtare si edhe vështirësitë e mëdha në parandalimin dhe menaxhimin e krizave të ndryshme, kërkojnë nga organet përkatëse të sigurisë që, në bazë të objektivave të sigurisë globale, të ndërmarrin masat dhe aktivitetet më efikase, të cilat përdoren në mënyrë të tërësishme e të gërshetuar luftojnë kërkesat dhe interesat individuale, grupe e të tjera dhe vihen në shërbim të aktiviteteve të përbashkëta që kanë rëndësi vendimtare për sigurinë nacionale. Në rrethana komplekse politike e të tjera, politika e sigurisë duhet të shprehë aktualitetin e vet. Pra, ajo duhet t'i kuptojë problemet e realitetit shoqëror bashkëkohor. Nëse nuk është në gjendje ta bëjë këtë, ajo do të jetë një improvizim që mund të ketë për pasojë rrënimin e sistemit të sigurisë. Tashmë e

dimë se problemi i realitetit bashkëkohor, rrjedhat globale dhe sfidat transnacionale implikojnë një sërë faktorësh që mund të shkaktojnë jostabilitet dhe konflikte me pasoja eventuale shumë të rënda. Së këndejmi shtrohet pyetja esenciale: si t'u përgjigjemi me politikë të sigurisë të gjitha këtyre sfidave që janë gjithnjë e më komplekse, më të rrezikshme etj.? Në sigurinë nacionale reflektohen veçanërisht sfidat në planin global. Kjo kërkon një qasje shumë serioze dhe të përgjegjshme të shoqërisë në krijimin e politikës së sigurisë, e cila duhet të operacionalizohet nëpërmjet organeve dhe institucioneve përkatëse. Me veprimtarinë e tyre të tërësishme ato duhet të sigurojnë dominimin e tendencave konstruktive ndaj tendencave destruktive në zhvillimin e shoqërisë. Mirëpo, të gjitha këto aktivitete varen nga faktori njeri, kështu që „është e pamundur të thuhet diçka me mend mbi drejtimin dhe të mos flitet mbi sjelljen politike të njeriut... objektivat, ndjenjat, besimet dhe vlerat e tij”. (Eulau H., 1963, f.3).

Siç duket, politika e sigurisë është në varësi me të gjitha aspektet e aktiviteteve të njeriut. Natyrisht, aftësia e tij, e cila përfshin të gjitha sferat e jetës shoqërore, vështirëson formësimin dhe zbatimin efikas të politikës së sigurisë. Arsyet për këtë qëndrojnë edhe në rrezikun e madh që vjen nga arritjet teknologjike. Për këtë arsye nuk mund të favorizohet një segment i veçantë, por, në bazë të studimeve shkencore interdisiplinare mbi burimet e rrezikut, duhet të analizohet, sistemohet dhe hartohet politika e sigurisë që do të shërbejë si udhërrëfim për sqarimin e problemeve të sigurisë. Vetëm disa shenja dhe kuptime të politikës së sigurisë flasin mjaft për ndikimin e saj në funksionimin e fushave të tjera të bashkësisë shoqërore. Shtrirja e saj në marrëdhënie të ndryshme shoqërore dëshmon se me çfarë përgjegjësie duhet t'i qasen subjektet e sistemit të sigurisë formësimi dhe zbatimi të masave të sigurisë, të ndërmarra me neutralitetin e nevojshëm politik, të cilave duhet të jenë në kornizat e lejuara me kushtetutë. Natyra, intensiteti dhe shumëllojshmëria e kundërshtive në shoqëri kushtëzojnë dhe orientojnë domosdoshmërisht edhe konceptin e organizimit të politikës së sigurisë, mjeteve dhe mekanizmat e veprimit. Kështu, politika e sigurisë siguron dhe orienton veprimet e përshtatshme operative të një sërë subjektsh të sistemit të sigurisë, me qëllim të sqarimit të çështjeve më të pranishme. Në këtë mënyrë sigurohet dominimi i masave të sigurisë ndaj të gjitha sfidave që e shoqërojnë zhvillimin e shoqërisë bashkëkohore. Në këtë mënyrë ajo, në thelb, përbën pjesën integrale shoqërore të aktiviteteve të gjithmbarshme shoqërore që zhvillohen në një shtet. Për të qenë politikë përkatëse e sigurisë, ajo duhet të bazohet në bazë të kornizës shoqërore-politike, vlerësimeve të sigurisë, vlerësimeve të rrezikshmërisë dhe, sidomos, në bazë të rezultateve të hulumtimeve nga fusha e sigurisë dhe njohurive të nxjerra nga përvoja, me krijimin e kushteve të nevojshme materiale, teknike e të tjera për zhvillimin e shkencës mbi sigurinë, duke respektuar edhe njohuritë e disiplinave të tjera shkencore. Në këtë kontekst është e

domosdoshme të krijohet hapësira politike autonome për veprimin e institucioneve përkatëse. Vetëm një politikë demokratike e sigurisë, e cila është e çliruar nga presionet e ndryshme dhe është e operacionalizuar në mënyrë profesionale, mund t'u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të ndryshme të shoqërisë civile. Vetëm kështu mund të hartohet koncepti global i nevojshëm, i zbatueshëm nëpërmjet aktiviteteve operative e të tjera, i cili krijon parakushte për afirmimin e të gjitha aspekteve të zhvillimit të shoqërisë civile. Ky koncept krijon kushte për sigurinë e nevojshme në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Politika efiçase e sigurisë mund të jetë e suksesshme vetëm në qoftë se ajo është e bazuar në njohuritë shkencore. Kjo është bazë për formësimin e kornizave të filozofisë së saj dhe shërben si pikënisje themelore globale për përcaktimin e qartë të obligimeve të të gjitha nënsistemeve në shoqëri, kur bëhet fjalë për një fushë të caktuar (ekonomike, sociale, ekologjike, politike, etj.) Mbështetjen e qytetarëve e ka vetëm një politikë imanente e sigurisë, e hartuar në hapësirë demokratike të sigurisë dhe me të gjitha referencat relevante të karakterit shkencor e profesional, e cila i jep shans të gjitha subjekteve të sistemit të sigurisë që të mbrojnë vlerat fundamentale të shoqërisë. Asnjë sistem i sigurisë nuk mund të zbatohet e ta kryejë funksionin e saj në shoqëri, pa besimin e qytetarëve, për shkak se në shoqëri ka interesa të ndryshme dhe kundërshti që shkaktojnë një sërë komplikimesh. Kështu, politika demokratike e sigurisë fiton rëndësi të jashtëzakonshme shoqërore dhe përballon të gjitha sjelljet devijante në shoqëri, sidomos në procesin e organizimit të tërësishëm të shoqërisë në fusha të ndryshme.

Politika demokratike e sigurisë, përveç komponentës së sigurisë, e cila është komponentë themelore e saj, nëpërmjet aktualitetit të saj praktik, shërbimit të sigurisë dhe institucioneve të tjera, duhet të përcaktojë kornizën që përfshin ndërvarësinë e saj dinamike në ruajtjen e stabilitetit të rendit politik. Kjo tregon qartë vendim që ka politika e sigurisë në shoqëri. Gjatë formësimit të vizionit global në këtë fushë gjithnjë duhet pasur parasysh edhe faktorët e befasisë. Midis nevojave për realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe përpjekjeve për një stabilitet të siguri të lartë të shoqërisë demokratike ekziston një diskrepancë e madhe. Prandaj, është vështirë të gjendet një model për ruajtjen e baraspeshës. Kundërshtitë midis lirive dhe sigurisë mund të tejkalohen me sukses dhe të zbuten vetëm me një politikë konsistente të sigurisë. Një politikë e tillë duhet të vendosë në korelacion vlerat e individit dhe të shoqërisë. Këtu është e rëndësishme të kuptohet se në formësimin e politikës së sigurisë duhet të kihet ndjesia për gjetjen e zgjidhjeve më optimale, të cilat bazohen në realitetin ekzistues. Këtë e imponojnë sidomos sfidat që vijnë nga zhvillimi teknologjik. Dinamika e zhvillimit të teknologjisë shkakton paqartësi për të ardhmen, pra edhe pasiguri që shprehen në

aspekte të ndryshme, të cilat kërcënojnë civilizimin bashkëkohor. Vetëm perceptimi i orientimeve themelore të zhvillimit në të gjitha fushat dhe, në mënyrë analogjike, krijimi i mekanizmave të nevojshëm efikas në aspektin e sigurisë mund të garantojë një baraspeshë që është e domosdoshme për ekzistencën e shoqërisë dhe pjesëtarëve të saj.

Por, duhet të thuhet se proceset e ardhshme është shumë vështirë të parashikohen, sepse ato janë shumë të paparashikueshme. Ajo që është e mundur të bëhet është përcaktimi i orientimeve të përafërta, por vetëm në bazë të njohjes përmbajtjesore të realitetit shoqëror. Për këto arsye, koncepti i politikës së sigurisë duhet të hartohet vetëm në bazë të njohurive shkencore e profesionale të realitetit të sigurisë, prej të cilave varet formësimi i objektivave të sigurisë dhe strategjisë së nënsistemeve tjera. Megjithatë, duhet të theksohet se formësimi dhe definimi i politikës nacionale të sigurisë, bashkë me përcaktimin e prioriteteve, është punë me përgjegjësi të madhe dhe shumë komplekse. Këtë punë e bën të tillë tërësia dhe kompleksiteti i qenies shoqërore pothuaj në të gjitha sferat e jetës. Në këtë drejtim shtetet nacionale krijojnë në vazhdimësi kornizat konceptuale dhe strategjike të politikës së sigurisë, si instrument operativ politik e metodologjik për ruajtjen e vlerave vitale të shoqërisë gjegjësisht për realizimin e objektivave nacionale. Ndërtimi i një koncepti dhe strategjie krejtësisht e re bazohet në politikën e sigurisë, gjë që paraqet shenjat relevante të funksionimit të pushtetit politik. Çështjet e sigurisë do të kenë rëndësi dominante edhe në të ardhmen, duke pasur parasysh rreziqet politike e të sigurisë e rreziqet tjera, të cilat janë të pranishme vazhdimisht në marrëdhëniet ushtarake e politike dhe në marrëdhëniet tjera në planin ndërkombëtar. Këto karakteristika të politikës së sigurisë, pa dyshim, tregojnë se sfidat e karakterit të sigurisë janë esenciale për funksionimin e papenguar të të gjitha institucioneve të sistemit.

Faktor vendimtar në shkatërrimin dhe eliminimin e të gjitha burimeve të pasigurisë është reaksioni i shoqërisë në tërësi dhe jo vetëm i organeve shtetërore që merren më këtë problematikë. Në kushte të tilla, konsiderojmë se rëndësi të veçantë ka parashikimi. Në vizionin global të politikës së sigurisë analizat parashikuese me të gjitha aspektet: shkencore, profesionale-operative, praktike, kohore, hapësinorë, etj., mund të shërbejnë si fundamend i veprimit operativ të sigurisë kundrejt të gjitha formave të devijimeve. Por, çdo vizion prognozues ka më shumë gjasa për krijimin e hipotezave të qëndrueshme, në qoftë se bëhet fjalë për probleme të afërta të sigurisë. Në të vërtetë, njohja e mirë e të gjitha problemeve të sigurisë nga aspekti shkencor, profesional e operativ dhe praktik, është e mundur vetëm me një shkallë të lartë të planifikimit, e cila arrihet vetëm në bazë të politikës së formësuar të sigurisë. Për këtë arsye duhet të theksohet se sot koha ecën shpejt dhe e ardhmja e

panjohur është pasojë e sfidave dhe problemeve komplekse që e shoqërojnë zhvillimin e shoqërisë.

Në të gjitha shtetet, hartimi dhe miratimi i politikës nacionale të sigurisë bëhet në parlament. Aty është i mundur një dialog transparent mbi të gjitha çështjet themelore aktuale të bashkësisë politike, pra edhe mbi çështjet e sigurisë. Përveç kësaj, organizimi dhe pluralizmi politik i jetës duhet të mundësojë që edhe në sferën e sigurisë qytetarët të gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në miratimin e programeve preventive si dhe të aktiviteteve të ndryshme në këtë sferë. Pra, kornizat globale të politikës së sigurisë i vendos parlamenti ose trupat tjerë të shtetit, ndërsa e realizojnë subjektet e sistemit të sigurisë, të cilat kanë role të ndryshme.

Politika e sigurisë, para së gjithash, është e orientuar në krijimin e parakushteve të domosdoshme që duhet t'ia mundësojnë pushtetit politik krijimin e një bashkësie demokratike e të sigurisë. Kjo mundëson njëkohësisht që idealet politike të avancohen në doktrinë politike e të sigurisë, nëpërmjet të cilës synohet të realizohen konceptet optimale të bashkëjetesës dhe strategjisë së veprimit në drejtim të realizimit të objektivave të caktuara në mënyrë institucionale. Pra, në kuadrin e doktrinës politike, politika e sigurisë është mbështetëse e veprimit dhe legjitimitetit të bashkësisë politike stabile, duke eliminuar të gjitha ato sjellje që mund të pengojnë veprimin strategjik. Në mendimin shkencor interdisiplinar, politika e sigurisë përkufizohet me termat si janë: pushtet, fuqi dhe ndikim. Meqenëse këto terme meritojnë një elaborim më të gjerë, ne do të theksojmë me këtë rast vetëm disa veçanti. Siç kemi thënë, çdo pushtet në esencë është pushtet politik gjegjësisht produkt i politikës. Për krijimin e kushteve politike për zhvillim të lirë të një shoqërie shfaqet nevoja për norma të përgjithshme, të cilat formulojnë në mënyrë institucionale interesat e përgjithshme dhe mbrojtjen e bashkësisë.

Normat rregullative paraqesin çështje politike imperative, sidomos kur vështrohen në formë të mundësisë për shkeljen e tyre. Për këtë arsye, pas këtyre normave duhet të qëndrojë autoriteti i bashkësisë. Kjo do të thotë që, nëpërmjet pushtetit si formë e fuqisë legjitime dhe si komponentë e politikës, gjegjësisht nëpërmjet funksionimit të pushtetit, krijohet ambient për shqyrtimin dhe provimin konkret të “përshtatshmërisë së doktrinës, arsyeshmërisë së rendit, pranisë së subjektit dhe rregullsisë dhe nacionalitetit të procesit politik, (Leksikoni i nocioneve themelore politike, f. 15). Kështu, aftësia dhe efikasiteti i hierarkisë institucionale të pushtetit politik, të krijuar me instrumente legjitime të pushtetit, është faktori kyç i ndikimit të nevojshëm në sjelljen e individit ose grupit që përpiqet të realizojë objektivat e tij me mjete të ndryshme të dhunës. Këtu shihet qartë se fuqia institucionale në nivele të ndryshme kalon në duar të institucioneve të pushtetit shtetëror. Kështu vijnë deri



te konstatimi se, në paraqitjen e vet legjitime, pushteti politik është “fuqia kolektive që e njohin dhe e pranojnë varësit, e cila e posedon të drejtën e organizimit dhe përdorimit të forcës fizike (Leksikoni i nocioneve politike, 994, f. 179). Në organet e pushtetit ekzekutiv bën pjesë edhe aparati ekzekutiv-detyrues. Por, „çfarë është aparati detyrues e ekzekutiv, çfarë është raporti i tij me trupat përfaqësuese si edhe me bartësit zyrtarë të funksioneve ekzekutive, me çfarë mjetesh disponon ai dhe nën kontrollin e ndikimin e kujt gjendet ai, në masë të madhe varet nga struktura e vërtetë e pushtetit ekzekutiv dhe, rrjedhimisht, kualiteti dhe forma e një sistemi politik. (J. Gjorgjeviq, botimi i ri, f. 642). Siç duket, për të realizuar objektivat e saj, politika e shfrytëzon shtetin. Pa këtë hallkë themelore, politika kurrsesi nuk do të ishte në gjendje të realizonte programin politik. Meqë objektiv i çdo pushteti është që të krijojë besimin e qytetarëve tek legjitimiteti i tij, shtrohet përsëri çështja esenciale, ajo e kompleksitetit funksional dhe e veprimit operativ të organeve ekzekutive të pushtetit. Me nxjerrjen e kushtetutës dhe të ligjeve e të akteve nënligjore precizohen qartë roli dhe fuqia e organeve dhe shërbimeve të sigurisë në një shoqëri moderne, kështu që, nëpërmjet miratimit të politikës së sigurisë, teoria e sigurisë dhe filozofia e sigurisë krijojnë kornizën shkencore globale në nivel shtetëror, me qëllim të mbrojtjes së vlerave themelore të shoqërisë.

Mungesa e nivelit të nevojshëm të sigurisë gjithsesi vë në pikëpyetje stabilitetin e funksionimit të institucioneve të pushtetit, pra edhe të shoqërisë në tërësi. Në këtë kuptim, detyrë e institucioneve që merren me kornizat e politikës së sigurisë është që nëpërmjet zbatimit të këtyre kornizave të sigurohet stabiliteti i shtetit, por duke mos vënë në pikëpyetje mbrojtjen kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore. Pra, në një hapësirë demokratike e të sigurisë krijohen kushtet që të gjithë anëtarëve të bashkësisë politike t'u mundësohet zhvillim dhe avancim në të gjitha fushat, gjithnjë duke respektuar kornizën kushtetuese e ligjore.

Varësia reciproke demokratike e sigurisë mund të eliminojë konceptet dhe veprimet redukcionistike, sepse pluralizmi i interesave dhe nevojave në shoqërinë demokratike nuk i duron kufizimet e përmendura, të cilat vënë në pikëpyetje përcaktimet themelore të jetës demokratike. Mirëpo, edhe në kornizat e dëshiruara vjen deri të „pasigurisë demokratike“, sidomos në zbatimin e masave operative të politikës së sigurisë, kështu që pluralizmi i objektivave në shoqëri pashmangshëm prodhon edhe situata konfliktuale. Pikërisht në këso rastesh duhet të vijmë në shprehje forcat demokratike të sigurisë të institucioneve të krijuara në mënyrë legjitime, të cilat, para së gjithash, nëpërmjet masave preventive, ngushtojnë dhe eliminojnë hapësirën për sjellje devijante. Me këtë rast duhet të respektohen standardet themelore të të drejtave dhe lirive të njeriut, të cilat janë postullat fundamental në veprimin e tyre. Gjithë kjo shpie në përfundimin se zhvillimi i

shoqërisë demokratike në të gjitha aspektet, e sidomos krijimi i hapësirës për humanizimin e personalitetit në të cilën kultura dhe dimensionet e vlerave forcojnë rolin e tyre dhe kuptimi themelor i personalitetit krijues duhet të përcjellë edhe politikën e sigurisë. Duke respektuar premisat e përmendura del se pa një stabilitet të nevojshëm për cilëndo shoqëri, as që mund të bëhet fjalë ruajtjen e strukturës organizative të shoqërisë.

Nga këndvështrimet e deritashme del se politika e sigurisë është element qenësor i funksionimit të një shteti. Gjatë krijimit të saj duhet të vijmë në shprehje të arriturat bashkëkohore civilizuese në të gjitha fushat, gjë që është shumë e rëndësishme për emanacionin e të gjitha postulateve demokratike. Meqenëse jetojmë në një kohë me paqartësi, kundërshti e kompleksitete të shumta, të cilat shkaktojnë situata të ndryshme konfliktuale, politika e sigurisë duhet të ketë kuptimin e ruajtjes së stabilitetit të bashkësisë politike.

Pra, një politikë e sigurisë imanente efektive preventive do të sigurojë një hapësirë të lirë, demokratike dhe të sigurt, në të cilën do të zhvillohen të gjitha aktivitetet e nevojshme politike e të tjera të shoqërisë. Së këndejmi, mbetet të përpiqemi të formulojmë një definicion integral të politikës së sigurisë.

*Në një shoqëri demokratike, pluraliste, juridike e civile, politika e sigurisë e cila bazohet në parimet politike, demokratike e kushtetuese juridike, mund të definohet si kornizë komplekse e masave dhe aktiviteteve në planin politik, ekonomik, social, të sigurisë e të mbrojtjes si edhe në fushat tjera, e miratuar në pajtim me analizat përmbajtjesore shkencore, profesionale, operative dhe praktike të burimeve të rreziqeve, operacionalizimi i të cilave zhvillohet dhe orientohet nëpërmjet nënstistemeve të shtetit, të cilat kanë funksione të precizuara qartë, duke respektuar gjatë aktivitetit të tyre parimet e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe në pajtim me vlerat demokratike të shoqërisë, krejt me qëllim të ruajtjes së sigurisë së brendshme dhe të jashtme të shoqërisë.*

## **1.2. STRATEGJIA E SIGURISË**

Nga vërtetimet e deritashme del se politika e realizon fuqinë e saj institucionale nëpërmjet shtetit, sepse lufta politike midis partive, para së gjithash, është e orientuar kah shteti, si objekt i fundit i tyre. Shteti paraqet interesin themelor politik të çdo partie politike, sepse secila parti ka të drejtën e organizimit të masave

të ligjshme detyruese. Në këtë kuptim, në nivel të shtetit hartohet dhe miratohet politika e sigurisë, e cila shërben si kornizë themelore për realizimin e interesave fundamentale të shoqërisë. Nuk ka dyshim se politika e sigurisë ka një vend specifik, me që ajo është një prej levave më të rëndësishme të sigurisë, e cila krijon parakushtet e nevojshme për zhvillim progresiv të shoqërisë në të gjitha fushat e jetës. Kështu, më nuk mund të vihet në pyetje rëndësia e shkencës së sigurisë, e cila është faktor i rëndësishëm në hartimin e politikës së sigurisë dhe strategjisë së zbatimit të saj.

Pra, në rrafshin teorik dhe shkencor e profesional, me një qasje sistemore dhe interdisiplinare komplekse krijohet mundësia për shqyrtimin e të gjitha premisave relevante edhe në bazë të vrojtimeve të tyre themelore, vendosen dhe ndriçohen problemet që mund të shkaktojnë ose shkaktojnë pasoja komplekse për sigurinë. Çdo shkencë, pra edhe shkencës mbi sigurinë, mbi të gjitha, i intereson e kaluara dhe e tashmja, e cila shërben si substrat për miratimin e planeve operative që duhet të shërbejnë për eliminimin ose uljen e rreziqeve për sigurinë në fusha të ndryshme. Arsytet e përmendura më sipër të progresit shkencor-teknik pa dyshim kërkojnë hulumtime inter-disiplinare dhe nevojën e reciprocitetit, në mënyrë që problematikës së sigurisë t'i qasemi si një faktori relevant dhe dinamik me politikë të sigurisë të definuara qartë. Mbështetja e fortë profesionale e operative mundëson krijimin e strategjisë reale të zbatueshme për të arritur objektivat e përcaktuara. Me këtë rast, duket të thuhet se objektivat e sigurisë duhet të të krijohen ashtu që nëpërmjet strategjisë së përcaktuar qartë e në bazë të njohurive shkencore e profesionale të formësohet politika e sigurisë. Për këtë arsye është joreale të pritet që ajo të jetë e përshtatshme në qoftë se nuk është harmonizuar në pajtim me objektivat më të rëndësishme dhe me interesat primare të shoqërisë bashkëkohore. Vetëm në këtë mënyrë mund të përmbushen kërkesat e sigurisë dhe të jepet kontribut në zhvillimin, harmonizimin dhe orientimin e interesave vitale të shoqërisë. Këtu qëndron rëndësia e saj politike dhe e sigurisë, në mënyrë që në bazë të mendimit shkencor e profesional dhe të përvojës paraprake të eliminohen të gjitha pengesat që shpien te jofunksionaliteti i rendit juridik. Për të mos ardhur deri të kriza në funksionimin e rendit juridik dhe për të operacionalizuar me sukses politikën e sigurisë, është e nevojshme të hartohet strategjia. Fjala strategji rrjedh nga fjalët greke *stratos* – *ushtri* dhe *ago* – *udhëheq*. Ky nocion është përvetësuar dhe është shfrytëzuar në të gjitha hapësirat gjuhësore. Ai përdoret që prej vitit 500 para erës së re.

Kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe përdorimin e këtij nocioni ka dhënë Sun Cu Yu, i cili e ka shkruar veprën e njohur nga sfera e shkathtësive ushtarake. Më vonë, ai është përpunuar në mënyrë përmbajtjesore nga gjenerali K.U. Clauzeuitz, i

cili ka shprehur qëndrimin e tij tashmë të njohur se “lufta nuk është asgjë tjetër veçse vazhdim i politikës me mjete të tjera”. Ai nuk e ka renditur strategjinë as në mesin e dijes as në mesin e shkathtësive. Por, pikëpamja e tij shpreh qartë ndikimin vendimtar të politikës në strategjinë. Edhe shumë autorë të tjerë kanë dhënë definicionet e tyre. Në të gjitha pikëpamjet e tyre qëndron konstatimi se strategjia është syri i shkathtësisë. Këtu ata kanë përmendur edhe taktikën operative, por rol dominant i kanë dhënë strategjisë.

Strategjia e përcakton zgjedhjen e metodave dhe mjeteve për realizimin e objektivave të politikës së sigurisë. Disa autorë, definimin e strategjisë e mbështesin në teori, ndërsa disa të tjerë e definojnë si teori dhe praktikë. *Sa i përket definicionit, mund të thuhet se nocioni strategji përfshin interaksionin e nevojshëm të teorisë dhe praktikës, njohurisë dhe shkathtësisë, ashtu që, nëpërmjet një koordinimi të suksesshëm në të gjitha nivelet dhe nëpërmjet zbatimit të metodave dhe mjeteve përkatëse të politikës dhe strategjisë së sigurisë, të realizojë objektivat e përcaktuara në rrafshin politik. Objektivat politike nuk mund të arrihen pa politikë dhe strategji përkatëse të sigurisë, të cilën janë të obliguar ta zbatojnë organet dhe institucionet e shtetit që ndërtohen enkas për këtë qëllim.*

Objekti i interesimit tonë, para së gjithash, është strategjia e sigurisë, si pjesë e strategjisë së përgjithshme globale, në nivel të shteteve nacionale. Një analizë e shkurtër e njohurive të deritashme çon te konstatimi se ende nuk ka një përpunim përkatës teorik e shkencor dhe profesional e operativ për përpunimin e strategjisë së sigurisë, e cila do të mundësonte planifikimin real të të gjitha masave operative, taktike, teknike e të tjera, me qëllim të përballimit dhe zgjidhjes së problemeve të sigurisë në shoqëri, duke respektuar të gjitha elementet e politikës së sigurisë. Për këtë arsye, rëndësi themelore ka kuptimi shkencor e profesional i esencës dhe i përmbajtjes së strategjisë, në bazë të të cilave mund të hartohen plane reale, nëpërmjet operacionalizimit të të cilave arrihet dhe ruhet gjendje e mirë e sigurisë. Së këndejmi, para teorisë së sigurisë shtrohen kërkesa të larta shkencore e profesionale interdisiplinare. Në qoftë se dëshirojmë që strategjinë ta bazojmë në njohuritë shkencore, profesionale e operative, duhet të dimë se është shumë vështirë të perceptohet realiteti në sferën e sigurisë, për shkak të formave më të ndryshme të rrezikimit, të cilat është e pamundur të studiohen deri në fund. Prandaj, kurrë nuk mund të flitet për siguri absolute të shoqërisë. Pikërisht për shkak se nga aspekti teorik e metodologjik ky proces është shumë i ndjeshëm dhe i rëndë, në krahasim me fushat tjera me faktorë të shumtë specifikë që ndikojnë në situatën e sigurisë. Prandaj, strategjia e sigurisë duhet të jetë e drejtë dhe e pranueshme për shoqërinë, e orientuar ndaj objektivave që duhet t’i arrijë, të cilat burojnë nga politika e sigurisë.

Por, gjatë operacionalizimit të strategjisë së sigurisë, gjithmonë shfaqen sfida që do të pengojnë realizimin e objektivave të përcaktuara. Në fushën e sigurisë së shtetit pashmangshëm shfaqen një sërë interesash e konfliktesh (politike, ekonomike, sociale etj.). Ato shoqërohen me devijime në fusha të ndryshme të jetës e të punës dhe manifestohen me një sërë dukurish që çojnë drejt destabilizimit të nënsistemeve të caktuara. Kjo tregon se strategjia e sigurisë, para së gjithash, duhet të trajtohet nga këndvështrime interdisiplinare. Detyrë themelore e të cilës është që, në bazë të njohurive shkencore dhe praktikës, të gjendet zgjidhje për të gjitha problemet e sigurisë dhe të gjenden zgjidhje e metodave dhe mjeteve adekuate. Pa zgjidhje të tilla nuk mund të merren vendime konsistente mbi përcaktimin e orientimeve operative e të tjera, me qëllim të krijimit të kornizës së dëshiruar të sigurisë në një shtet.

Çdo strategji duhet të mbështetet në njohuritë dhe forcën e operacionalizimit të saj, ashtu që organet dhe shërbimet e sigurisë të kenë të drejtë legjitime për përdorimin e dhunës, në pajtim me kushtetutën dhe ligjin. Strategjia globale në nivel të shtetit vështrohet si strategji nacionale, prandaj gjithnjë e më shumë përdoret nocioni “strategji e sigurisë nacionale”, e cila duhet të mbulojë të gjitha fushat e veprimit, me një sërë nënstrategjish që kanë të bëjnë me segmente të veçanta të punës së subjekteve të sistemit të sigurisë. Me këtë rast është shumë e rëndësishme që njohuritë shkencore nga fusha e sigurisë të aplikohen në funksion të operacionalizimit të masave më të ndryshme preventive. Kjo mundëson që njohuritë shkencore të fenomenologjisë, sidomos ato për format komplekse të kriminalitetit të organizuar, të aplikohen për hartimin e programeve që do të çojnë në reagimin efikas e të suksesshëm të organeve dhe shërbimeve në drejtim të eliminimit të të gjitha rrethanave që mund të shpien deri te format e ndryshme të sjelljes devijante. Pra, objektivi i politikës së sigurisë është që në bazë të njohurive shkencore e profesionale dhe në bazë të përvojave operative të krijohen korniza sa më reale dhe sa më objektive për reagim me kohë, efikas e autoritativ të subjekteve përkatëse. Objektivi është gjithashtu koordinimi dhe orientimi i organeve dhe institucioneve me qëllim të marrjes së vendimeve më meritore për veprim praktik, duke respektuar standardet ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë e njeriut. Nga politika e sigurisë pritet dhe kërkohet që yë krijojë korniza të tilla globale të veprimit, me zbatimin e të cilave përmbushen nevojat dhe interesat fundamentale të qytetarëve. Së këndejmi, strategjia është tërësi e metodave dhe mjeteve për arritjen e objektivave në sferën e sigurisë. Objektivat e përmendura, pra eliminimi i rreziqeve të sigurisë në fusha të ndryshme, mund të arrihen vetëm me një strategji të menduar mirë. Por, fushat e veprimit të mekanizmave të sigurisë nuk mund të mbështeten vetëm në aparatën shtetërore, por duhet të mbështeten edhe në komponentat tjera të shoqërisë civile. Mu për shkak të diskontinuitetit të madh në zhvillimin e teknologjisë, të

vatrave të ndryshme të sigurisë dhe organizimit të pamjaftueshëm institucional, shtrohet nevoja e konstituivit të hapësirës që duhet të krijojë mundësi për përfshirjen e të gjitha subjekteve të cilat mund të kontribuojnë për përmirësimin e gjendjes në fushën përkatëse. Sot siguria nuk është vetëm përgjegjësi e organeve dhe shërbimeve zyrtare. Në qoftë se duam të ndërtojmë një shoqëri civile, problemet e sigurisë duket të jenë në qendër të interesimit edhe për një sërë asociacionesh të pavarura dhe për qytetarët. Në kushte pluraliste specifike, qytetarët mund të japin ndihmë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjeve kryesore të sigurisë. Komplementariteti dhe multidisciplinarteti i strategjisë së sigurisë shprehet në lloj-llojshmërinë dhe lidhshmërinë dialektike me një sërë nënsistemesh, të cilat kanë funksione të ndryshme. Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i strategjisë së sigurisë në kuptimin dhe përmbajtjen e plotë të saj domosdo shtron nevojën e bashkëpunimit midis subjekteve të ndryshme. Veprimi i përbashkët i një sërë asociacionesh dhe institucionesh mund të jetë shumë i frytshëm në ruajtjen e segmenteve relevante të sigurisë. Në pajtim me objektivat e planifikuara, duhet të ndërmerren të gjitha veprimet dhe aktivitetet për kundërvënien me sukses ndaj kundërshtive që mund të shndërrohen në vatra të sjelljeve të ndryshme devijante. *Vetëm një strategji efikase, e orientuar mirë, legjitime, praktike, me metoda e mjete të ligjshme, e përcaktuar në aspektin kohor e hapësinor, e bazuar në njohuritë shkencore e profesionale dhe në përvoja të nivelit shtetëror mund të operacionalizohen me sukses objektivat e politikës së sigurisë.* Strategjinë e veprimit e hartojnë bashkërisht të gjitha organet dhe institucionet e një shteti, të cilat kanë funksione të ndryshme në fusha të ndryshme. Detyrë parësore e tyre është që në mënyrë adekuate të angazhohen për përcaktimin dhe realizimin praktik të masave dhe aktiviteteve që duhet të jenë rezultat i njohurive shkencore e profesionale dhe operative si edhe i praktikës. Duhet të theksohet se rrethanat e ndryshme të sigurisë kanë veçantitë e tyre dhe, në analogji me këtë, duhet të krijohen mekanizmat që duhet të veprojnë në secilën situatë për sigurinë e hapësirës për zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, me të gjitha specifikat dhe të gjitha dallimet.

Është fakt i njohur se pa një nivel të kënaqshëm të sigurisë nuk mund të zhvillohen proceset ekzistenciale në shoqëri, sidomos kur dihet se kundërshtitë ndërmjet forcave demokratike, përparimtare e konstruktive dhe forcave antidemokratike e destruktive janë gjithnjë e më të mëdha. Këto kundërshti krijojnë në vazhdimësi sfida për sigurinë, kështu që ndikojnë në stabilitetin e rendit politik. Në këtë kuptim, rëndësi fundamentale ka hartimi i strategjisë së menduar mirë për sigurinë, me qëllim të eliminimit me efikasitet të të gjitha formave të dhunës. Për këtë arsye, shkenca mbi sigurinë duhet të orientohet para së gjithash në zbulimin me kohë të të gjitha vatrave të sjelljeve devijante. Meqenëse siguria është objektiv themelor i

secilës shoqëri, edhe strategjia e sigurisë ka një rol dhe një rëndësi të madhe, për shkak të karakterit multidisiplinar të hulumtimeve të problematikës së sigurisë. Për këto arsye, është i domosdoshëm aplikimi i njohurive shkencore, profesionale e operative dhe i njohurive të nxjerra nga përvoja. Kjo është garanci se nëpërmjet mekanizmave institucional dhe në interaksion të plotë të tyre do të sigurohen parakushtet për arritjen e një niveli sa më të lartë të sigurisë. Në lidhje me këtë është e rëndësishme të njihen faktorët determinues, të cilët kanë rëndësi thelbësore për krijimin e strategjisë globale të sigurisë dhe për gjetjen e zgjidhjeve optimale. Njohja e mirë e këtyre faktorëve ndihmon hartimin e një strategjie përmbajtjesore. Pra, është e rëndësishme të theksohen ata faktorë kyçë të cilët paraqesin fundamentin e një strategjie që do të përmbante të gjitha ato elemente që janë të domosdoshme për realizimin e detyrave që dalin nga politika e sigurisë.

Çdo organizatë dhe çdo subjekt i sistemit të sigurisë duhet të kryejë me sukses funksionet me të cilat është ngarkuar. Zhvillimi i përgjithshëm i sistemit të sigurisë, pra edhe trajtimi shkencor i të gjitha aspekteve të saj, sot janë parakushtet themelore të sistemit të organizuar e bashkëkohor të sigurisë. Pra, qasjet konkrete retorike dhe operacionalizimi i tyre, si edhe përcaktimi i objektivave specifike globale dhe prioriteteve, duke i kushtuar kujdes funksionimit efikas të të gjitha elementeve të sistemit të sigurisë dhe përshtatjes së tyre me sfidat e ndryshme që shfaqen nga rrethina e jashtme. Kjo është detyrë e strategjisë së sigurisë. Ajo përcakton orientimet, metodat, mjetet, kohën, hapësirën, kushtet dhe mundësitë e veprimit, të cilat varen nga kompleksiteti i problemit të sigurisë. Pluralizmi i nënsistemeve që veprojnë në pajtim me pozitën e tyre në strukturën organizative, të cilat kanë të drejta, detyrat dhe obligimet e përcaktuara qartë, kërkon edhe një planifikim preciz të detyrave konkrete të tyre. Pavarësisht prej rëndësisë së tyre të ndryshme, secili prej nënsistemeve është në funksion të ruajtjes së gjendjes së sigurisë, gjë që mundëson zhvillimin e papenguar të shoqërisë bashkëkohore. Orientimi strategjik e metodologjik, sidomos në situata komplekse, është parakusht thelbësor për realizimin e detyrave. Trajtimi me kohë dhe i tërësishëm i të gjitha çështjeve, me qëllim të harmonizimit të masave dhe veprimeve të domosdoshme është shumë i rëndësishëm për eliminimin e problemeve e vështirësive që e rëndojnë situatën e sigurisë.

### **1.3. METODAT DHE MJETET E STRATEGJISE SE SIGURISE**

Për çdo pushtet politik është e rëndësishme shkalla e zbatimit të politikës së sigurisë, gjegjësisht mënyra e operacionalizimit të strategjisë së sigurisë. Prej tyre varen masat e pushtetit politik për ruajtjen e nivelit të kënaqshëm të sigurisë në

shoqëri. Të gjitha organet dhe institucionet e një shteti, megjithëse kanë funksione të ndryshme dhe veprojnë në fusha të ndryshme, ideojnë dhe miratojnë strategjitë e tyre të veçanta, me qëllim të realizimit të objektivave të planifikuara. Detyrë kryesore e tyre është që të angazhohen në mënyrë adekuate, duke pasur parasysh se secili aktivitet dhe secila rrethanë e sigurisë kanë specifikat e tyre, të cilat diktojnë mënyrën e veprimit të mekanizmave të sigurisë. Strategjia e sigurisë nuk mund të jetë unike për të gjitha fushat dhe as të bazohet në kritere dhe parime të njëjta, sipas të cilave në të gjitha rrethanat konfliktuale mund të zbatohet strategjia. Secila situatë kërkon qasje të veçantë dhe veprim konkret të veçantë. Siç është thënë, çdo strategji duhet të bazohet në analizat sistimore shkencore, profesionale, praktike dhe kritike. Është e domosdoshme që reagimi të jetë i shpejtë, autoritativ, profesional, i ligjshëm dhe efikas, prandaj me këtë rast vjen në shprehje zbatimi i formave, metodave dhe mjeteve më të përshtatshme si edhe njohuritë dhe shkathtësitë për zgjidhjen e situatave komplekse.

Një prej faktorëve themelorë për kryerjen e detyrave operative më mënyrë të ligjshme e profesionale për arritjen e objektivave të caktuara është shqyrtimi përmbajtësor e sistemor i elementeve qenësore që përbëjnë vlerësimin e sigurisë, si edhe vlerësimi i shkallës së sigurisë me parashikim të saktë të situatës së sigurisë. Në bazë të identifikimit të problemit, ku vjen në shprehje iniciativa, aftësia, kreativiteti, përgjegjësia, etj., rëndësi të veçantë ka zbatimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së veprimeve (për çka kemi folur më sipër).

Është e rëndësishme të thuhet se mekanizmat demokratik të kontrollit kërkojnë që zbatimi i të gjitha masave të sigurisë në shoqëri, sidomos harmonizimi i aktiviteteve të ndryshme, të bëhet duke respektuar plotësisht ligjshmërinë. Në këtë mënyrë nuk sigurohet vetëm rregullsia në funksionimin e rendit demokratik, por sigurohet edhe drejtësia e cila bazohet në njohjen dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive të njeriut, të cilat paraqesin vlerat më të larta të shoqërisë. Për këtë arsye, institucionet publike hartojnë kornizat e sigurisë për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Një prej faktorëve më të rëndësishëm të strategjisë së sigurisë është edhe politika arsimore dhe përshtatja e saj me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë bashkëkohore. Për shkak të specifikave organizative dhe shumëllojshmërisë së punëve dhe detyrave, politika arsimore kushtëzon edhe qasje të re në hartimin e strategjisë e cila duhet të bazohet në të arriturat dhe parimet shkencore. Shqyrtimi i funksionalitetit dhe efikasitetit të subjekteve të sistemit të sigurisë, si edhe shqyrtimi i programeve të tyre arsimore kanë treguar se formësimi i zhvillimit të procesit operativ, strategjik e drejtues varet shumë nga funksioni arsimor.



Së këndejmi parakusht relevant për hartimin e një strategjie të dëshiruar dhe për zbatimin e saj është gjetja e përmbajtjeve arsimore të cilat bëhen fundament i zhvillimit kreativ, inovativ dhe integrativ. Për këtë arsye është e domosdoshme që programet arsimore të plotësohen dhe të aktualizohen në vazhdimësi. Këtë e imponon dinamika e zhvillimit shoqëror, ekonomik, teknologjik dhe shkencor. Kërkesë e veçantë është që arsimimi të paraqes bartjen e dijes, gjë që ka rëndësi të veçantë për të gjitha nënsubjektet e sistemit të sigurisë, të cilat duhet të përshtatin strukturën e tyre dhe të begatojnë veprimet konkrete si edhe aftësitë për zbatimin e detyrave të tyre në përputhje me kërkesat që dalin nga marrëdhëniet e reja shoqërore. Qasja moderne e arsimit në strukturat e sigurisë shfaqet si kërkesë e postulateve bashkëkohore shoqërore. Ajo ndikon në lidhjen funksionale të sistemeve arsimore, e cila duhet të përshtatet me përmbajtjet dhe dimensionet e aktiviteteve konkrete gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave në fushën e sigurisë. Në këtë kontekst, aftësitë dhe njohuritë duhet të jenë instrument themelor për kryerjen e detyrave të caktuara në fusha të ndryshme të sigurisë. Në çoftë se synohet reagimi me kohë ndaj rreziqeve të sigurisë, orientim themelor i politikës arsimore duhet të jetë e ardhmja, në mënyrë që subjektet e sistemit të sigurisë të jenë të gatshme dhe të përgatitura për veprim në situata të ndryshme të sigurisë. Arsimi bashkëkohor duhet të jetë investimi kryesor i sistemit të sigurisë në të ardhmen. Ky investim përfshin arsimimin e pjesëtarëve të këtij sistemi, nëpërmjet të cilit ata përgatiten për veprim praktik e operativ në shoqërinë bashkëkohore. Në këtë kuptim çështjet e sigurisë fitojnë një kuptim dhe rëndësi të re, para së gjithash në drejtimin dhe punën efikase të subjekteve të sistemit të sigurisë në kushtet bashkëkohore. Vetëm një personel i arsimuar dhe i përgatitur mirë mund të krijojë nënsisteme transparente, demokratike dhe komunikative, me objektiva të qarta, strategji të definuar për kryerjen e detyrave në procesin e modernizimit. Ky proces duhet të bazohet në njohuritë teorike dhe shkencore, operacionalizimi konkret dhe praktik i të cilave duhet të sigurojë një rol të pranueshëm të subjekteve të sistemit, që është me interes reciprok e të përbashkët për zgjidhjen e problemeve të sigurisë. Siguria nuk është vetëm shqetësim i organeve të sigurisë, por edhe shqetësim për të gjithë qytetarët. Për këtë arsye mekanizmat e sigurisë duhet të kenë vend të respektuar në shoqëri dhe këtë mund ta arrijnë vetëm duke vepruar në bazë të njohurive dhe të arriturave shkencore e profesionale. Koncepti arsimor i orientuar drejt së ardhmes është një instrument shumë i fuqishëm për përshtatjen dhe vitalitetin e strukturave organizative të sigurisë ndaj sfidave të së ardhmes.

Përveç avancimit të sistemit arsimor në pajtim me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë bashkëkohore, pajisjes me mjete materiale e teknike, shfrytëzimit të të arriturave shkencore dhe shfrytëzimit të mjeteve të informimit e komunikimit, rëndësi të veçantë ka sistemi i udhëheqjes sidomos në kryerjen e aksioneve në situata

komplekse të sigurisë. Vetëm një sistemim i udhëheqjes, i cili bazohet në të arriturat shkencore dhe në zbatimin e koncepteve, parimeve, metodave, taktikave dhe teknikave bashkëkohore mund të realizojë me sukses detyrat strategjike operative për arritjen e objektivave konkrete, të cilat janë cak i vizionit të forcave demokratike të sigurisë. Parakusht për këtë është ndërtimi i marrëdhënieve të tilla brenda strukturave të sigurisë, të cilat do të mundësojnë që zhvillimi i tyre të bëhet në pajtim me parimet e barazisë, tolerancës, durimit dhe aftësisë. Kjo nënkupton respektimin e filozofisë së udhëheqjes e cila përfshin komponentat politike, juridike, strategjike, taktike, etj. Me rastin e hartimit të planeve globale operative, sidomos kur bëhet fjalë për masa operative, vjen në shprehje autoriteti dhe njohja e problematikës nga struktura udhëheqëse. Në këtë mënyrë mund të përcillet shkalla e realizimit të objektivave dhe të jepen këshillat e domosdoshme të veprimit, të cilat do të ndihmojnë orientimin e veprimit efikas. çdo sistem i sigurisë së një shoqërie kujdeset për realizimin e detyrave për të cilat është përgatitur. Edhe sistemi i sigurisë, nëpërmjet një sërë bartësish dhe subjektsh synon të përmbushë funksionin dhe të realizojë detyrat e tij për arritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e situatës së sigurisë, me theks të veçantë në mbrojtjen e qytetarëve dhe në sigurinë personale të pasurisë së tyre.

Qenia shoqërore është shumë e komplikuar dhe komplekse, prandaj shtrohet nevoja për një udhëheqje që ka njohuri për të udhëhequr, qasje studioze, aftësi për analizë dhe sintezë, aftësi për analiza kritike dhe komparative. Vetëm një udhëheqje e tillë mund të bëjë ndryshime strukturore, instrumentale dhe organizative që do t'u përshtaten kushteve në të cilat zhvillohen aktivitetet në sferën e sigurisë. Është e qartë se udhëheqja është zbatim në praktikë i njohurive shkencore e teorike. Ajo sot është rregullatorë i funksionimit të subjekteve të shumta të sistemit të sigurisë. Gjithashtu, udhëheqja është edhe profesion që, përveç dijes, kërkon edhe përgatitje shkencore për ndërtimin e marrëdhënieve njerëzore brenda strukturës organizative. Për t'u përshtatur kërkesave të shoqërisë, sistemi bashkëkohor i udhëheqjes duhet të arrijë objektivat e përcaktuara në bazë të politikës së sigurisë dhe strategjisë së sigurisë. Për këtë arsye, organizata udhëheqëse, në të gjitha nivelet hierarkike të organizimit dhe të autorizimeve e përgjegjësi, ka rol vendimtar në ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve me bashkësinë shoqërore. Në qoftë se marrëdhëniet midis elementeve të sistemit të udhëheqjes janë në nivel të kënaqshëm, atëherë edhe marrëdhëniet midis niveleve të ndryshme të forcave të sigurisë së shtetit janë në pajtim me objektivat e përcaktuara nga mekanizmat legjitim të shtetit. Kjo mund të arrihet vetëm në kuadrin e atyre strukturave që kanë komponenta të zhvilluara organizative dhe kadrovike.

Metoda e re e ndërtimit të marrëdhënieve në sistemin e udhëheqjes, e bazuar në metodat shkencore, mundëson krijimin e kushteve të përshtatshme që subjektet e sistemit të sigurisë të veprojnë në mënyrë profesionale në rrethana të caktuara. Kjo metodë mundëson vlerësimin profesional dhe propozimin e masave përkatëse, në pajtim me objektivat dhe interesat e shoqërisë në tërësi. Por, ky proces kërkon përgatitje të lartë profesionale në të gjitha nivelet e udhëheqjes. Për këtë arsye, përgatitja e lartë dhe aftësia për udhëheqje mund të konsiderohen si pikënisje fillestare për të gjitha subjektet e sistemit të sigurisë. Dihet se kompleksiteti i probematikës së sigurisë shtron kërkesa më të mëdha ndaj kudrit udhëheqës. Praktika ka treguar se puna e mirë dhe efikase e secilit udhëheqës varet nga dija, kualifikimi, qëndrimi, gjykimi, etika, autoriteti, sjellja, roli pedagogjik i tij ndaj vartësve, kreativiteti, aftësia për analiza dhe sinteza të fenomeneve të sigurisë, etj. Por, kurrë nuk mund të gjendet ndonjë mënyrë universale e udhëheqjes, as njdonjë model i udhëheqjes që mund të shërbejë në të gjitha situatat. Kjo tregon se përgatitja dhe zhvillimi i kuadrit në institucione të sigurisë, të cilat janë shumë specifike, është çështje shumë komplekse. Këtu duhet të kihet parasysh një sërë faktorësh. Për hartimin dhe zbatimin e programit përkatës për zhvillimin dhe arsimimin e kuadrit udhëheqës, pa të cilin nuk mund të imagjinohet udhëheqja, sidomos në kushtet e ndryshimeve të shpejta shoqërore, është e nevojshme të hartohen programe të avanuara arsimore për udhëheqje.

Në procesin e operacionalizimit të detyrave strategjike dhe kryerjen e aktiviteteve të sistemit të sigurisë në planin operativ, taktik, metodologjik, teknik, etj., me interaksionin e nevojshëm të nënsistemeve, mund të vështrohen qartë objektivat e strategjisë së sigurisë. Me këtë rast mund të shihet se a ofrojnë ato mundësi optimale për arritjen e objektivave të politikës globale të sigurisë. Këtë e themi për shkak se dinamika, kompleksiteti dhe paparashikueshmëria e madhe e situatës së sigurisë, e cila përballet me sfida të shumta e të mëdha për shoqërinë, detyrimisht kushtëzon që tiparet e strategjisë së sigurisë të jenë rezultat i njohurive shkencore dhe zbatimit të metodologjisë së hulumtimeve shkencore të të gjitha vatrave të rrezikut, të cilat duhet të zënë vend të veçantë në të gjitha vlerësimet e rrethanave të sigurisë dhe të të gjithë faktorëve relevantë që mund të kenë ndikim negativ në fushën e sigurisë. Vetëm në bazë të këtyre njohurive dhe të vlerësimeve të sakta të indikatorëve të situatës së sigurisë, të shqyrtuar në mënyrë teorike, shkencore e metodologjike, mund të arrihet deri te njohja objektive e situatës së sigurisë. Pikërisht kjo është fundament për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve përkatëse. Megjithatë, në rrugën e njohjes së situatës shfaqen vështirësi të shumta, prandaj është shumë e vështirë që të vlerësohen drejt të gjitha aspektet e situatës së sigurisë. Për këtë arsye, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet befasive eventuale gjatë veprimit operativ e taktik të nënsistemeve. Parakusht për këtë është organizimi

profesional i bartësve të veprimit dhe i subjekteve të sistemit, sidomos në shoqëritë me dallime të mëdha politike, historike, kulturore, sociale, etj., të cilat kanë ndikim të madh. çdo padituri, paaftësi, joprofesionalizëm, mungesë e dimensionit etik, etj., shkakton probleme të mëdha në punën e organeve të sistemit të sigurisë. Për këtë arsye, profesionalizmi është një prej faktorëve më të rëndësishëm në punën e organeve dhe institucioneve të sistemit të sigurisë në shoqëritë demokratike. Në rendin demokratik rëndësi e veçantë i kushtohet marrëdhënieve të subjekteve të sistemit të sigurisë ndaj qytetarëve dhe opinionit publik, si dhe përshtatjes së sistemit të sigurisë me situatën e sigurisë.

Aftësitë profesionale paraqesin parakushtet kryesore të elementeve të sistemit të sigurisë për eliminimin dhe sqarimin e situatave komplekse të sigurisë. Këtu hyjnë dija, profesionalizmi, durimi dhe këmbëngulësia gjatë operacioneve të këtyre elementeve. Koncepti i profesionalizmit dhe kontrollit të brendshëm realizohet nëpërmjet autonomisë së nevojshme të bartësve dhe subjekteve të shumta të elementeve të sistemit të sigurisë. Duke pasur parasysh faktin se funksioni i këtyre elementeve ka karakter dhe rëndësi publike, profesionalizmi bëhet gjithnjë e më shumë imperativ i aktiviteteve të këtyre subjekteve. Profesionalizmi me dimension human e etik i forcon moralisht strukturat e sigurisë, gjë që paraqet pengesën kryesore për punë joprofesionale në fushën e sigurisë. çdo nivel i profesionalizmit mund të qëndrojë aty sa organet dhe institucionet e sistemit të sigurisë gëzojnë autoritet në opinion. Por, profesionalizmi kërkon edhe zbatimin adekuat të ligjeve. Në këtë kontekst duhet të vështrohet edhe nevoja për profesionalizimin adekuat të strukturave të sigurisë, të cilat duhet të veprojnë në kornizat e të drejtave, obligimeve dhe autorizimeve të tyre, sipas njohurive teorike, sipas karakterit specifik në shoqëri dhe sipas kompetencave të tyre. Filozofia profesionale, në qoftë se përcillet nga kodi etik i sjelljes dhe nga njohuritë mbi fushën e caktuar të sigurisë, rezulton me formësimin e zgjidhjeve kreative të problemeve heviroistike gjatë marrjes së vendimeve në situata specifike të sigurisë. Pa përmbushjen e kërkesave të nevojshme profesionale dhe respektimin e vlerave të gjithëpranueshme gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme në fushën e sigurisë, subjektet e sigurisë nuk do të mund të merrnin vendime kompetente. Zyrtarët e këtyre subjekteve nuk do të njihnin të drejtat dhe autorizimet e tyre dhe mënyrën e zgjidhjes së problemeve të ndryshme që kanë nivel të ndryshëm kompleksiteti.

Përveç profesionalizmit, i cili është tipar relevant i strategjisë së sigurisë gjatë veprimit operativ e teknik, si edhe parimeve tjera të rëndësishme, rëndësi të veçantë ka edhe operativiteti. Veprimi operativ është i kushtëzuar nga metodat dhe mjetet përkatëse të cilat zbatohen në një periudhë të caktuar kohore. Në këtë veprim ndikojnë shumë faktorë objektiv dhe subjektiv. Këto veprime janë të domosdoshme

sidomos në procesin e parandalimit dhe zbulimit të kriminalitetit të organizuar. Në to angazhohen subjekte të shumta të sigurisë, të cilat duhet të reagojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase ndaj problemeve të sigurisë. Veprimtaria operative e organeve të sigurisë përbën bazën e veprimit të këtyre organeve. Gjatë veprimit të tyre, ato duhet të gjejnë dhe zbatojnë forma të tilla të aktiviteteve, të cilat sigurojnë efikasitetin e nevojshëm për parandalimin, zbulimin dhe shkatërrimin e të gjitha formave të dhunës që kërcënojnë situatën e sigurisë në shoqëri. Për veprim operativ janë relevante shpejtësia, saktësia dhe efikasiteti i kryerjes së detyrave konkrete. Për kryerjen me sukses të detyrave është i nevojshëm organizimi i strukturave të nënsistemit i cili do të mundësojë shfrytëzimin e taktikës, teknikës dhe metodikës së nevojshme dhe shfrytëzimin e të dhënave informative. Kështu organizimi i këtyre strukturave do të rezultojë me gjetjen e zgjidhjeve më optimale gjatë procesit të realizimit të detyrave operative për zgjidhjen e problemeve në fushën e sigurisë. Realizimi i këtyre objektivave duhet të ketë pikënisje rezultatet shkencore të taktikës, teknikës dhe metodikës kriminalistike, të kriminologjisë dhe sidomos të shkencës së sigurisë dhe disiplinave tjera shkencore. Nëpërmjet tyre, organet e sigurisë do të kryejnë shpejt veprimet e sigurisë për kryerjen e detyrave të caktuara. Të gjitha këto aktivitete duhet të kryhet me shpejtësi dhe në pajtim me kërkesat e shtruara gjatë planifikimit të situatës operative. Vetëm zbatimi profesional i masave operative, sidomos nga kuadri drejtues, mund të sigurojë veprim profesional. Kjo, para së gjithash, pasqyrohet në hulumtimin, njohjen dhe studimin e të gjitha aspekteve të nevojshme për avancimin e shkallës së efikasitetit në punë. Vetëm në këtë mënyrë është e mundur që, në bazë të strategjisë së hartuar paraprakisht të veprimit operativ të planifikohen mirë aksionet dhe të përcaktohen qartë metodat, masat, veprimet dhe mjetet operative e taktike që do të jenë të nevojshme gjatë operacionit. Kështu do të përcaktohet operativiteti strategjik, kurse disiplina operative e cila përfshin kryerjen e detyrave në mënyrë të përgjegjshme, të saktë, të shpejtë e precize që dalin nga plani global i aksionit konkret operativ ose lëndën konkrete operative, është pjesë përbërëse e planit operativ të hulumtimeve. Në praktikën operative është definuar qartë qëndrimi se kryerja e detyrave konkrete dhe realizimi i objektivave të përcaktuara në bazë të hulumtimeve paraprake operative, gjendjes, lëvizjes dhe parashikimeve në fushën e sigurisë, varet nga shpejtësia, saktësia dhe kohëzgjatja e veprimtarisë operative.

Organizimi i luftës kundër të gjitha vatrave të pasigurisë buron nga baza ligjore e miratuar nga organet ligjvënëse dhe politika globale e sigurisë e miratuar nga po këto organe. Trupat ligjvënëse përcaktojnë autorizimet e të gjithë bartësve të sistemit të sigurisë. Në këtë kuptim, si parim bazë del realizimi praktik i normave ligjore në kuptimin e plotë të tyre. Kjo nënkupton kryerjen me përpikëri të obligimeve që burojnë nga zgjidhjet ligjore, me qëllim të ruajtjes së sigurisë së

përgjithshme. Vetëm një qasje korrekte, e ndërgjegjshme dhe e ligjshme ndaj veprimeve të ndërmarra në pajtim me etikën profesionale i bën detyrat e sigurisë të besueshme për opinionin, kështu që operacionet e sigurisë gjegjësisht operacionet strategjike operative kërkojnë një nivel të kënaqshëm të transparencës për opinionin. Bartësit dhe subjektet e sistemit të sigurisë, gjegjësisht përfaqësuesit e tyre që kontaktojnë në qytetarë, nëpërmjet këshillave, udhëzimeve, veprimeve, vërejtjeve dhe propozimeve, sidomos në planin social preventiv, ndihmojnë afirmimin e subjekteve dhe të veprimeve të tyre si edhe ndërtimin e autoritetit të subjekteve e të sistemit të sigurisë në përgjithësi. Pa autoritetin e subjekteve të sistemit të sigurisë nuk mund as të imagjinohet pjesëmarrja e qytetarëve në hartimin e disa segmenteve konkrete të doktrinës dhe strategjisë së sigurisë. Kjo do të thotë se në bazë të klimës së krijuar dhe besimit reciprok krijohen gjasat dhe mundësitë që subjektet e përmendura t'i kryejnë me sukses dhe në mënyrë efikase obligimet e tyre. Prandaj, organet dhe subjektet e sigurisë duhet të fitojnë besimin e qytetarëve dhe operacionet e tyre duhet të jenë të pranueshme për bashkësinë shoqërore.

Duke iu përmbajtur me përpikëri kornizave kushtetuese dhe ligjore, përfaqësuesit e subjekteve të sistemit të sigurisë bëhen institucion kompetent i veprimit praktik në të gjitha situatat konfliktuale. Kështu, autonomia e subjekteve të sistemit buron nga të drejtat legjitime, autorizimet dhe kompetencat, duke u kujdesur për rëndësinë e masave juridike dhe pasojat e tejkalimeve gjatë veprimit të nënsistemeve. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet shfrytëzimit të forcave dhe mjeteve. Ato duhet të lëvizin në kufi të ligjshmërisë, në mënyrë që të mos rrezikohen të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve. Për këtë arsye, është e rëndësishme të theksohen parimet themelore determinuese, të cilat vijnë në shprehje posaçërisht gjatë operacionalizimit të planeve strategjike operative. Por, konkretizimi i çështjeve strategjike në shoqërinë demokratike duhet të bëhet gjithnjë e më shumë obligim i qytetarëve, si edhe i organeve dhe institucioneve tjera. Për këtë arsye, është shumë i rëndësishëm kuptimi i njoftimit të opinionit me veprimet konkrete të bartësve dhe subjekteve të sistemit të sigurisë. Njoftimi është shprehje e garantimit të proceseve demokratike dhe i sjelljeve në marrëdhëniet reciproke. Përveç tjerash, kjo nënkupton se operacionet duhet të jenë dukshëm më të hapura për opinionet dhe mediat, me përjashtim të rasteve kur procesi i kryerjes së detyrave zyrtare nuk kërkon rregulla të shkruara ose në rastet kur është e nevojshme që kryerja e detyrave të bëhet në fshehtësi, me qëllim të efikasitetit. Njoftimi i detajuar mbi rrjedhën e aktiviteteve të ndërmarra do të nxis opinionin që të përfshihet sa më shumë në çështje të sigurisë. Kështu, qytetarët u raportojnë organeve dhe shërbimeve të sigurisë për çështje të ndryshme relevante, të cilat përveç karakterit të sigurisë kanë edhe karakter preventiv. Në këtë mënyrë, pjesëtarëve të bashkësisë u sigurohet e drejta qytetare që nëpërmjet propozimeve, mendimeve dhe përvojave të

tyre të japin kontributin e tyre në planifikimin strategjik. Pikërisht për këtë, ligji dhe zbatimi i tij duhet të perceptohen, para së gjithash, si mbrojtje e lirive demokratike dhe e organizimit të shoqërisë. Nevoja për pjesëmarrjen aktive të opinionit dhe organizimi i subjekteve të përmendura në zbatimin e ligjshmërisë do të mundësojnë kryerjen e funksionit dhe detyrave të sigurisë sipas kërkesave, dëshirës dhe nevojës së opinionit në përgjithësi. Raporti i organeve dhe institucioneve të sigurisë ndaj qytetarëve është shumë i rëndësishëm për zbatimin e strategjisë dhe për kryerjen me sukses të aktiviteteve themelore për zgjidhjen e problemeve të sigurisë dhe për përmirësimin e kualitetit të jetës në bashkësi. Kjo do të thotë se për çdo formësim të objektivave dhe strategjisë së sigurisë dhe për implementimin efikas të tyre është e nevojshme të fitohet besimi i opinionit. Ky besim mund të fitohet vetëm nëse pjesëtarët e organeve dhe shërbimeve të sigurisë, nëpërmjet angazhimit dhe sjelljes së tyre personale, ndikojnë në zgjerimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit. Këto marrëdhënie krijohen dhe marrin një kuptim të ri pluralist, i cili eliminon tendencat për fetishizëm dhe për perceptim të aparatit shtetëror ekskluzivisht si aparat represiv. Prandaj, është e nevojshme një vetiniciativë, këmbëngulësi, durim, objektivitet dhe përgjegjësi e madhe në kryerjen e detyrave. Po kështu, nevojitet qasje korrekte, drejtësi, maturi dhe stabilitet psikik me rastin e përdorimit të mjeteve të detyrimit, si edhe definim preciz i masave dhe veprimeve për kryerjen e detyrave konkrete. Pjesëtarët e organeve dhe shërbimeve të sigurisë duhet të jenë të kujdesshëm gjatë verifikimit të saktësisë së të dhënave të cilat janë rezultat i veprimeve operative. Gjatë reagimit në situata specifike, ata duhet të dëshmojnë profesionalizëm, aftësi, përshtatshmëri, mirëkuptim vetëbesim, përkushtim, përkujdesje dhe të jenë diskret. Kjo vlen sidomos gjatë aktiviteteve të rregullta dhe gjatë operacioneve për eliminimin e sjelljeve negative. Subjektet e sistemit të sigurisë duhet t'i kushtojnë kujdes vetëpërmbytjes, në mënyrë që të mos i tejkalojnë autorizimet dhe kompetencat e tyre gjatë realizimit të detyrave. Tejkalimi i autorizimeve të përcaktuara me ligj mund të rrezikojë të drejtat dhe liritë e njeriut më shumë se sa organet dhe shërbimet e sigurisë mund t'i mbrojnë ato. çdo sjellje e pakuptueshme dhe e paarsyeshme, pashmangshëm shpie deri te situatat konfliktuale. Prandaj, opinioni pret dhe kërkon me të drejtë që organet e sigurisë t'i respektojnë parimet e përgjithshme të demokracisë dhe të drejtat themelore dhe liritë e njeriut, gjatë zbatimit të operacioneve. Kështu, organet dhe institucionet e sigurisë duhet t'i japin prioritet qasjes preventive, e cila i hap rrugë krijimit të parakushteve për ndërmarrjen e iniciativave të reja për bashkëveprim. Vetëm duke aplikuar metodat moderne të punës publike, veprimi konkret operativ fiton besimin e opinionit, gjë që bëhet faktor kryesor për parandalimin e të gjitha dukurive dhe sjelljeve negative në shoqëri.

çdo strategji e hartuar, pra edhe ajo e sigurisë, ka metodat e saj të cilat burojnë nga faktorët e përmendur, nga parimet themelore dhe nga mjetet përkatëse. Kjo bën që strategjia e sigurisë të realizojë objektivat e planifikuara. Në bazë të kësaj, aktivitetet duhet të bazohen në kontaktet e vazhdueshme dhe interaksionin e planifikuar ndërmjet nënsisitemeve të cilat sigurojnë njohje përmbytjesore reciproke e sidomos opinionit publik. Pra, opinionit publik duhet të njoftohet se ruajtja e disa segmenteve të sigurisë varet nga shkalla e informimit. Por, informatat duhet të bazohen në njohuritë shkencore, profesionale dhe operative, në mënyrë që të krijohen mundësi për përmirësimin dhe plotësimin e strategjisë. Në këtë mënyrë organet dhe shërbimet e sigurisë bëhen më funksionale dhe më efikase. Prandaj, format e reja të organizimit të sistemit bashkëkohor të sigurisë në të gjitha nivelet e hierarkisë, si edhe përsosja e metodologjisë në kuptim të analizës, përcjelljes sistematike, vëzhgimit të intensitetit dhe marrëdhënieve të dukurive të sigurisë, kontribuon për propozimin dhe gjetjen e zgjidhjeve më të mira dhe më efikase. Vlerësimet e sakta dhe reale të shkallës së rrezikshmërisë e forcojnë besimin në aftësinë dhe efikasitetin e subjekteve të sistemit të sigurisë. Kjo bën që edhe në rrethana shumë komplekse të sigurisë dhe në rrethana të kundërshtive të thella organet dhe shërbimet e sigurisë të ruajnë nivelin e nevojshëm të shkallës së sigurisë. Ky sukses varet shumë nga koherenca e veprimeve metodologjike të sistemit. Kjo shpie në përfundimin se vetëm në këtë mënyrë mund të realizohen objektivat e dëshiruara. Metodatat e strategjisë së sigurisë janë shumë të rëndësishme, pasi “metoda duhet t’i përshtatet objektit ndaj të cilit zbatohet” (Hegeli). Në rastin tonë objekt është siguria. Gjatë shqyrtimit të metodave më kryesore, në rend të parë duhet të vendoset prognozimi strategjik. Pa këtë parim metodologjik do të jetë e pashmangshme shfaqja e tendencave negative në përballje me problemet e karakterit të sigurisë.

Kur bëhet fjalë për rëndësinë e metodave duhet të respektohen të gjithë përcaktuesit relevantë që ndikojnë në mekanizmat institucionalë të sigurisë gjegjësisht sjelljet e tyre të ligjshme e demokratike me rastin e planifikimit të veprimeve konkrete. Shqyrtimi dhe prognozimi cilësor strategjik krijon mundësi që në mënyrë të qëndrueshme të shqyrtohen të gjitha aspektet e operacioneve të sigurisë, duke përfshirë edhe befasitë eventuale dhe gjetjen me kohë të zgjidhjeve alternative, në mënyrë që të evitohet përkeqësimi i situatës së sigurisë. Për këtë arsye është e domosdoshme të bëhen analiza të planifikuara e sistematike, të përcillen dhe të vërehen me kohë ndryshimet e karakterit të sigurisë, efektet që arrihen me masa të planifikuara, format e ndryshme të befasisë, si edhe reagimet me kohë, zgjidhjet alternative dhe analiza e kualitetit të masave preventive e represive. Këto janë vetëm disa aspekte që ndikojnë në mënyrën e veprimit dhe prognozimin e përcaktimin e prioriteteve gjatë veprimit konkret operativ.



Konkretizimi i masave dhe aktiviteteve operative taktiko-teknike nuk mund të jetë i suksesshëm nëse ato nuk janë rezultat i diskutimit paraprak strategjik në të gjitha nivelet e hierarkisë dhe nëse nuk marrin pjesë aktive në marrjen e vendimeve relevante që kanë të bëjnë me veprimet praktike edhe vartësit e hierarkisë drejtuese të organeve dhe institucioneve të sistemit të sigurisë. Prandaj, të gjitha aktivitetet duhet të zhvillohen në bazë të njohurive të fituara dhe aftësive individuale. Është sidomos e rëndësishme që njohuritë e fituara nga veprimtaritë praktike të shfrytëzohen në realitetin e ri shoqëror, gjegjësisht në organizimin e ri me shkallë të lartë të sistematizimit operativ. Kështu, kuadri konceptual i strategjisë së sigurisë në të ardhmen do të artikulojë elementet relevante organizative, drejtuese, parashikuese, materiale, planifikuese, informative, etj., prej të cilave buron veprimtaria e tërësishme operative.

Qasja e re organizative dhe strategjike e operative detyrimsht nënkupton reagimin shumë efikas, të shpejtë dhe të matur në situata të komplikuar, si edhe manifestimin e shkallës së lartë të invencionit, aftësisë për zgjidhjen e problemeve të tanishme dhe vlerësimin efikas të situatës së sigurisë. Rëndësi të veçantë meriton studimi i detajuar i përvojave tjera nga fusha e sigurisë, në mënyrë që nëpërmjet krahasimit të nevojshëm të eliminohen ato segmente që mund të ndikojnë në dinamikën e reagimit në rrethana të caktuara. Në këto situata vjen në shprehje gjeturia operative për zgjidhjen e problemeve komplekse, qasja e pjekur dhe gjykimi, ligjshmëria e zbatimit të autorizimeve të caktuara, matura dhe rezistenca ndaj streseve të ndryshme eventuale, si edhe vështirimi konstant, i balancuar dhe autoritativ i veprimit, pavarësisht se deri në ç'masë mund të komplikohet situata e sigurisë. Kjo ka të bëjë sidomos me sistemin e policisë.

Pluralizmi i ideve, mendimeve, pikëpamjeve dhe qëndrimeve në të gjitha segmentet e sigurisë, si edhe forcimi i komponentës së vlerave utilitare, intelektuale dhe profesionale për zgjidhjen optimale të problemeve të sigurisë, i jep një ton, dinamikë dhe vendosmëri të gjitha fazave të zbatimit të detyrave të sigurisë. Ndër të tjera, kjo ka për qëllim edhe që në mënyrë të kuptueshme dhe adekuate të perceptohet strategjia e sigurisë, me theks të veçantë në zbatimin e pluralizmit të metodave pa të cila nuk mund të ketë veprim efikas. Metodatat mundësojnë që nëpërmjet zgjedhjes së aktiviteteve më shembullore të reagohet shumë shpejt e në mënyrë fleksibile, në përshtatje me ndryshimet dinamike dhe problemet e sigurisë që manifestohen në shtetet demokratike. Në këtë mënyrë pozicioni i ri i të gjitha niveleve hierarkike të sistemit të sigurisë siguron formë të re e kreative për krijimin e ideve operative për pranimin e tyre nga nënsistemet dhe për rritjen e interesimit për dhënien e propozimeve me qëllim të zgjidhjes së problemeve të tanishme. Kjo

ka ndikim të konsiderueshëm në përmbushjen e detyrave dhe në suksesin e punës. Në rrethanat e reja transparente rëndësi të veçantë i kushtohet edhe zhvillimit shkencor, profesional e operativ dhe punës krijuese. Kjo ndikon ngritjen e cilësisë, rritjen e motivit të individëve dhe stimulimin e kërkimit të zgjidhjeve më efikase. Kështu manifestohet gjithnjë e më shumë identifikimi i njerëzve me orientimet krijuese e progresive në kuadrin e nënsistemeve në tërësi. Rëndësi të jashtëzakonshme ka perceptimi i të gjitha niveleve të subjekteve të sistemit të sigurisë si struktura dinamike organizative që duhet të krijojnë në vazhdimësi hapësirë për komunikim, për liri të shprehjes së qëndrimeve dhe për ide të reja organizative e taktike. Vetëm në këtë mënyrë i hapet rrugë orientimit pluralist në perspektivë dhe diskutimit mbi pjesëmarrjen e individëve në krijimin e përmbajtjeve operative. Me interes të veçantë për planifikim, analizë, vendim dhe zbatim të masave adekuate është edhe siguri i me kohë i informacioneve të sakta. Mungesa e çdo informacioni, sidomos me karakter informativ, si edhe pengimi i qarkullimit të tyre dhe e kanalizimit sipas përmbajtjes e kuptimit të tyre, e kufizon qenësisht efikasitetin në punë. Pra, duhet të thuhet se nuk ka njohuri dhe veprime të drejta operative pa informacione relevante. Prandaj, transparenca e bartësve dhe subjekteve të sistemit të sigurisë, individëve brenda strukturës organizative u ofron informacione të mjaftueshme mbi planet dhe veprimet e rëndësishme operative. Kjo njëkohësisht paraqet një formë të mirë komunikimi, nëpërmjet të cilës vendoset një bashkëpunim i ngushtë e profesional midis strukturave të nënsistemeve të sigurisë për zgjidhjen e problemeve vitale të sigurisë. Kjo do të thotë se hartimi dhe zhvillimi i masave të suksesshme në veprimin konkret të organeve dhe shërbimeve të sigurisë kërkon përpunimin e vazhdueshëm të informacioneve me karakter shkencor e profesional, sidomos kur bëhet fjalë për ndërmarrjen e masave specifike që kërkojnë aftësi, profesionalizëm dhe përgjegjësi të lartë.

Gjetja e metodave më të reja duhet të jetë detyrë e përhershme e shërbimeve të sigurisë. Vetëm kështu është e mundur të avancohen të gjitha segmentet e punës dhe të krijohen raporte të mira bashkëpunimi midis nënsistemeve. Kjo vjen në shprehje gjatë implementimit të detyrave që duhet t'u përshtatet vlerave demokratike të shoqërisë civile. Këtu kanë rol të veçantë mjetet e strategjisë së sigurisë. Si mjete themelore konsiderohen vlerësimet e situatës së sigurisë, vlerësimet politike e të sigurisë, informacionet e karakterit të sigurisë të cilat japin sistemet e krijuara në kuadrin e organeve dhe shërbimeve të sigurisë, informacionet e organeve gjyqësore, etj. Këtu mund të radhiten edhe autorizimet e dhëna për zbatimin e masave ligjore, për përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme, sidomos për përdorimin e mjeteve të detyrimit, të mjeteve speciale të veprimit në rrethana të ndjeshme e komplekse të sigurisë, planet e përgjithshme dhe konkrete të bazuara në politikën globale të sigurisë, etj. Edhe këtu bëhet fjalë për çështje shumë

komplekse të cilat kërkojnë qasje shumë studioze dhe analiza të praktikave të deritashme. Për këtë arsye duhet të zhvillohen elementet e bashkëpunimit me qëllim të veprimit harmonik të të gjitha strukturave të sigurisë. Kështu këshillojnë të gjitha proceset dinamike, organizative dhe profesionale, të cilat zhvillohen në fazën e hartimit të politikës së sigurisë dhe formësimit të praktikës së sigurisë, me qëllim të sigurimit të transparencës sa më të madhe dhe komunikimit me shoqërinë. Të gjitha proceset pozitive që zhvillohen në planin organizativ, shkencor, profesional, operativ, praktik, teknik, informativ, komunikativ, arsimor, etj., duhet të perceptohen si nevojë për krijimin e koncepcioneve optimale dhe të orientimeve të sigurisë. Pra, vetëm në bazë të shqyrtimit dhe elaborimit kritik të vlerave të reja demokratike të strukturave të sigurisë duhet të aplikohen metodat dhe mjetet bashkëkohorë me qëllim të mbrojtjes maksimale të sigurisë në shoqëri.

## **2. ZHVILLIMI I STRATEGJISE SHOQERORE PËR PERBALLIMIN E KRIMINALITETIT**

Zhvillimi i strategjisë shoqërore për parandalimin e kriminalitetit ka ngecur mjaft karshi represionit, i cili është komponentë themelore për përballimin e kriminalitetit. Kësaj i ka kontribuar politika kriminale, e cila ka ndryshuar paralelisht me ndryshimet shoqërore, ndërsa në fushën e preventivës ka ngecur vazhdimisht dhe ka mbetur pothuaj vetëm deklarative. Një prej frenuesve kryesorë të zhvillimit të strategjisë parandaluese ka qenë mungesa e një studimi të bazuar të shkaktarëve të veprimeve kriminale dhe pengesave në sjelljen shoqërore, të cilat nuk është e thjeshtë të vështrohen në mënyrë të gjithanshme.

Krizat sociale dhe ekonomike kanë ndikuar negativisht dhe u kanë shkuar përshtati synimeve për zgjidhje të shpejta e të drejtpërdrejta, me programe të ndryshme të hartuara ad hoc, synim i të cilave ka qenë arritja e rezultateve në luftimin e kriminalitetit. Natyrisht, kjo nuk i ka shkuar përshtati hartimit të planeve dhe programeve të menduara, të cilat mund të japin rezultate preventive. Dekadat e fundit, preventiva nuk është zhvilluar përtej deklaratave, të cilat, zakonisht, janë dhënë sipas nevojës së politikës ditore. Pasojë e mungesës së programeve cilësore preventive është edhe ngecja e zhvillimit teorik të saj, prandaj sot kemi një sërë idesh e propozimesh të lloj-llojshme, gjë që e vështirëson një realizim konkret të tyre.

Është plotësisht e qartë se kundërvënja kriminalitetit, sidomos ajo preventive, duhet të ketë themel të konceptit programor faktin së kriminaliteti nuk mund të vështrohet

edhe më tutje si problem që ka të bëjë me sjelljen e individit apo të grupit kriminal, por si problem që ka të bëjë me shoqërinë globale. Sot është gjithnjë e më i pranueshëm koncepti mbi kriminalizimin e shoqërisë. Ky nuk është rezultat i ndonjë qasjeje të re teorike ose ndonjë koncepti të ri kriminalistiko-politik, por pasojë e faktit real se kriminaliteti po përfshin pothuaj të gjitha fushat e jetës, përkatësisht shoqërinë në tërësi. Së këndejmi, strategjia e kundërvënies së kriminalitetit nga ana e shoqërisë, qoftë nëpërmjet metodave represive qoftë nëpërmjet metodave preventive, kërkon detyrimsht një qasje gjithëpërfshirëse dhe globale. Do të ishte gabim që vetë strategjia të përkufizohej në fusha të ngushta, pavarësisht se bëhet fjalë për përfshirje më të vogël apo më të madhe të programeve preventive apo për fusha të përfshira në kriminalitet.

Përpjekjet e shumicës së shoqërive perëndimore që të animojnë bartësit e pushtetit politik si edhe të bartësve të politikës kriminale, me qëllim të hartimit të programeve gjithëpërfshirëse dhe cilësore preventive, kryesisht kanë përfunduar pa sukses. Kjo është pasojë e të metave dhe mangësive të programeve dhe e mungesës së gatishmërisë së shoqërive që programet e hartuara të zbatohen me përpikëri.

Megjithatë, në vitet '70 parandalimi i kriminalitetit ka qenë pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të organeve shtetërore. Angazhimet e disa subjekteve shoqërore në planin preventiv kanë qenë obligime të përcaktuara me ligjet e atëhershme të vetëmbrojtjes shoqërore. Kësaj i ka shkuar përshtati klima e përgjithshme shoqërore, evolucioni i koncepteve themelore teorike mbi kundërvënien ndaj kriminalitetit nga të cilat është inspiruar strategjia, si edhe disa programe preventive në hapësirat tjera të sjelljes së papërshtatshme dhe kundër-shoqërore (p.sh. në fushën e devijimeve sociale, alkoolizmit, narkomanisë, etj.). Mangësi kryesore përpjekjeve preventive kanë qenë pikëpamjet individuale e shoqërore se shkatërrimi i kriminalitetit është mënyra më efikase e parandalimit të tij.

Koncepti teorik për parandalimin e kriminalitetit dhe të dukurive tjera devijonte nuk ka gjetur terren të përshtatshëm në shoqëri, pasi shoqëria nuk ka qenë e gatshme të bëjë diçka më shumë në këtë plan. Qasja deklarative e politike ndaj aktiviteteve parandaluese nuk është shoqëruar me aksione të drejtpërdrejta. Vetëmbrojtja shoqërore, e cila është konceptuar kryesisht si kategori ideologjike dhe vetëqeverisëse, më shumë është përqendruar në manifestimet e jashtme të kriminalitetit se sa i është kundërvënë realisht. Nëpërmjet formave të ndryshme të aktivitetit e të fushatës mediale, vetëmbrojtja shoqërore është paraqitur më shumë i rend ideo-politik e juridik, i cili e ka trajtuar kriminalitetin më shumë si manifest se sa si dukuri etiologjike.

Vetëmbrojtja shoqërore është e proklamuar si sistem i organizuar i mbrojtjes së rendit kushtetues e juridik , të drejtave dhe lirive të qytetarëve, sigurisë personale dhe pasurisë së tyre, si dhe i mbrojtjes së shoqërisë nga kriminaliteti dhe dukuritë tjera negative. Model themelor i realizimit të këtyre objektivave ka qenë integrimi dhe bashkëpunimi i organeve shoqërore dhe shtetërore me qytetarët. Ideja themelore e vetëmbrojtjes shoqërore haset në konceptin fillestar të revolucioneve dhe kryengritjeve të armatosura. Ajo është proklamuar së pari në programin ideorë të Komunës së Parisit, në vitin 1871. Më vonë kjo ide është plasuar edhe në vende të tjera, si në ish-Jugosllavi. Sipas konceptit themelor, vetëmbrojtja shoqërore duhet të bashkonte të gjitha subjektet në luftën kundër kriminalitetit dhe dukurive tjera negative. Masat e vetëmbrojtjes shoqërore kanë qenë të orientuara drejt realizimit të sigurisë shoqërore dhe mbrojtjes së vendit, mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të qytetarëve, sigurimit fizik e teknik të objekteve e pasurisë, kontrollit të punës, mbrojtjes së sekreteve zyrtare e afariste të organizatës punuese dhe ndërmarrjes së masave në rrethana të jashtëzakonshme. Sipas teorisë së vetëmbrojtjes shoqërore, kuadri dhe institucionet e specializuara profesionale paraqesin bazën e politikës kriminalistike, e cila paraqet faktor kryesor në sferën e mbrojtjes nga format e ndryshme të kriminalitetit.

Kjo qasje e përgjithshme mbi karakterin e politikës kriminale nuk ka gjetur zbatim praktik në kornizat e vetëmbrojtjes shoqërore. Përgjithësimi, deklarativizmi dhe pajtueshmëria parimore me normat ideore, politike dhe juridike të vetëmbrojtjes shoqërore nuk ka përmbushur kërkesat e shtruuara ndaj subjekteve të vetëmbrojtjes shoqërore, për shkak të mungesës së programit bazë për realizimin praktik të këtyre kërkesave. Megjithatë vetëmbrojtja shoqërore formalisht ka qenë sistemi më gjithëpërfshirës i mbrojtjes së shoqërisë dhe vlerave të saj themelore, zyrtarisht është propaganduar se ajo nuk është e organizuar si institucion i veçantë shoqëror ose shtetëror, i cili ka për detyrë funksionalizimin e mbrojtjes dhe sigurisë. Sipas teorisë, aktiviteti i vetëmbrojtjes shoqërore, para së gjithash, bazohej në përfshirjen e vetëdijshme dhe vullnetare të qytetarëve. Në viti 1992 në ish-Jugosllavi ishte ndërprerë ekzistimi formalo-juridik i vetëmbrojtjes shoqërore, e cila nuk është përfshirë në kategoritë kushtetuese e ligjore.

Programi i vetëmbrojtjes shoqërore bazohej në format dhe manifestimet e shfaqjes së kriminalitetit, duke përjashtuar qasjen themelore analitike e hulumtuese, e cila konsiderohej e padëshirueshme. Kështu vetëmbrojtja shoqërore bazohej kryesisht në modelin klasik “shoqëri pa të meta”, prandaj asaj i ka munguar një qasje më e thellë dhe më e bazuar. Kështu shoqëria është përballur me shkaqet e kriminalitetit brenga saj, gjë që ka ndikuar në rrezikimin e konceptit fillestar të vetëmbrojtjes shoqërore. Pa dyshim, kjo i ka kontribuar dukshëm tolerancës së shoqërisë ndaj

njerëzve me prirje për sjellje devijante, gjegjësisht shfaqjes së problemeve për integrimi e tyre në jetën shoqërore e ekonomike. Problemi i kriminalitetit është vënë kryesisht në lidhshmëri me kriminelët, ndërsa ka lënë pas dore rrethin shoqëror.

Strategjia formale juridike dhe ideologjike ka qenë për shumë kohë pikënisje dominuese në parandalimin primar të kriminalitetit. Modeli vetëqeverisës i vetëmbrojtjes shoqërore është nisur nga qëndrimi se efektet negative të sjelljeve kriminale mund të zëvendësohen me efekte të dëshiruara shoqërore nëse qytetarëve u ofrohen informacione të plota, të qarta dhe të sakta mbi devijimet e ndryshme të cilat janë të gjykueshme nga shoqëria. Në fund është dëshmuar se këto rezultate të veprimeve preventive të inspiruara nga vetëmbrojtja shoqërore, kanë qenë shumë të kufizuara dhe jetëshkurtra.

Megjithatë, nuk mund të mohohet se ka pasur përpjekje që disa programe preventive të hartohen mbi bazë të hulumtimeve shkencore mbi etiologjinë e kriminalitetit dhe format manifestative të tij. Para së gjithash kjo është bërë nga ata që kanë pasur pikënisje një qasje moralistike, e cila bazohej në premisat e mendjes së shëndoshë, gjë që ka rezultuar me një përparim në krahasim me gjendjen paraprake. Por, në qasjen ndaj këtij problemi të rëndësishëm ka pasur dallime të theksuara. Meqenëse këto premisa fillestare kanë qenë shumë të përgjithësuara, gjë që ka shkaktuar pikëpamje mjaft të ndryshme dhe jo të analizuara, është shfaqur problemi i operacionalizimit të konceptit gjatë përpunimit të programit primar preventiv.

Fakti se preventiva duhet të burojë nga rezultatet e hulumtimeve shkencore të objektivave kërkon institucionalizimin e preventivës, si edhe lidhjen e saj me mekanizmin organizativ-institucional të institucioneve të specializuara. Në zbatimin e programit preventiv do të duhej të angazhohej kuadri profesional, institucionet profesionale dhe ekspertët, sidomos në disa faza të zbatimit të programit. Veprimi i tillë është i rëndësishëm sidomos nga pikëpamja e institucionalizimit të realizimit efikas të preventivës primare në preventivën e përgjithshme të kriminalitetit. Në sistemin e vetëmbrojtjes shoqërore kanë munguar ose kanë qenë sporadike hulumtimet përkatëse dhe programimi i kriminalitetit. Edhe kur janë bërë, ato kanë qenë jashtë kornizave teorike e hipotetike dhe orientimeve disiplinare, sidomos lidhur me disa lloje të kriminalitetit, prej të cilave asokohe ka dominuar kriminaliteti ekonomik. Mungesa e një modeli të preventivës kualitative është shprehur negativisht në preventivën primare, për shkak se shkatërrimi i kriminalitetit i është ngarkuar disa organeve shtetërore (policisë, gjyqësisë, etj.), të cilat veprimtarinë e tyre e mbështesin në ligj. Prandaj, veprimtaria e tyre në kuadrin e vetëmbrojtjes shoqërore nuk ka qenë e definuar qartë.

Pavarësisht prej mangësive të shumta të preventivës në planin e përgjithshëm shoqëror, disa forma të preventivës së vetëmbrojtjes shoqërore kanë bërë një progres të pjesshme në krahasim me gjendjen e mëparshme. Vërejtjet që mund t'u bëhen këtyre formave të preventivës, siç është thënë, kanë të bëjnë me orientimin programor të tyre. Ato kanë qenë jo mjaft diskriminuese, për shkak se kriminaliteti nuk është trajtuar në mënyrë eksplicite dhe implicite si problem etiologjik, që do të thotë se problemi nuk është trajtuar në mënyrë të thelluar, e cila është komponentë e çdo planifikimi dhe programimi preventiv.

Meqenëse programimi i preventivës në kuadrin e vetëmbrojtjes shoqërore nuk është bazuar në karakteristikat etiologjike të kriminalitetit, aktiviteti preventiv është shndërruar kryesisht në deklarata dhe më pak në komponentët tjera të domosdoshme për veprim të suksesshëm preventiv. Kjo do të thotë se mbështetja e pamjaftueshme e programit preventiv ka qenë pasojë e mungesës së komponentës etiologjike të modelit preventiv. Çdo program preventiv kërkon detyrimisht qasje etiologjike shumë të bazuar, prandaj programet e vetëmbrojtjes shoqërore kanë pasur mangësi të shumta. Midis faktorëve kufizues që duhet të evitohen është edhe forma stereotipe e konceptimit të përmbajtjeve programore të preventivës primare. Emëruesi i përbashkët i këtyre programeve ka qenë qasja racionalistike, gjegjësisht ofrimi i sa më shumë informacioneve mbi dukuritë ose fenomenet e padëshiruara në sjelljen e shoqërisë të cilat duhet të parandalohen. Disa mjete shoqërore teknike e shprehëse dhe aktiviteti propagandues masovik kanë qenë gjithashtu të bazuara në një qasje tradicionaliste.

Kufizime të konsiderueshme kanë qenë edhe pasojë e vështirimit të ngushtë të problemit të kriminalitetit, i cili është trajtuar kryesisht si problem juridik. Kështu është anashkaluar fakti se kriminaliteti nuk është vetëm problem juridik, por edhe problem shoqëror. Kjo ka bërë që të përjashtohet ose kufizohet pjesëmarrja e disa ekspertëve të fushave të caktuara, siç janë psikologët, pedagogët, mjekët, etj.

Nga këto kufizime në konceptimin dhe programimin e preventivës dalin vështirësi të shumta. Disa bartës të programit preventiv, në aktivitetin e tyre mbeten të vetmuar ose e humbin shumë shpejt motivimin, për shkak se e shohin se përpjekjet e tilla nuk janë proporcionale me obligimet e përgjithshme, të cilat janë të domosdoshme për preventivë të suksesshme. Lidhja organizative e institucionale me sistemin e gjerë social gjatë zbatimit të çfarëdo programi preventiv ka rëndësi të jashtëzakonshme. Ajo nuk mund të realizohet pas pjesëmarrjes së ekspertëve, të cilët i krijojnë këto lidhje dhe u japin atyre përmbajtje preventive konkrete.

Mungesa e koordinimit me sistemin social shkakton rënien e interesimit dhe të motivimit. Kështu parandalimi i kriminalitetit bëhet si veprimtari e dorës së dytë, marginalizohet dhe u besohet subjekteve më pak të rëndësishme, joformale e jo-institucionale, ose formave sporadike apo deklarative të kundërvënies së kriminalitetit. Kështu luftimi i kriminalitetit është kufizuar në një numër më të vogël të organeve shtetërore, ndërsa parandalimi i kriminalitetit u është lënë subjekteve tjera, të cilat e kanë bërë këtë vetëm në mënyrë deklarative. Së këndejmi, preventiva e kriminalitetit dhe devijimeve tjera është bërë “tokë e askujt”, duke mbetur midis organeve shtetërore dhe bashkësisë shoqërore.

Është i pamohueshëm fakti se organet gjyqësore, organet e punëve të brendshme dhe, në një masë të konsiderueshme, edhe organet tjera shtetërore kanë subjekt themelor luftimin e kriminalitetit, pra edhe parandalimin e tij. Mirëpo këto organe nuk mund të jenë të suksesshme pa një organizim institucional gjithëpërfshirës, financiar e programor, dhe pa një mbështetje të institucioneve simotra shtetërore e shoqërore. Është e rëndësishme të theksohet gjithashtu se përveç faktit që preventiva në sistemin e vetëmbrojtjes shoqërore është bërë në mënyrë josistematike dhe jo të koordinuar. Faktikisht ajo është bërë veprimtari e marginalizuar, e cila nuk ka përfshirë përpjekjet e vendosura për progres. Preventiva, si ide apo si program nuk ka arritur realizohet dhe as të shtrihet të shtresat e gjera shoqërore, përveç se në mënyrë deklarative. Kjo është pasojë e përpjekjeve për idealizimin e imazhit të shoqërisë, i cili nuk është lejuar të priset nga çfarëdo kritike apo vërejtjeje për gjendjen ekzistuese.

Edukimi i qytetarëve mbi luftimin e kriminalitetit është kombinuar me aktivitete masovike propaganduese. Në ish-Jugosllavi është konsumuar kryesisht propaganda ideologjike dhe politike, angazhimi në kuadrin e sistemit të vetëmbrojtjes shoqërore, ndërsa janë zbatuar shumë pak programet cilësore preventive. Prandaj ka pasur mangësi sa i përket objektivave të aktiviteteve preventive, ka pasur veprim deklarativ, josistematik, mangësi në lidhjen organizative të institucioneve dhe organeve gjatë hartimit dhe zbatimit të programeve. Gjithashtu kanë munguar hulumtimet themelore mbi të cilat duhet të mbështeten programet preventive.

Vetëmbrojtja shoqërore nuk ka sjell pothuaj kurrfarë ndryshimesh përmbajtjesore në fushën e politikës kriminalistike. Ndryshimet organizative e institucionale nuk kanë quar në ndryshime të rëndësishme të strategjisë, metodave, dhe teknikave të preventivës primare. Preventiva dhe represioni i kriminalitetit kanë ruajtur po ato kuptime themelore, kurse përmbajtjet e tyre në esencë kanë mbetur të njëjta.



Megjithëkëtë, disa përpjekje të orientuara drejt veprimit të menduar preventiv, kanë luajtur një rol të rëndësishëm shoqëror, me që kanë ndikuar në ngritjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë së një pjese të opinionit publik mbi rëndësinë e veprimit preventiv në luftimin e kriminalitetit. Në disa organe shtetërore, si edhe në disa organizata shoqërore e politike, është krijuar ideja për disa programe preventive. Por, ato kanë mbetur kryesisht në nivel deklarativ, sepse përpunimi dhe realizimi i tyre kryesisht nuk është realizuar. Veprimtaria cilësore preventive e bazuar në programe operacionale preventive, zbatimi me sukses i të cilave nënkupton lidhshmëri të mirë organizative e institucionale të organeve dhe subjekteve relevante, as që ka mundur të mendohet në sistemin e vetëmbrojtjes shoqërore.

### **3. STRATEGJIA KRIMINALISTIKE**

#### **3.1. Nocioni, metodat dhe mjetet kriminalistike**

Megjithëse ekzistojnë definicione të ndryshme për strategjinë kriminalistike, teoricienët nuk vënë në dyshim se lëndë kryesore e saj është përcaktimi i masave globale kriminalistike dhe i detyrave preventive e represive në luftën kundër kriminalitetit. Natyrisht, detyrat përcaktohen nga politika kriminale dhe e drejta. Kjo do të thotë se strategjia kriminalistike është projekt mbi përdorimin optimal të mjeteve kriminalistike për realizimin e objektivit të caktuar. Kjo do të thotë se fusha e strategjisë kriminalistike përfshin masat që kanë të bëjnë me luftimin e kriminalitetit në tërësi, gjegjësisht të pjesëve të tij. Nga ana tjetër, siç dihet fusha e taktikës kriminalistike përfshin masat për zbulimin, hulumtimin dhe dëshmimin e veprimeve kriminale.

Siç shihet, masat taktike kriminalistike mund të jenë vetëm mjete për realizimin e strategjisë kriminalistike. Por, është e mundur edhe e kundërta, që do të thotë se strategjia kriminalistike mundëson zgjidhjen e drejtë të taktikave kriminalistike më adekuate. Masat taktike kriminalistike mund të jenë vetëm simulim për realizimi e strategjisë kriminalistike. Kuptimin dhe objektivin e simulimit e dinë vetëm planifikuesit e tij. Kjo do të thotë gjithashtu se masat strategjike dhe taktike kriminalistike ndonjëherë shkrihen, siç është rasti në strategjinë ushtarake.

Strategjia kriminalistike është mjet për realizimin e objektivave të politikës kriminalistike. Në rast se dëshmohet se objektivat e caktuara të planifikuara me strategjinë kriminalistike (masat dhe veprimet strategjike kriminalistike) nuk është e mundur të realizohen, shfaqen objektiva dy-kahëshe, për shkak të mjeteve në

dispozicion që janë të përcaktuara tej mase. Në këtë rast bëhet fjalë për politikë kriminalistike të pazbatueshme, prandaj është e nevojshme të bëhen ndryshime në mënyrën e përdorimit të mjeteve ekzistuese, sepse mënyra e planifikuar nuk mundëson rezultate optimale. Konkluzioni që del vetvetiu tregon se strategjia kriminalistike duhet të ndryshojë. Duhet të kihet parasysh se strategjia kriminalistike është vetëm një pjesë e strategjisë së tërësishme për luftimin e kriminalitetit, në të cilën përfshihen edhe institucionet tjera mbikëqyrëse.

Nga sa u tha deri me tash, mund të konkludohet se lufta kundër kriminalitetit zhvillohet nëpërmjet politikës kriminalistike, strategjisë kriminalistike dhe taktikës kriminalistike. Disa masa që përdoren në këtë luftë mund të jenë afatshkurta, afatmesme apo afatgjata.

Të përcaktojmë tani edhe raportet midis strategjisë kriminalistike dhe strategjive të ngjashme. Siç kemi thënë, strategjia kriminalistike është vetëm një pjesë e strategjisë së përgjithshme për kufizimin e kriminalitetit, në të cilën janë të përfshira me strategji të tyre edhe mekanizmat tjerë mbikqyrës (gjyqësi, shëndetësi, shërbimi social dhe mekanizmat tjerë joformal). Ato pranojnë ose do të duhej të pranonin udhëzime nga politika kriminalistike e cila është pranuar dhe miratuar. Kjo strategji e përbashkët ose gjithëpërfshirëse mund të quhet edhe strategji e mbikëqyrjes së kriminalitetit („strategy of crime control“ ose „Strategie der Kriminalitätskontrolle“).

Strategji tjetër simotër është strategjia e sigurisë. Disa teoricienë e cilësojnë atë si strategji të policisë, por kjo strategji ka një kuptim shumë më të gjerë. Strategjia e sigurisë përfshin edhe kufizimin e rrezikut nga kriminaliteti nga ana e institucioneve mbikëqyrëse jopolicore (siç janë shërbimet e sigurisë në ndërmarrje ose në institucione private të sigurisë). Përveç kësaj, në strategjinë e sigurisë përfshihen edhe rreziqet të cilat nuk janë pasojë e veprave kriminale (p.sh. fatkeqësitë natyrore). Në qoftë se e kemi parasysh se strategjisë së sigurisë ia përcakton objektivat politika e sigurisë, atëherë mund të nxjerrim përfundimin se pjesë e strategjisë së sigurisë është edhe strategjia ushtarake.

Puna e policisë nuk nënkupton vetëm aktivitetet e orientuara në luftimin kriminalitetit. Në fushëveprimin e saj përfshihen dhe kontrolli i komunikacionit, ruajtja e rendit publik dhe qetësisë, mbikëqyrja e kufirit, etj. Në këtë fushë të veprimtarisë së policisë duhet të planifikohen masa të ndryshme të cilat mundësojnë realizmin e objektivave të caktuara. Më fjalë të tjera, edhe te veprimtaritë e policisë është e domosdoshme strategjia (policore). Kështu vijmë në përfundim se nocioni strategji policore ka kuptim më të gjerë së nocioni strategji kriminalistike.

Në literaturën profesionale haset edhe nocioni strategji hetimore. Zierke, Jnasel dhe Finkel ( 1995, 459-550) e përdorin këtë termin si sinonim për strategjinë kriminalistike. Sipas mendimit tonë, bëhet fjalë për një nocion më të ngushtë se strategjia kriminalistike. Strategjia hetimore, siç e përcakton Maver (200,12-23) mund të renditet në mesin e strategjive kriminalistike operative (p.sh. strategjia e ruajtjes së sekretit të punëtorëve të policisë ose strategjia e ruajtjes së dëshmitarëve kryesorë, etj.). Domethënë bëhet fjalë për një nocion me kuptim më të ngushtë.

### **3.2. Analitika kriminalistike si parakusht për strategji kriminalistike efikase**

Të dhënat operative që kalojnë nëpër procesin e seleksionimit dhe vlerësimit futen në sistemin e evidencës kriminalistike nëpërmjet të cilit shfrytëzohen më vonë. Këto të dhëna shpërndahen menjëherë pas grumbullimit dhe i dërgohen shërbimit për dokumentacion dhe përpunim. Pastaj, në bazë të tyre, hartohen raporte përmbledhëse dhe buletine, të cilat mund të jenë ditore, javore, mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe njëvjeçare. Në bazë të tyre hartohen raporte statistikore, bëhen pasqyrime dhe grafikone të cilat u shpërndahen për informim dhe shfrytëzim njësisive të organeve të punëve të brendshme dhe subjekteve të tjera.

Ekzistojnë edhe forma të tjera të prezantimeve, siç janë: raportet mbi situatën e sigurisë, njoftimet individuale, përmbledhjet e njoftimeve, dokumentet problemore, etj. Një pjesë e të dhënave vihet në qarkullim menjëherë, sipas automatizmit, kryesisht sipas sistemit të komunikimit vertikal dhe horizontal. Këtu bëhet fjalë për të dhëna që u dërgohen atyre organeve të cilave u nevojiten për procedim të mëtejshëm në pajtim me veprimtarinë e tyre themelore. Përmbajtja e këtyre të dhënave e përcakton edhe mundësinë e shfrytëzimit të tyre: a do ta iniciojë ai fillimin e përpunimit kriminalistik, a do ta shtyjë me qëllim të krahasimeve apo plotësimeve me të dhëna të tjera, ose a paraqesin bazë për vendosjen e kontrollit kriminalistik.

Nga përmbajtja e të dhënave varet se deri në çfarë mase mund të shërbejnë ato, si bazë për planifikimin dhe ndërmarrjen e masave preventive kriminalistike. Por, për dallim nga ndërmarrja e masave represive, ndërmarrja e masave preventive mund të bëhet vetëm pas grumbullimit të një numri të madh të dhënash të cilat hedhin në dritë aspekte të ndryshme: etiologjike, mbi çështjen e vendit, kohës, mënyrës, motivit të kryerjes së veprës penale, karakterit të viktimës, aspektit viktimologjik, etj. Për këtë arsye në fazën e evidentimit të informacioneve të para fillestare mbi dukurinë kriminale është e pamundur të zbatohen masa të organizuara dhe

përmbajtjesore preventive, apo masa të tjera që në këtë fazë mund të kenë efekte represive.

Veprimtaria kriminalistike e organeve të punëve të brendshme, pavarësisht se a është veprimtari preventive apo represive, determinohet shumë nga kualiteti i analizës kriminalistike. Analiza përmbajtjesore duhet të përfshijë anët më të rëndësishme të gjendjes dhe dinamikës së kriminalitetit. Kjo do të thotë se ajo duhet të tregojë tendencat eventuale të manifestimeve kriminale në të ardhmen dhe të përcaktojë momentet dhe faktorët pozitiv dhe negativ që ndikojnë në efikasitetin e masave të ndërmarra, në mënyrë që të bëhet orari gjithëpërfshirës dhe raciale i forcave.

Kërkesa më e rëndësishme e analizës është që të tregojë kushtet dhe shkaqet që qojnë ose kushtëzojnë kryerjen e veprës penale. Veprimtaria analitike, në kuadrin e eksploatimit të të dhënave të sistemit informativ, duhet të përfshijë tërësinë e metodave që shërbejnë për studimin e sjelljes kriminale të kryerësve të veprës penale, studimin e vet veprave penale, studimi i indicieve të shumëllojshme që kanë të bëjnë me veprat penale dhe kryerësit e tyre, si edhe studimin e disa tipareve etiologjike dhe fenomenologjike të kriminalitetit. Analiza duhet të përmbajë edhe të dhënat mbi suksesin e punës operative organeve të punëve të brendshme.

Studimi analitik i organizimit të punës duhet të ofrojë rezultate maksimale me qëllim të eliminimit të metodave dhe mjeteve joracionale. Me këtë rast duhet ta kenë primati ato veprime me të cilat arrihen rezultate më të mira në kundërvënien e kriminalitetit. Evidentimi dhe përpunimi i të dhënave lidhur me punë të tjera të brendshme (punët drejtuese, punët e sigurisë në komunikacion, etj.) mund të kenë rëndësi të madhe për përpunimin analitik dhe planifikimin e punës operative, me qëllim të parandalimit të kriminalitetit.

Analiza e kriminalitetit varet shumë nga cilësia dhe renditja e evidencave statistikore të cilat kryhen në shërbimet analitike të organeve të punëve të brendshme. Por, kjo statistikë i ka të gjitha mangësitë që i kanë statistikatat e kriminalitetit në përgjithësi. Të dhënat statistikore të organeve të punëve të brendshme janë të pamjaftueshme, sidomos nëse shfrytëzohen në mënyrë joadekuate ose nëse atyre iu jepet rëndësia që nuk ato nuk e kanë.

Mangësia e të dhënave të tilla statistikore qëndron në faktin se për vlerësimin e dinamikës së kriminalitetit përdoren shpesh të dhëna të pasakta e jo të plota. Ndonjëherë në këto të dhëna bëhen edhe gabime të ndryshme të cilat japim tregues

të ndryshëm. P.sh. në vend të vitit jepet ndonjë shifër e përpunimit kriminalistik, pa marrë parasysh se cili do të jetë përfundimi.

Tash për tash nuk ekziston ndonjë statistikë e cila pasqyron në mënyrë të plotë vëllimin dhe strukturën e kriminalitetit. Asnjë statistikë ekzistuese nuk përmban, p.sh., të dhënat mbi kriminalitetin e fshehur, i cili është gjithmonë më i rrezikshmi dhe më i rëndi për shoqërinë. Kjo ndodh për shkak të mundësisë së vogël të zbulimit të këtij kriminaliteti, për shkak të pasojave të fshehura. çështje relative është edhe numri i “patologjive nacionale”, i cili nuk përfshihet në statistikat zyrtare, për shkak se ai varet nga një sërë faktorësh, midis të cilëve bën pjesë edhe efikasiteti i organeve të punëve të brendshme në zbulimin veprave penale. Tash për tash, vetëm në bazë të supozimeve të përgjithshme mund të konstatojmë se vëllimi i kriminalitetit që është paraqitur në polici dhe është i njohur për policinë dhe organet e drejtësisë është disa herë më i madh sesa kriminaliteti që pasqyrohet në statistika zyrtare. Kjo është një prej arsyeve që planifikimi i veprimtarisë preventive nuk mund të mbështetet plotësisht në statistikat mbi kriminalitetin, për shkak se ato bazohen ekskluzivisht në të dhënat mbi veprat e njohura penale dhe kryesit e tyre, të cilat përbëjnë vetëm një pjesë të veprave dhe kryesve që realisht ekzistojnë.

Përveç kësaj, statistika e organeve të punëve të brendshme përmban vetëm veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare. Një numër të këtyre veprave penale disa subjekte të tjera i paraqesin direkt prokurorit publik, ndërsa një numër i konsiderueshëm i kalon në përgjegjësi organeve ushtarake të drejtësisë, kështu që ato mbeten jashtë statistikave të policisë.

Megjithëse mbi vëllimin dhe etiologjinë e kriminalitetit të fshehur mund të flitet vetëm në bazë të të dhënave të tërthorta, ekziston supozimi real se ky lloj i kriminalitetit është më i shprehuri në sferën e pronësisë. Por, ky kriminalitet reflektohet edhe në sfera të tjera kriminale, siç janë: kriminaliteti kompjuterik, posedimi dhe bartja e armëve ilegale, cenimi i dinjitetit, personalitetit dhe moralit personal, veprat penale lidhur me drogën, reketi, shantazhi, etj.

Është fakt se kriminaliteti “i fshehtë” ekziston faktikisht, por jo edhe juridikisht, prandaj ai mbetet jashtë statistikave zyrtare, gjë që mund të ketë ndikim në përcaktimin e drejtë të politikës orientuese kriminale. Statistikat e kriminalitetit “të fshehtë” nënkuptojnë të dhënat mbi veprat e dënuara nga organet e drejtësisë (statistikat gjyqësore), ndërsa statistikat e kriminalitetit “faktik” nënkuptojnë të dhënat tjera statistikore, para së gjithash ato të kallëzimeve penale, të cilat i kanë paraqitur organet e punëve të brendshme dhe “shifrën e errët” të kriminalitetit. Kur bëhet fjalë për njohuritë mbi këtë lloj të kriminalitetit, të dhënat më të plota

megjithatë janë ato të organeve të punëve të brendshme, megjithëse statistika e tyre përmban vetëm veprat penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, ndonëse këtu nuk hyjnë të gjitha veprat e këtij grupi. Në këtë statistikë përfshihen veprat penale juridike (por edhe kriminalistike) që nuk janë hetuar.

Statistikat më të sakta do të duhej t'i kishin organet e drejtësisë, por kjo nuk ndodh. Organet e drejtësisë, si edhe organet e punëve të brendshme kanë kritere të veçanta të grumbullimit të të dhënave, prandaj të dhënat statistikore të tyre më shumë janë statistika të punës së tyre, se sa statistika që japin pasqyrë reale për kriminalitetin.

Në organet e punëve të brendshme bëhen statistika që, kryesisht, bazohen në raportet mbi operacionet operative ose përpunimet kriminalistike, mbi procesverbale të ndryshme, mbi raporte mbi ndërmarrjen e masave dhe veprimeve, mbi shënimet zyrtare, mbi evidencat që përmbajnë të dhëna për fenomenet kriminale, mbi kallëzimet penale në të cilat shpesh nuk tregohet nëse organi i punëve të brendshme ka bërë vetë kallëzim apo vetëm e ka përcjellë kallëzimin.

Të dhënat e thata e të papërpunuara kanë qenë për shumë kohë treguesit e vetëm të aktiviteteve të njëjësive të organizuara të policisë. Në bazë të këtyre të dhënave është bërë vlerësimi i suksesit të organeve të policisë dhe janë analizuar lëvizjet e kriminalitetit. Kur ka pasur rritje të numrit të veprave penale në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak apo kur është shënuar rritje e veprave penale me kryes të panjohur, kjo është cilësuar si pasivitet i organit të punëve të brendshme. Disa evidenca dhe statistika të shërbimit analitik të organeve të punëve të brendshme as sot e kësaj dite nuk kanë ndikim më të madh, sidomos në ndërmarrjen e masave praktike me karakter preventiv.

Roli i statistikës te disa organe të punëve të brendshme në masë të madhe përmbledhet në treguesin e angazhimit. Vlerat numerike të këtyre statistikave shërbejnë vetëm për vlerësimin e cilësisë së punës së këtyre organeve ato të individëve brenda tyre, i cili shërben më shumë si bazë për shpërblim se sa për pasqyrimin e problemeve të kriminalitetit me të cilat përballen organet e punëve të brendshme.

Disa evidencave dhe statistikave, megjithëse mbahen në mënyre të ndërgjegjshme dhe të rregullt, u mungon përpunimi hulumtues e analitik. Kjo dhe mangësitë tjera të shërbimit analitik e statistikor të organeve të punëve të brendshme janë gjithnjë e më të vogla. Këto statistika gjithnjë e më shumë përmbajnë të dhëna mbi veprat penale dhe kryesit e tyre, si edhe të dhëna të karakterit kriminologjik, etiologjik e të tjera. Pavarësisht se një kohë të gjatë ka dominuar mendimi se organeve të punëve

të brendshme nuk u interesojnë disa raste nga aspekti sociologjik e kriminologjik, të dhënat e tilla kanë rëndësi të veçantë, sidomos lidhur me planifikimin e masave preventive.

Statistika e policisë vetëm afërsisht e pasqyron gjendjen e kriminalitetit në fusha të caktuara. Prandaj, statistikën e organeve të punëve të brendshme duhet të plotësohen në aspektin hulumtues e analitik. Kjo nënkupton edhe analizën metodologjike të të dhënave, në bazë të së cilës mundësohet një vështrim më i plotë i fenomenologjisë kriminale, etiologjisë, viktimologjisë, etj. Statistikat e tilla kontribuojnë për pasqyrimin objektiv të gjendjes dhe dinamikës së kriminalitetit, i cili është parakusht shumë i rëndësishëm për planifikimin dhe zbatimin e preventivës.

Dokumentacioni, pavarësisht se cila pjesë e të dhënave të sistemit informativ të organeve të punëve të brendshme është përfshirë në të, duhet t'i nënshtrohet një analize të thuktë në mënyrë që t'u përshtatet nevojave dhe të jetë në funksion të veprimeve preventive e represive të organeve të punëve të brendshme. Po ashtu, dokumentacioni është e nevojshme të përmbajë të dhënat mbi veprat penale konkrete dhe mbi përpunimet kriminalistike e mbi kontrollin kriminalistik, si edhe të dhënat mbi patologjinë sociale dhe shkaktarët e kriminalitetit në përgjithësi. Natyrisht, është e domosdoshme që nëpërmjet një analize e thuktë të përpunohen të gjitha të dhënat mbi gjendjen aktuale të kriminalitetit. Planet e veprimit preventiv e represiv të organeve të punëve të brendshme duhet të hartohen mbi bazë të analizës së të dhënave.

Veprimtaria e një shërbimi të mirë analitik në organet e punëve të brendshme kontribuon në avancimin e veprimtarisë operative, jo vetëm represive, por edhe preventive. Ne do të ndalemi vetëm në disa prej këtyre aktiviteteve, të cilat bazohen në veprimtarinë analitike. Me interes të veçantë janë analizat që bazohen në rezultatet operative të disa përpunimeve kriminalistike që kanë të bëjnë me lëndë të domosdoshme për inicimin e procedurës penale. Pra, këtu bëhet fjalë për materialet e domosdoshme për hartimin e kallëzimit penal. Të ndalemi te rëndësia e të dhënave analitike e statistikore që bazë të të cilave parashikohen gjendjet parapenale apo hulumtimet e situatave të ardhshme kriminalistike. Plotësimi i këtyre përmbajtjeve mund të bëhet nëpërmjet përpunimit analitik kriminalistik dhe kontrollit kriminalistik.

Planifikimi i punës operative, qoftë represive apo preventive, lidhur me disa vatra kriminale duhet të bëhet në bazë të dukurive të regjistruara lidhur me kriminalitetin. Me këtë rast mund të parashikohen gjendje të ndryshme parapenale, fenomeneve sociale e patologjike dhe indikatorë të tjerë të manifestimeve të ardhshme

kriminale. Kualiteti i të dhënave, pra edhe i informacioneve që burojnë prej tyre, varet nga fakti se sa realisht, objektivisht dhe e plotë është prezantuar një ngjarje, si edhe nga fakti se sa i dokumentuar është ai. Meqenëse disa të dhëna regjistrohen më vonë, ndonjëherë edhe me distancë të madhe kohore, mund të përballemi me dy probleme: me aktualitetin e të dhënave dhe me objektivitetin ose vërtetësinë e tyre.

Në ecensën e orientimit të aksionit konkret antikriminal duhet të jetë parashikimi i manifestimit kriminalistik në hapësirën e caktuar, në kohën e caktuar dhe nga persona ose grup i caktuar. Gjendjet ose situatat parapenale duhet të vështrohen në raport me hapësirën dhe kohën. Kur bëhet fjalë për hapësirën atëherë duhet të nisemi nga mikro-hapësira ose mikro-sektori (operativ), bashkësia lokale dhe deri te rajoni patrullues i policisë. Kjo është e arsyeshme në radhë të parë për shkak se qytetarët e bashkësisë lokale duhet të përfshihen drejtpërdrejt në organizimin e sistemit të sigurisë, pra edhe me veprimin e përbashkët në sektorin e tyre, me qëllim të parandalimit dhe shkatërrimit të kriminalitetit.

Spektori si hapësirë territoriale përfshin hapësirën ku shfaqen dhe ku zhvillohen aksionet kriminalistike represive dhe kriminalistike preventive dhe ku realizohen edhe detyrat tjera të drejtpërdrejta kriminalistike. Parashikimet e kriminalitetit në mikro-plan sintetizohen në mënyrë që parashikimet e bashkuara të pasqyrojnë gjendjen në makro-plan. Hulumtimet analitike statistikore që bëhen me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve preventive në mikro-plan kanë të bëjnë me grumbullimin e të dhënave mbi natyrën dhe zhvillimin e delikuencës në gjithë territorin nacional, paralelisht me hulumtimet në mikro-plan, në mënyrë që të përcaktohen rrethanat e përbashkëta të kryerjes së veprave penale, veprat penale që kryhen më së shpeshti, *modus operandi* më i shpeshtë, struktura e moshës së kryerësve të veprave penale dhe të viktimave, si edhe që të bëhen hulumtime të tjera që do të mundësonin konceptimin ose zbatimin praktik të veprimtarive preventive e represive.

Në qoftë se është e mundur që në bazë të gjendjes analitike-statistikore sa më mirë të parashikohen lëvizjet kriminalitetit në hapësirën e caktuar dhe në kohë të caktuar, atëherë është e mundur që të parashikohen nevojat dhe të planifikohen masat për “mbulimin” e vatrave kriminale, gjegjësisht për ndërmarrjen e masave taktike me qëllim të parandalimit. Por, kur bëhet fjalë për veprimtarinë preventive të organeve të punëve të brendshme, planifikimi në bazë të punës hulumtuese e analitike nuk është avancuar mjaft në këtë fushë, për dallim nga veprimtaritë që kanë të bëjnë me zbatimin e masave represive. Megjithatë, çdo hulumtim i kriminalitetit si dhe hulumtim analitik e statistikor, duhet të ketë objektiv të fundit parandalimin.



Rezultatet e hulumtimeve analitike a statistikore, bashkë me determinantet tjera, do të duhej të krijojnë mundësi për parashikimin e ngjarjes dhe atë: a) parashikimin e sjelljes kriminale të personit të caktuar dhe b) parashikimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta që në situata përkatëse mundësojnë parashikimin e kriminalitetit në hapësira të caktuara dhe në kohë të caktuar. Meqenëse përpunimi kriminalistik është proces dinamik që ka lidhje me të gjitha ndryshimet që i shoqërojnë dukuritë e kriminalitetit, shërbimet analitike e statistikore duhet t'i përcjellin ato vazhdimisht dhe, varësisht prej ndryshimeve, të hartojnë plane në bazë të të cilave do të bëhen ndryshime në mënyrën e përpunimit, varësisht prej ndryshimeve të manifestimeve kriminale. Kjo do të thotë se materiali statistikor e analitik përmban jo vetëm veprimtarinë e tërësishme kriminale, por edhe ndryshimet e metodave dhe veprimeve operative, gjë që është e rëndësishme për planifikimin e mëtejme të veprimtarisë operative. Në këtë rast bëhen korrigjime dhe ndryshime të planeve dhe programeve preventive, në qoftë se do të jetë e nevojshme.

Në kuadrin e planifikimit të preventivës është e domosdoshme të bëhet edhe vlerësimi i forcave që mund të mobilizohen për parandalimin e ngjarjeve kriminale. Ky vlerësim përmban të dhënat mbi potencialin vetjak, teknik e njerëzor, si edhe numrin, aftësinë, specializimin, organizimin, efikasitetin e veprimit preventiv edhe të subjekteve tjera. Në bazë të bashkëpunimit reciprok i cili ka rëndësi për punën e mëtejme preventive.

Kjo do të thotë se që të krijohet baza për veprime preventive, organet e punëve të brendshme duhet të orientojnë veprimtarinë e tyre analitike e hulumtuese lidhur me: frekuencën, llojin, zhvillimin kohor të kriminalitetit të pasqyruar në pasqyrat analitike e statistikore, pastaj mënyrat e kryerjes së veprës penale dhe sipas mundësisë, motiveve, vendit dhe kohës së secilës vepër penale, pastaj rrezikshmërinë e vet viktimës, praninë e faktorit viktimologjik, si edhe tiparet tjera të kryerjes së veprës penale që paraqesin elemente të rëndësishme kriminalistike; mundësia që edhe subjektet tjera preventive të veprojnë duhet t'i mobilizojë organet e punëve të brendshme që të bashkëpunojnë me disa subjekte duke u ofruar ndihmë profesionale, duke i informuar qytetarët mbi kriminalitetin dhe veprimet e nevojshme preventive si dhe t'i mobilizojë për bashkëpunim duke u nisur nga kategoritë e ndryshme të viktimave potenciale, të objekteve të rrezikuara, etj.; organi i punëve të brendshme duhet t'i informojë punëtorët e vet, para së gjithash ata që janë angazhuar në punë të karakterit preventiv, mbi aspektet e përgjithshme dhe të veçanta të kriminalitetit jo vetëm nga aspekti etiologjik e fenomenologjik, por edhe nga aspekti i interaksionit të masave të veta dhe masave të subjekteve të tjera;

është e domosdoshme që organet e punëve të brendshme të angazhohen që në radhët e tyre të marrin qëndrime mbi dobinë e masave preventive. Por, çdo "bindje" në këtë drejtim është e pavlefshme në qoftë se nuk përcillet nga kuadri profesional i angazhuar në punët e analitikës, të cilit deri më tash nuk i është kushtuar kujdes i mjaftueshëm, për dallim nga arsimimi për qëllime represive.

### **3.3. Planifikimi operativ-strategjik si segment i strategjisë kriminalistike**

Pjesëtarët e policisë kriminalistike merren me parandalimin dhe shkatërrimin e kriminalitetit në sektorë sipas të ashtuquajturit "parim i linjës". Nga këndvështrimi i këtij libri janë me interes punët e kësaj njësie (si edhe të njësive tjera) që kanë karakter kryesisht kriminal e preventiv, me që brenda sektorit zhvillohet edhe punë të tjera të shumëllojshme, efektet dhe qëllimet e kryerjes së të cilave janë të ndryshme.

Punë preventive janë, para së gjithash, veprimet kriminalistike që kanë për qëllim t'i pengojnë personat, nga sjelljet e të cilëve mund të supozohet se mund të kryejnë vepra penale ose veprime devijante. Këtu, më së shpeshti bëhet fjalë për të kthyerit e shumëfishtë, gjegjësisht për persona me recidiva kriminale. Ndër këto masa është edhe mbikëqyrja e objekteve në hapësirat ku më së shpeshti shfaqen dukuritë kriminale ose sjelljet socio-patologjike. Këto objekte mund të shënjohen nga aspekti kriminogjen vazhdimisht ose përkohësisht.

Në këtë veprimtari bën pjesë edhe grumbullimi i të gjitha njoftimeve dhe informacioneve që tregojnë disa gjendje parapenale (në formë të krimit të organizuar, nxitjes dhe përgatitjes së veprimeve). Me qëllim të veprimit preventiv të policisë brenda sektorit është e rëndësishme që të bëhet grumbullimi i informacioneve mbi shenjat që tregojnë për mundësinë e prishjes së rendit e të qetësisë në përmasa më të mëdha, të rrezikimit të jetës dhe të sigurisë së qytetarëve në përgjithësi, të shkatërrimit të pasurisë dhe të të mirave publike, etj. Në punë preventive bën pjesë edhe bashkëpunimi me organizatorë të tubimeve publike si dhe aktivitete që ndërmerren me qëllim të zbulimit dhe parandalimit me kohë të veprimtarive ose gjendjeve që rrezikojnë sigurinë personale të personaliteteve të caktuara apo të objekteve siç janë ato me rëndësi të veçantë. Këtu bëjnë pjesë edhe punët për ofrimin e ndihmës për organet shtetërore apo për organizatat punuese që janë të autorizuar të ekzekutojnë vendime të caktuara.

Natyrisht, efekte preventive kanë edhe punë të tjera të shumëllojshme në sektorë, siç janë siguria e komunikacionit, furnizimi, bartja dhe ruajtja e armëve si edhe

shumë punë të tjera administrative. Punë të tjera që zhvillohen brenda sektorit kanë karakter organizativ, drejtues ose kriminal-represiv. Në kuptimin e zbulimit të veprave penale dhe kundërvajtjeve dhe të përgatitjes së dokumentacionit për paraqitjen e tyre tek organet gjyqësore dhe kundërvajtëse. Me këto punë mund të arrihen efekte shumë të rëndësishme preventive, me kusht që ato të kryhen me sukses, me efikasitet dhe me kohë.

Meqenëse roli kriminalo-politik i policisë është që të merret me kriminalitetin në mënyrë të drejtpoërdrejtë ose të tërthortë, nga spekti i zbulimit apo parandalimit, është e domosdoshme që policia të lirohet nga disa pengesa të cilat e pamundësojnë ose e ngadalësojnë veprimin e saj kundër kriminalitetit. Ky rol i policisë, në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë, varet nga bashkëpunimi i policisë me qytetarët gjegjësisht i policisë me opinionin brenda sektorit dhe në përgjithësi. Në këto marrëdhënie, policia duhet të shfrytëzojë të gjitha përparësitë e menaxhmentit, të cilat e bëjnë policinë më të afërt për qytetarët, pikërisht për shkak se brenda sektorit ekzistojnë kushtet më të volitshme për këtë.

Në bazë të programeve të caktuara policia duhet të zbatojë masat me të cilat shtohet mbrojtja e qytetarëve nga kriminaliteti në mikrohapësirë (sektor). Me këtë rast policia duhet të ketë autorizime që të bashkëpunojë me qytetarë, që të respektojë propozimet dhe iniciativat e tyre, që të organizojë dhe zbatojë programe dhe aksione të caktuara preventive dhe t'i përfshijë qytetarët në to, nëse kjo nuk do të jetë e rrezikshme për ta. Programet dhe aksionet e tilla duhet të jenë të përshtatshme dhe të krijojnë rrethana për bashkëpunim dhe zbatim në bazë të besimit reciprok, gjegjësisht informimit reciprok.

Objektiv i këtij bashkëpunimi është fitimi i dyanshëm i besimit reciprok të qytetarëve dhe policisë dhe informimi i domosdoshëm i policisë dhe qytetarëve mbi veprimet kriminale e kundërvajtëse, mbi fenomenet socio-patologjike dhe mbi devijimet tjera dhe autorët e tyre. Pa këto informacione, policia dhe qytetarët praktikisht janë të pafuqishëm, gjegjësisht të pambrojtur dhe joefikas, kur bunet fjalë për planifikimin dhe programimin e aksioneve preventive. Bashkëpunimin që do të duhej të bazohej në programet aksionale adekuate në kuptimin e përmendur, policia duhet ta vendos me të gjitha subjektet relevante në hapësirën brenda sektorit për të cilin është kompetente, pastaj me disa institucione, organizata punuese, shoqata qytetarësh, shkolla, qendra për punë sociale, familje, etj. Këto programe duhet të jenë të përgatitura, funksionale, të arsyeshme, të përshtatshme dhe të drejta për subjektet me të cilat policia duhet ta koordinojë punën e saj.

Është e sigurt që një rol i tillë i policisë kërkon ndryshime brenda policisë dhe korrigjime të rolit të policisë në kuadrin e sistemit të organeve shtetërore dhe vendin e saj në shoqëri përgjithësisht. Ndryshimet kanë të bëjnë në masë të madhe me decentralizimin e policisë dhe pjesërisht me demistifikimin dhe deglorifikimin e disa veprimtarive të policisë. Këto ndryshime do ta bënin policinë më të afërt për qytetarë, të cilët do të motivoheshin që të bashkëpunojnë me policinë dhe të ndërtojnë marrëdhënie të besimit reciprok me të. Por, gjendja aktuale me shumë e largon policinë nga qytetarët sesa e ofron.

Kundërvënja e efikase kriminalitetit përjashton formalizmin e tepërt të punës së policisë, i cili shpesh, në mënyrë direkte e pengon angazhimin e policisë për parandalimin dhe shkatërrimin e kriminalitetit. Hierarkia tepër formale, e ngurtë dhe vertikale e vendimmarrjes, e cila, sipas natyrës është e ngadalshme dhe jooperative, mund të ndikojë negativisht në gatishmërinë dhe kreativitetin e veprimit konkret kriminalistik të policisë në mikro-hapërisë, sidomos për shkak se për veprimin e drejtpërdrejt preventiv është i domosdoshëm një interaksion dinamik me pjesëmarrjen e subjekteve të shumta jashtë policisë dhe me qytetarë. Pra, policia duhet të ruaj dhe të avancojë bashkëpunimin me këto subjekte dhe me qytetarë dhe për këtë është e domosdoshme që policia të ketë kuadër profesional të përgatitur në të gjitha nivelet, i cili mund të hartojë dhe realizojë në mënyrë të kualifikuar programet të caktuara preventive.

Të gjitha këto probleme varen në masë të madhe nga parandalimi i kriminalitetit, prandaj ekziston bindja si decentralizimi i policisë do të mundësonte kreativitet më të madh, vetiniciativë dhe përgjegjësi më të madhe të përgjegjësive brenda sektorit dhe marrëdhënie më të mira të saj me qytetarët dhe opinionin në përgjithësi. Por, janë të domosdoshme edhe parakushte të tjera, siç janë ndryshimet e regullativave ligjore të cilat do t'i bënin të obligueshme veprimet preventive të policisë. Do të ishte e domosdoshme që të miratohen rregullativa që do t'i obligonin edhe subjektet tjera të shoqërisë të ndërmarrin aktivitete preventive në bashkëpunim me policinë dhe në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, është e domosdoshme edhe mbështetja mediale, jo vetëm ndaj veprimeve antikriminale, por edhe ndaj aksioneve të përbashkëta preventive. Një prej parakushteve themelore për veprim të suksesshëm antikriminal të policisë është edhe kontrolli efikas, i brendshëm dhe parlamentar. Për të qenë e suksesshme veprimtaria preventive e policisë është e domosdoshme që të plotësohen edhe kushtet tjera të rëndësishme (organizative, funksionale dhe profesionale).

Policia nuk bën ta vështrojë parandalimin e kriminalitetit jashtë kontekstit të përgjithshëm të kriminalitetit. Mirëpo, shumica e autorëve i vë në të njëjtin rrafsh

organizativ aktivitetet e policisë për parandalimin dhe shkatërrimin e kriminalitetit. Në esencë, ky qëndrim është i gabuar sepse parandalimi policor i kriminalitet, si rregull, mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse realizohet në bashkëpunim dhe interaksion me të njëjtën veprimtari të subjekteve tjera të shumëllojshme. Qasjes së tillë ndaj preventivës së kriminalitetit i shkojnë për shtati proceset demokratike në shoqëri, nga zhvillimi i të cilave varen shumë edhe mundësitë e zhvillimit të preventivës në përgjithësi.

### **3.4. Kontrolli kriminalistik si segment i veprimit kriminalistiko-strategjik**

Esenca e kontrollit kriminalistik qëndron në mbikëqyrjen e mjediseve të caktuara kriminale dhe objekteve kriminogjene, të ngjarjeve në to, të aktiviteteve të kriminelëve të caktuar (para së gjithash të të kthyerve), në vërejtjen e disa faktorëve kriminogjen dhe të sjelljeve asociale e antisociale, me qëllim të parandalimit të shfaqjes së pasojave kriminale.

Kontrolli kriminalistik, si sistem i masave dhe veprimeve policore operative e taktike, ushtrohet ndaj mjediseve kriminale dhe mjediseve socio-patologjike, ndaj situatave të cilat nuk e përjashtojnë mundësinë e veprimeve kriminale dhe ndaj kundravajtjeve dhe manifestimeve devijante në përgjithësi. Këto mund të jenë edhe fatkeqësitë natyrore, siç janë: vërshimet, zjarret e përmasave të mëdha, aksidentet e mëdha të komunikacionit, gjendja e luftës dhe situatat tjera në të cilat ekzistojnë rrethana të përshtatshme për kryerjen e krimeve dhe për veprimtari destruktive.

Ndonjëherë kontrolli kriminalistik dhe përpunimi kriminalistik gjasojnë shumë midis tyre, prandaj është vështirë të dallohen. Disa masa dhe veprime merren në të dyja rastet, si p.sh.: grumbullimi i informacioneve, racia, verifikimi i identitetit, legjitimimi, mbikëqyrja, prita, etj. Kriter i sigurt për dallimin e tyre është veprimi hetimor, i cili mund të kryhet vetëm në kuadrin e përpunimit kriminalistik.

Dallimi midis kontrollit kriminalistik dhe përpunimit kriminalistik mund të shihet në shembullin e mëposhtëm:

Për personin A ka informacione se merret me shitjen ilegale të drogës dhe se ka marrë pjesë në shpërndarjen e parave të falsifikuara.

Personi B i kthyer i shumëfishtë, është kthyer nga vuajtja e dënimit shumëvjeçar me burg, i cili i ishte shqiptuar për shkak të plaçkitjes së shumëfishtë.

Në rastin e parë ekziston dyshimi (indiciet) se personi A ka kryer vepër penale, ndërsa në rastin e dytë ekzistojnë parakushtet se personi B ka mundur të kryejë vepër penale, prandaj është e domosdoshme të kontrollohet sjellja e tij. Në rastin e parë ndërmerren masa të përpunimit kriminalistik, ndërsa në rastin e dytë ndërmerren masa të kontrollit kriminalistik. Një dallim i tillë është shumë më i përcaktuar sesa në bazë të bazave dhe veprimeve të ndërmarra, pikërisht për shkak së në autorizimet e organeve të punëve të brendshme pothuaj nuk ekzistojnë veprime policore kriminalistike që mund të ndërmerren vetëm për qëllime preventive.

Kontrolli kriminalistik, sipas natyrës së tij dhe vëllimit të njohurive, mund të bazohet vetëm në dyshimin e përgjithshëm, me që kontrolli është aktivitet i përhershëm që ndërmerret në mjediset kriminale dhe, pjesërisht, në mjediset socio-patologjike, në raport me kryesit eventual të veprave penale.

Nëse nëpërmjet kontrolli kriminalistik zbulohen indiciet e para orientuese-eliminuese (bazat e dyshimit) lidhur me një vepër të caktuar penale apo lidhur me një person të caktuar që mund të jetë kryesi, atëherë kontrolli kriminalistik transformohet në përpunim kriminalistik. Në këtë situatë, kontrolli kriminalistik paraqitet si fazë e parë e përgjithshme, ndërsa përpunimi kriminalistik si fazë e veçantë konkrete e kundërvënies ndaj kriminalitetit. Për dallimin e tyre është e domosdoshme të ekzistojë “baza e dyshimit” se është kryer apo se përgatitet kryerja e veprës penale, gjë që paraqet kushtin minimal për shmangien e përpunimit kriminalistik.

Metodat kriminalistike taktike të parandalimit të kriminalitetit që përdoren në kontrollin kriminalistik kanë hapësirë shumë më të gjerë veprimi dhe paraqesin mënyrën e punës së domosdoshme dhe të dobishme të policisë bashkëkohore. Mbulimi operativ i mjediseve dhe objekteve të caktuara kriminogjene ka për qëllim parandalimin e veprimeve kriminale.

Kontrolli kriminalistik zhvillohet sipas “mbulimit” sektorial dhe specialistik të hapësirës së caktuar. Në këtë rast, forma e fundit ka përmbajtje më konkrete, sepse zakonisht orientohet në një lloj të caktuar të manifestimeve kriminale.

Kur bëhet fjalë për zbatimin e disa masave dhe veprimeve, sipas këtij kriteri nuk ekziston dallim qenësor midis këtyre dy formave të kontrollit kriminalistik. Ky dallim është minimal, madje edhe në krahasim me dallimet midis përpunimit kriminalistik dhe kontrollit kriminalistik, me që në ndërmarrjen e veprimeve të kontrollit kriminalistik (duke pasur parasysh karakterin e saj preventiv dhe

rëndësinë e përgjithshme), ekzistojnë mundësi më të mëdha për përfshirjen e subjekteve tjera jashtë organeve të punëve të brendshme.

Nëpërmjet kontrollit kriminalistik ndonjëherë zgjidhen dhe veçohen të dhënat dhe faktet që dëshmojnë për një dukuri apo ngjarje konkrete ose për persona që kërkojnë angazhim të veçantë kriminalistik, në kuptimin e përpunimit të të dhënave, fakteve dhe dëshmimeve, me qëllim të ndriçimit përfundimtar të çështjes. Nëpërmjet kontrollit kriminalistik, si metodë e përgjithshme, kjo nuk mund të arrihet. Kontrollin kriminalistik, madje edhe në formën e tij konkrete (specialistike), ndalon në një distancë të caktuar në raport me kryesin konkret të veprës penale, në mënyrë që përpunimi kriminalistik të vazhdojë më tutje ndriçimin e veprës, zbulimin kryesit dhe kallëzimin ndaj tij pasi të jenë mbledhur të dhëna të mjaftueshme kriminalistike dhe, sipas mundësisë materiale procedurale. Për këtë arsye përpunimi kriminalistik është i kufizuar në kohë dhe, në parim, zgjat deri në ndriçimin e dukurive kriminale ose të veprimtarisë kriminale të personit të caktuar, kur plotësohet përmbajtja e procedurës parapenale.

Meqenëse procedura parapenale ndiqet nga procedura penale, si fazë e parë e saj, në bazë të përpunimit kriminalistik, si rregull vazhdon hetimi.

Duke shqyrtuar më tutje marrëdhëniet e kontrollit kriminalistik dhe përpunimit kriminalistik, mund të përfundohet se kontrolli kriminalistik është veprimtari e organizuar e organeve të punëve të brendshme për parandalimin e kriminalitetit, ndërsa përpunimi kriminalistik është gjithashtu formë e organizuar e punës për shkatërrimin e kriminalitetit. Natyrisht, ky dallim ka domethënie vetëm të kushtëzuar dhe të përgjithshme, sepse si kontrolli kriminalistik ashtu edhe përpunimi kriminalistik zbatohen nëpërmjet metodave preventive e represive, por ato plotësohen dhe kushtëzohen reciprokisht nga njëra-tjetra.

Pavarësisht se veprimi kriminalistik i policisë duhet të lëviz në hapësirën e preventivës, kur ajo është racionale dhe e përshtatshme, këto metoda kushtëzohen reciprokisht në mënyrë funksionale, ndërsa kundërvënia ndaj kriminalitetit mund të jetë e suksesshme vetëm nëse ato plotësohen reciprokisht.

#### **4. STRATEGJIA KRIMINALISTIKE DHE SHKENCAT TJERA ANALITIKE TE SIGURISE**

Preventiva policore e kriminalitetit ka lidhje të ngushtë e policinë kriminalistike, përkatësisht me atë pjesë të kriminalistikës që është e lidhur në mënyrë funksionale me procedurën parapenale (kriminalistika heuristike). Një hapësirë më e gjerë e

marrëdhënieve të ngjashme ekziston midis preventivës së kriminalitetit dhe politikës kriminale, në të cilën preventiva është pikërisht komponentë domethënëse.

Shtimi enorm i kriminalitetit në botë, gjatë dekadave të fundit e shton interesin për gjetjen e metodave të reja të kundërvënies ndaj kriminalitetit, gjegjësisht për intensifikimin e disa prej metodave ekzistuese në rrethana të ndryshimeve të mëdha shoqërore. Qysh para gati 30 vjetësh, Schafer (1973, 37-71) është përpjekur që strategjinë kriminalistike ta trajtojë si veprimtari praktike të policisë, duke u angazhuar që t'ia përcaktojë edhe konceptin themelor teorik. Në fillim, përpjekjet e Schafer-it nuk kanë bërë kurrfarë ndikimi praktik, por pas më shumë se 10 vjetësh akademia policore për udhëheqje në Mynster (Gjermani) organizoi një seminar mbi strategjinë kriminalistike. Kjo ishte një nxitje e rëndësishme që të shqyrtoheshin metodat ekzistuese kriminalistike-policore, me qëllim të zvogëlimit të shkallës së lartë të kriminalitetit, i cili nuk mund të mbahej edhe më tutje nën kontroll dhe të luftohej në mënyrë efektive me mjetet ekzistuese.

Në fillimet e saj, strategjia kriminalistike kishte për qëllim ndjekjen e strategjisë kriminale, në mënyrë që nëpërmjet metodës së “vërejtjes së hershme” të pengonte kriminelët që të kryenin vepra të reja penale. Duket qartë se dobësia kryesore e kësaj metode qëndronte në faktin se ajo duhej eventualisht të parandalonte delikuentet e kthyer, por jo edhe ata primar. Mirëpo, ky orientim kishte për qëllim që të parandalonte ndikimet e caktuara kriminogjene që kërcënonin të manifestoheshin.

Hulumtimet kriminalistike sot në botë tashmë kanë një traditë e cila është e fokusuar në preventivën kriminalistike. Hulumtimet kriminalistike janë objekt i punës së Zyrës Federale Kriminalistike në Njiesbaden, e cila, në fillim, quhej zyrë kriminalistiko-kriminologjike. Më vonë kjo zyrë mori përsipër vetëm hulumtimet kriminalistike, nëpërmjet të cilave studiohen mundësitë e parandalimit të kriminalitetit, para së gjithash nëpërmjet strategjisë kriminalistike.

Ndër autorët që insistojnë sidomos në strategjinë kriminalistike janë Stubert (1999), Kube (1992), Kernerr (1991) e të tjerë. Këta autorë e konsiderojnë strategjinë kriminalistike si veprimtari praktike, e cila kontribuon në parandalimin e veprave penale me mjete dhe masa organizative kriminalistike-hetimore.

Objektiv themelor i strategjisë kriminalistike është që, në bazë të masave të programuara kriminalistiko-taktike të ndërmarrë masa të caktuara preventive. Strategjia kriminalistike duhet të përputhet fort me politikën kriminale. Ajo është në lidhje të ngushtë me të, sepse paraqet operacionalizimin e masave të caktuara, të



cilat politika kriminale i ka në programin e saj, e të cilat kanë të bëjnë me metodat kriminalistike. Kështu, me metoda kriminalistike arrihen efektet e politikës kriminale. Kjo arrihet nëpërmjet strategjisë kriminalistike. Ky efekt më së shumti ka karakter preventiv, por mund të arrihet edhe me zbulimin efikas të veprës së caktuar penale ose kryesit të saj.

Strategjia kriminalistike realizohet drejtpërdrejt me masa dhe veprime kriminalistike, të cilat janë mjet për realizimin e objektivave strategjike. Gjatë realizimit të veprimeve kriminalistike, ky objektiv strategjik nuk është e thënë të jetë i njohur nga zbatuesi i drejtpërdrejt. Interesi strategjik është më i lartë dhe përfshihet në objektivin përfundimtar, i cili barazohet me objektivin primar të politikës kriminale. Ndërmarrja e masave konkrete ka objektiv të drejtpërdrejt zbulimin e veprës së caktuar penale, ndërsa si objektiv strategjik e ka avancimin e marrëdhënieve të policisë me opinionin, me qëllim të kundërvënies ndaj kriminalitetit.

Veprimet kriminalistiko-taktike më së shpeshti shërbejnë si mjet për realizimin e strategjisë kriminalistike, e cila përbën interesin e përgjithshëm të çdo veprimi kriminalistik. Ndonjëherë, strategjia i përcakton veprimet kriminalistike e antidelikuede që do të ndërmerren me qëllim të realizimit të objektivit të vet.

Marrëdhëniet e politikës kriminale dhe strategjisë kriminalistike janë marrëdhënie të përgjithshme dhe të veçanta. Strategjia kriminalistike duhet të përcjellë idenë dhe orientimin themelor të politikës kriminale, kur kjo strategji është vetëm një prej të mundshmeve. Prandaj, politika kriminale nuk mund të realizohet direkt me veprime kriminalistiko-taktike, por përmes strategjisë kriminalistike, e cila paraqet fazën kaluese midis politikës së kundërvënies ndaj kriminalitetit dhe veprimit të tërthortë kriminalistik. Strategjia kriminalistike është pjesë e një interesi më të gjerë shoqëror, ndërsa taktika kriminalistike është ndërmarrje e masave të tërthorta kriminalistike, me qëllim të zbulimit të veprave të caktuara penale dhe kryesve të tyre.

Politika kriminale është fushë më e gjerë se strategjia dhe taktikës kriminalistike. Ajo është orientim afatgjatë jo vetëm për policinë dhe strategjinë kriminalistike, por edhe për veprimtari dhe sektorë të shumtë shoqërorë, me qëllim të realizimit të objektivave afatmesme dhe afatgjata kriminalo-politike. Strategjia kriminalistike, si pjesë e politikës kriminale, ushtron edhe ndikim kthyes në politikën kriminale, gjë që varësinë e saj nga politika kriminale e bën relative.

Një raport i tillë ekziston në vendet që kanë sistem të politikës kriminale. Por, disa vende nuk kanë sistem të tillë, prandaj policia duhet të definojë vetë problemet themelore të kriminalitetit me të cilat duhet të merret, kështuqë e përcakton strategjinë kriminalistike si veprimtari relativisht të pavarur policore, e cila bëhet një kategori e domosdoshme në shoqëri (Feltes, 1994).

Së këndejmi, politika kriminale, si pjesë përbërëse e politikës së përgjithshme, e determinon strategjinë kriminalistike, me qëllim që ajo të orientojë veprimtarinë e saj drejt objektivit të caktuar, i cili është pjesë e politikës së përgjithshme në shoqëri e lidhur me fenomenin e kriminalitetit. Ndërvlerësia e këtyre fushave (politikës kriminale, strategjisë kriminalistike) është shumë e madhe, siç është shumë i shprehur edhe informacioni kthyes reciprok, kështu që papërcaktimi i këtyre disiplinave është gjithashtu relativ.

Strategjia kriminalistike shërben për realizimin e konceptit të caktuar të politikës kriminale, nëpërmjet metodave kriminalistike. Ndonjëherë, politika kriminale nuk mund të realizohet, sepse situata për këtë nuk është adekuate. Në këtë rast ndryshon strategjia, në mënyrë që koncepti i caktuar kriminalo-politik t'i përshtatet situatës konkrete.

Strategjia kriminalistike ka lidhje horizontale dhe marrëdhënie me strategjitë tjera, të cilat kanë për qëllim kundërvënien ndaj kriminalitetit. Këto, para së gjithash, janë lidhjet që përcaktohen nga orientimet e politikës kriminale, të cilat kanë të bëjnë me strategjinë e kundërvënies ndaj kriminalitetit të sektorëve tjerë shoqërorë (gjyqësia, doganat, shëndetësia, etj.). Politika kriminale e shoqërisë i orienton të gjitha këto fusha strategjike, të cilat përbëjnë strategjinë e përgjithshme për parandalimin e kriminalitetit. Natyrisht, strategjia nuk është kompakte si politikë kriminale, me që strategjia buron prej sektorëve të ndryshëm shoqëror, në të cilët duhet të veprohen në pajtim me specifikat e tyre, të cilave duhet t'u përshtatet strategjia kriminalistike.

Strategjia kriminalistike duhet të dallohet nga e ashtuquajtura strategji e sigurisë. Strategjia e Sigurisë është shumë më e gjerë se strategjia kriminalistike. Ajo, praktikisht përfshin strategjinë policore dhe kriminalistike, si dhe strategjinë e institucioneve tjera shtetërore e shoqërore që kanë funksion zbulimin dhe parandalimin e rreziqeve nga kriminaliteti dhe eliminimin e rreziqeve, qofshin ato abstrakte apo konkrete. Raportet midis policisë, strategjisë kriminalistike dhe strategjisë hetimore nuk janë të diskutueshme dhe ato janë në funksion të parandalimit dhe shkatërrimit të të kriminalitetit. Strategjia policore ka të bëjë me një fushë më të gjerë veprimi se sa parandalimi gjegjësisht shkatërrimi i kriminalitetit. Ajo është e fokusuar në sigurinë e komunikacionit, në ruajtjen e

rendit publik e të qetësisë, në kontrollin e lëvizjes në kufirin shtetëror, etj. Nga ky aspekt, strategjia policore është më e gjerë se sa strategjia kriminalistike, sepse ka të bëjë me më shumë veprimtari. Por, strategjia kriminalistike i tejkalon kornizat e strategjisë policore në pjesën që ka të bëjë me parandalimin dhe shkatërrimin e kriminalitetit dhe bartet në organet që merren me kriminalistike, kryesisht në organet e drejtësisë.

Në literaturë përmenden lloje të ndryshme të strategjisë kriminalistike, si: strategji hetimore e strategji operative (p.sh. Schafer), strategji të fokusuar në kryes të veprave penale, në viktima të veprave penale, etj. Dvorshek (2000, 6) i rendit në mesin e strategjive kriminalistike edhe strategjinë e përgjithshme dhe strategjinë operative. Sipas tij, për nga vëllimi i kriminalitetit, hapësirës dhe gamës së kriminalitetit, strategjia e përgjithshme është formë më e gjerë dhe më e përgjithshme se sa strategjia operative, e cila merret me forma të caktuara të kriminalitetit gjegjësisht me grupe të caktuara të kriminelëve. I njëjti autor e rendit strategjinë e përgjithshme kriminalistike krahas strategjisë kriminalistike të delikuencës (që përfshin grupe të caktuara të veprave penale) dhe strategjisë hetimore, strategjinë rajonale (që ka të bëjë me kufizimin e kriminalitetit në një hapësirë të caktuar gjeografike).

Strategjitë operative kanë të bëjnë gjithnjë me specifika të caktuara, në të cilat vjen në shprehje talenti, aftësitë, shkathtësitë, përkushtimi, inteligjenca dhe operativiteti i shumëfishtë i punëtorëve. Këto veti, të cilat mund të jenë shumë të rëndësishme për zgjidhjen e situatave të caktuara operative, kanë rëndësi të veçantë, si në kuptimin represiv ashtu edhe në kuptimin preventiv.

Strategjia kriminalistike i ka dy qëllime themelore të veprimit: orientimin e represionit kriminalistik, në njërën anë, dhe planifikimin, programimin dhe realizimin e preventivës kriminalistike, në anën tjetër. Fusha e represionit kriminalistik është normativisht obliguese për organet kriminalistike, kështu që ajo është shumë më e përfaqësuar në kuadrin e strategjisë kriminalistike. Preventiva kriminalistike, e cila është përgjithësuese dhe deklarative, nuk ka bazë obliguese, por, nga aspekti i racionalitetit, humanitetit dhe përshtatshmërisë gjatë parandalimit të shfaqjes së pasojave kriminale, është shumë e arsyeshme dhe e domosdoshme për shoqërinë. Për këtë arsye, është e domosdoshme që strategjia kriminalistike të bartet nga fusha e strategjisë represive në fushën e strategjisë preventive, gjithnjë kur ekzistojnë kushte për këtë. Parandalimi i shfaqjes së pasojave të veprimeve kriminale do të duhej të ishte më e pranueshmja kur bëhet fjalë për strategjinë kriminalistike. Preventiva kriminalistike, si formë e strategjisë kriminalistike, është

fushë për të cilën duhet të përcaktohen kriminalistët për t'iu kundërvënë kriminalitetit.

## **5. PLANIFIKIMI STRATEGJIK I POLICISË ME „RRETHINËN“**

### **5.1. Planifikimi strategjik i marrëdhënieve të policisë me opinionin publik**

Nocioni “publik”, gjatë zhvillimit të shoqërisë, ka marrë kuptime të ndryshme. Përveç tjerash, ky nocion është vështuar edhe nga këndvështrimi politologjik, sociologjik dhe juridik. Kështu, sot hasim në definicione të shumta, të cilat përpiqen t'i japin kuptimin përkatës në shoqëri. Përmbajtja dhe kuptimi i tij është nxjerrë nga shqyrtimi i këtij termini. Por, opinionin publik përfshin një nocion shumë funksional me një pasuri të madhe shprehëse. Duke respektuar parimin demokratik, me këtë nocion sigurohet dinamika e aktivitetit të shoqërisë, në të cilën zhvillohen gjendje të caktuara shoqërore, pikëpamje me subjekte që janë burime të informacioneve të caktuara, kështu realizohet edhe parimi publik në shoqëri. Bëhet fjalë për një parim pluralist demokratik, i cili implikon qëndrimin shumë dinamik dhe të vazhdueshëm të qytetarëve në sferën e përgjithshme të një shteti. Prandaj, nuk mund të flitet për opinionin në kuptimin e tij të plotë në qoftë se qytetarët nuk e kanë të drejtën themelore të shprehin mendimin e tyre lidhur me disa çështje në shoqëri. Nganjëherë, këto mendime janë në kundërshtim me qëndrimet zyrtare, gjë që tregon se mospajtimet lidhur me disa çështje hapin perspektivë për zgjedhje adekuata. Në këtë mënyrë vërtetohet pikëpamja e Monteskie-s se “pa lirinë e qytetarëve nuk ka as opinion”. Është e rëndësishme të theksohet se opinionin kurrë nuk mund të ketë qëndrime identike me udhëheqjen zyrtare shtetërore. Në këtë kuptim mund të thuhet se opinionin është shprehje dhe garanci e proceseve demokratike dhe sjelljeve në shoqëri, mënyrë e vendosjes dhe zgjidhjes së problemeve me vështirësi kritik në disa aspekte të realitetit shoqëror. Për këtë arsye, fuqia themelore e opinionit pasqyrohet në parimin demokratik për jetë më të mirë, më humane dhe më të civilizuar, për tejkalimin e të gjitha formave të mbylljes me ç'rast parimi publik merr dimension të veçantë në kuptimin e tij funksional (transparenca e policisë, transparenta e gjykatës, transparenta e procedurës penale). Në bazë të kësaj mund të thuhet se funksion kryesor në zhvillimin e shoqërisë civile është e drejta e qytetarëve për transparencë, gjegjësisht e pjesëmarrjes së tyre në shoqërinë demokratike. Kjo nënkupton edhe obligimin e organeve dhe organizatave që të informojnë opinionin mbi punën e tyre. Më në fund, ky është edhe parimi i sanksionuar me kushtetutë. Qytetarit duhet t'i sigurohen mundësi që në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore politike të shpreh dijen, dhe mendimin e tij, të vështrojë në mënyrë

kritike disa çështje relevante të shoqërisë, pa frikë se individ apo grupi do të bartë përgjegjësi për pikëpamjet e veta. Pra, bëhet fjalë për pluralizmin e mendimeve në një shoqëri. Nuk mund të ketë fare opinion pa kontakte njerëzore, pa informacion dhe komunikim. Kjo ka të bëjë edhe me sistemin policor.

## **5.2. Disa çështje të hapura në marrëdhëniet e policisë me opinionin**

Që prej fillimit të organizimit modern të forcave policore, duke pasur parasysh rolin e tyre në zhvillimin e shoqërisë, sidomos si organ shtetëror ekzekutiv me të drejtë legjitime për përdorimin e forcës fizike, me kohë është krijuar një antagonizëm i heshtur dhe i hapur midis policisë dhe opinionit (qytetarëve). Këto marrëdhënie “të besimit” dhe bashkëpunimit, gjatë gjithë zhvillimit historik janë përcaktuar të shumtën nga karakteri i sistemit shoqëror-politik, e sidomos nga shkalla e zhvillimit të primeve demokratike, me theks të veçantë në lirinë dhe të drejtat e qytetarëve. Duke marrë parasysh se policia, si organ i specializuar, edhe sot e kësaj dite konsiderohet si dorë e zgjatur e forcës së shtetit, si “vegël e pushtetit”, janë hapur një sërë çështjesh, midis të cilave edhe ajo e raporteve të policisë me opinionin, të cilat janë potencuar në vazhdimësi në deceniet e fundit. Kështu, edhe sot, pavarësisht nga sistemi shoqëror e politik, çyshtja e marrëdhënieve midis opinionit e policisë konsiderohet një prej çështjeve qenësore në punë e forcave të policisë. Në këtë kontekst zhvillohen hulumtime interesante me një sërë pyetjesh që u shtrohen qytetarëve dhe pjesëtarëve të policisë, në mënyrë që të fitohet rezultate të besueshme mbi marrëdhëniet e policisë dhe opinionit. Anketat e shumta lidhur me hulumtimet e mendimeve të opinionit publik sot janë bërë praktikë e gjithëpranueshme në organizimin bashkëkohor të forcave policore në botë. Metodatat e përmendura kanë shërbyer për njohjen e qëndrimit të opinionit ndaj policisë, për të fituar indikatorë të besueshëm se deri në çfarë mase është pranuar nga shoqëria metodologjia e punës së policisë. Natyrisht, duhet të kemi parasysh se larushia, kompleksiteti, ndjesia dhe përgjegjësia në kryerjen e detyrave policore në shoqëri, si edhe dimensionet politike të veprimit policor brenda aparatit shoqëror ndikojnë shumë në krijimin e imazhit të policisë në opinion, gjegjësisht në krijimin e idesë se çfarë mendojnë qytetarët për punën e përgjithshme të policisë. Në marrëdhëniet gjithnjë e më komplekse që mbretërojnë sot dhe në kohën e problemeve të sigurisë pikëpamjet e përmendura mbi opinionin si mjet legjitim, fitojnë rëndësi më të madhe, sidomos në zbatimin e metodave bashkëkohore drejtuese të policisë, me qëllim të përvetësimit të mbështetjes së opinionit. Me shtrirjen e interesave legjitime në çdo shoqëri, në të cilën padyshim ka gjithnjë e më shumë bashkëpunim e konsensus, por edhe konflikte që kanë implikime për sigurinë, është gjithnjë e më i rëndësishëm konsensusi i pjesëmarrjes pluraliste, kur bëhet fjalë mbi definimin e objektivave dhe strategjisë së sigurisë, sidomos në nivel të bashkësive lokale, me

pjesëmarrje sa më të madhe të opinionit. Vështruar në tërësi, gërshetimi, dinamika dhe kundërshtia midis aspekteve të ndryshme të jetës në shoqëri, varësia reciproke në realizimin e interesave themelore vetjake që buron nga vet organizimi i shoqërisë si pluralitet i individëve, para policisë shtrohen pyetje urgjente për vendosjen e kontakteve institucionale me opinionin. Vetëm në këtë mënyrë qytetarët mund të përcjellin me kujdes dhe në mënyrë realiste zhvillimin, punën dhe veprimin e institucioneve policore në situata komplekse dhe të fitojnë pasqyrë reale për funksionin e tyre në të gjitha detajet relevante. Nga na tjetër, në bazë të përvojave të fituara, policisë i ofrohet mundësia të plotësojë planet e veta strategjike-operative. Pra, opinionin ka rol të rëndësishëm në filozofinë e policisë. Në çdo punë, pra edhe në atë të policisë, besimi dhe mendimi i opinionit është vlerë qenësore për veprimin e saj.

Hulumtimet e deritashme, sidomos ato të kryera në vitet '60 kanë treguar në mënyrë eksplicite se qëndrimi mbi policinë është bazuar në përvojat e kaluara tradicionale dhe në statusin e policisë në shoqëri. Ato kanë nxjerrë në pah tendenca antagoniste ndërmjet policisë dhe opinionit, gjë që, siç është shumë normale, ka krijuar vështirësi në rekrutimin e kuadrit të ri policor, ka shkaktuar uljen e ndarjes së mjeteve dhe çka është më e rëndësishme ka shkaktuar mungesën e gatishmërisë së një pjesë të opinionit për të bashkëpunuar me policinë dhe për ta ndihmuar atë në realizimin e objektivave strategjike të saj. Në të vërtetë, edhe sot e kësaj dite, opinionin ka përshtypjes se policia nuk i shërben mjaft opinionit, nuk është në funksion të qytetarëve, sillet si sistem i mbyllur me të drejtën ekskluzive vetëm për zbatimin e masave represive, manifeston sjellje jo tolerante dhe jo korrekte, etj. Po ashtu opinionin ka përshtypjen se kompetencë e policisë është vetëm zbatimi i vrazhdë i ligjit, se policia është joprofesionale, e korruptuar, e paarritshme për qytetarët, etj. Opinionin ka edhe përshtypje se policia është vetëm instrument i shtetit dhe shërben si instancë zyrtare ekskluzivisht, me qëllim të mbrojtjes dhe ndëshkimeve dhe se ajo vetëm pjesërisht e kryen funksionin e saj. Nga ana tjetër, policia ka përshtypjen se qytetarët nuk janë mjaft të disponuar t'i ndihmojnë asaj në punët e përditshme, duke vlerësuar mbrojtja e sigurisë nuk është vetëm obligim i saj, se kontaktet e saj me qytetarët nuk janë në nivelin e dëshiruar, se opinionin nuk e vlerëson mjaft aktivitetin e tyre të përditshëm, megjithëse ata e rrezikojnë jetën e tyre për sigurinë personale të qytetarëve dhe të pronës së tyre. Kjo tregon se përshtypjet negative ekzistojnë si të opinionit ashtu edhe te policia. Në këtë situatë është shumë vështirë të krijohet një klimë sipas parimit të Pel-it se “polici e ardhshme duhet të jenë njerëzit, kurse njerëzit duhet të jenë polici”. Pra, raporti i policisë dhe opinionit është shumëdimensional dhe edhe sot e gjithë ditën nuk është i përpunuar dhe i studiuar mjaft. Kështu mund të thuhet se procesi i hapjes së policisë ndaj opinionit ende nuk zhvillohet në drejtim të dëshiruar. Kur e themi këtë

nuk dëshirojmë t'i marginalizojmë përpjekjet e shumë vendeve që janë orientuar në drejtim të përfshirjes më aktive të opinionit në punën e policisë. Këtu duhet të përmendim faktin se policia e Anglisë që prej 150 vjetësh e lidh veprimtarinë e saj operative me mbështetjen dhe ndihmën e opinionit, në mënyrë që të fitojë besimin e qytetarëve. Edhe në vendet e tjera bëhen përpjekje të mëdha për vendosjen e marrëdhënieve korrekte midis policisë dhe opinionit, ku, ndër të tjera bëhen përpjekje për demistifikimin e tezave mbi “sekretet” dhe mbi frikën e nxjerrjes së të dhënave relevante. Pikëpamjet e tilla kanë ndikuar shumë në vënien në pyetje të prezantimit të punës së policisë në opinion, kështu që policia është konsideruar ekskluzivisht si aparat represiv negativ i shtetit, pa shprehje të mjaftueshme të interesit për vendosjen e lidhjeve më të forta me qytetarët. Besimi i opinionit dhe përshtypja e mirë mbi policinë duhet të konsiderohet si vlerë kryesore e filozofisë policore dhe e aktiviteteve konkrete të policisë. Pa mbështetjen përkatëse të opinionit në një shtet demokratik e juridik nuk mund të flitet për suksesin e kryerjes së detyrave policore. Por, duhet të theksojmë se përveç njohurive për nevojën e mbështetjes më të madhe të opinionit është zhvilluar ngadalë edhe procesi i hartimit të programeve të organizatave policore, në të cilat vend të rëndësishëm duhet të kenë marrëdhëniet me opinionin. Në të vërtetë, një kohë të gjatë ka dominuar përshtypja tradicionale se çdo polic, sipas natyrës së autorizimeve dhe detyrave të tij në zbatimin e masave të përditshme është “abetare” për marrëdhëniet me opinionin.

### **5.3. Braktisja e marrëdhënieve tradicionale dhe nevoja për vendosjen e marrëdhënieve të reja reciproke**

Në çdo shoqëri ka pak profesione siç është ai i policëve, aktiviteti i të cilëve gjendet nën llupën e opinionit dhe është lëndë e interesimit të tij. Përshtypjet dhe mendimet e para për policinë fitohen me kontaktet me qytetarë. Veprimi i policisë mund të nxjerrë rezultate pozitive vetëm nëse ai vendos me sukses ura bashkëpunimi me bashkësinë lokale dhe me opinionin në tërësi. Mirëpo siç kemi theksuar, ky proces është zhvilluar shumë ngadalë. Një prej arsyeve konsiderohet edhe përshtypja se policia si organ ekzekutiv i shtetit nuk duhet të bazohet në mirëkuptimin e qytetarëve dhe as ta kërkojë atë, por duhet të sigurojë përshtypje të mirë nëpërmjet realizimit të suksesshëm të detyrave të saj. Mirëpo, praktika policore ka dëshmuar se këto pikëpamje janë të paqëndrueshme. Kështu në hartimin e strategjisë së re policore i kushtohet rëndësi e theksuar marrëdhënieve me opinionin, përkundër përpjekjeve që këtë proces ta shpien në rrugë të gabueshme. Ky përparim e bën më vital procesin e hartimit të strategjisë organizative dhe mundësitë për planifikimin e veprimit policor optimal në bashkësitë lokale. Për këtë arsye, marrëdhëniet polici-opinion sot konsiderohen me rëndësi të dorës së parë për krijimin e besimit dhe

mirëkuptimit midis policisë dhe bashkësisë shoqërore. Në këtë proces duhet të hiqet dorë nga kontaktet formale tradicionale dhe të preferohen marrëdhënie të tilla që shpjen drejt hartimit të programeve të reja të ardhmërisë, të cilat do të bazohen në parashikimet relevante të sigurisë.

Përvoja historike tregon çartë se në të gjitha periudhat e zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore dhe formësimit të sistemit politik, secila prej tyre i ka dhënë tipare demokratike. Së këndejmi, zhvillimi i civilizimit dhe shoqërisë bashkëkohore moderne është i ngarkuar dukshëm me pasoja të sistemeve të kaluara të cilat i kanë konsideruar qytetarët vetëm si palë eventuale dhe në emër të tyre është nëpërkëmbur e drejta themelore për liri. Në shoqëritë e sotme moderne demokratike indikator i më i mirë i cilësisë së një shteti është shkalla e lejimit që të kritikohet lirisht, sepse njerëzit e kanë të drejtën e ushtrimit të pushtetit “ashtu që asnjë ndjenjë nuk prek thellë në impulset njerëzore” (Laski, f. 121-303).

Pra, lirisht mund të thuhet se realizimi i të drejtave themelore dhe lirive njerëzore varet nga fakti se deri në ç’masë dhe deri në çfarë niveli mbrohen ato nga institucionet përkatëse. Nuk ka asgjë më të rrezikshme dhe as më perfide se, siç kemi thënë, njeriu të ketë ndjenën e mungesës së përkrahjes në një shoqëri ose, siç ka thënë Gëte “asgjë nuk është më e tmerrshme se mosdija aktive”. Nëse opinioni dëshiron të ketë pasqyrë të çartë të veprimit të policisë, atëherë mund të shtrohet pyetja esenciale se a është opinioni i informuar me detyrat themelore të policisë dhe se cili duhet të jetë funksioni i forcave policore në shoqëritë demokratike moderne.

Sipas Veberit, njerëzit synojnë sjelljen shoqërore legjitime, sjelljen e cila konsiderohet e pranueshme për shoqërinë (Korvin, 1981), e cila u mundëson atyre që ta ruajnë legjitimitetin e vet. Sistemi policor, si pjesë përbërëse e shoqërisë, duhet të funksionojë në pajtim me ritmin e ndryshimeve që bëhen në organizimin e pushtetit shtetëror, duke e përshtatur sjelljen e vet me normat e gjithë-pranueshme. Sipas kësaj, sjellja legjitime e policisë detyrimisht kërkon ruajtjen e autonomisë së nevojshme të organizatës policore, sepse në këtë proces vjen deri te përballja me ndikime të ndryshme shoqërore e politike.

### **Doktrina dhe strategjia e veprimit policor në funksion të opinionit**

Krijimit të modelit të ri të sistemit policor në shoqëritë demokratike, i cili nënkupton braktisjen e formave organizative në bazë të këshillave eksplicite për urdhër-dhënie, kujdes i veçantë duhet t’i kushtohet kryerjes shumë të përgjegjshme dhe me ndjeshmëri të detyrave zyrtare. Pra, policia në punën e saj duhet të jetë institucion i tillë që do të ruaj baraspeshën midis interesave zyrtare shtetërore dhe



interesave private. Për ta arritur këtë, në aktivitet e saj të ardhshme, policia duhet të përcjellë në mënyrë objektive dhe reale të gjitha aspektet e procesit zhvillimor, organizativ e operativ të saj. Përveç kësaj ajo duhet të analizojë vazhdimisht përvojat e saj nga të cilat duhet të nxjerrë mësim të cilat duhet t'i zbatojë në mënyrë adekuatë në procesin e krijimit të marrëdhënieve me opinionin. Nëpërmjet zhvillimit të vet organizativ e operativ, nëpërmjet sistemimit të njohurive shkencore e profesionale dhe të përvojave të saj, policia duhet të sigurojë bindjen e qytetarëve se policia është e ngarkuar para së gjithash me ruajtjen e rendit publik dhe që në opinion të krijohet bindja se detyrat e policisë, të cilat janë të përcaktuara me ligj, nuk janë vetëm veprime të bazuara në urdhra të ngurta. Kjo mund të arrihet nëse policia zbaton masat e saj me ndjenjën e përgjegjësisë, korrektësisë dhe ndjeshmërisë, me qëllim të parandalimit të krimeve, nxjerrjes para organeve të drejtësisë të personave që e shkelin ligjin, ruajtjes së rendit publik dhe ndihmës për krijimin e sigurisë për shoqërinë në tërësi. Vetëm në këtë mënyrë, ligjet bëhen synim i qytetarëve për përmbushjen e nevojave të tyre për siguri. Në rrethana të tilla, çdo polic është zyrtar potencial për marrëdhënie me opinionin. Sjellja e pjesëtarëve të forcave të policisë nuk është domethënëse vetëm për reputacionin e tyre, por edhe për organizatën policore në përgjithësi, sepse qytetarët i ndërtojnë mendimet dhe përshtypjet e tyre mbi policinë në bazë të kontakteve të tyre të shkurta zyrtare.

Për këtë arsye duhet të hiqet dorë nga logjika se drejtësia është sundimi i të fortit dhe se “liria është ligj që e lejon i forti”. Prandaj në procesin e kalimit nga modeli militarist në marrëdhënie tolerante rol të rëndësishëm ka pikërisht njohja e qytetarëve dhe opinionit me rolin e policisë dhe me vendin saj në bashkësinë brenda së cilës formësohen kodet etike e profesionale të sjelljes së saj. Profesionalizimi, i cili është një prej çështjeve më të rëndësishme, i mundëson policisë që të jetë vërtetë progresive, forcë mbrojtëse e dëshiruar dhe shumë e vlerësuar brenda bashkësisë, dhe jo të mbetet sistem i mbyllur i vlerave që drejtohet ekskluzivisht nga nevoja për forcë shumë të madhe shtetërore. Mirëpo edhe ky proces, si edhe shumë të tjerë mbartin në vete një dozë ambivalente, për shkak të arsyeve të përmendura. Përkundër këtyre pengesave, procesi demokratik e ka përfshirë edhe transformimin e policisë në institucion demokratik, e cila nuk duhet jetë e varur nga varësia e strukturave politike.

Në qoftë së kontaktet e policisë me opinionin marrin karakter institucional atëherë mund të thuhet me siguri se opinionin do të ketë qëndrim shumë pozitiv ndaj policisë dhe do ta vështrojë atë si shërbim që e mbron rendin demokratik dhe i shërben opinionit. Njëkohësisht opinionin do ta vështrojë policinë gjithnjë e më shumë si pjesë të shoqërisë, me veprimin e saj dëshmohet se strukturë e aftë organizative, si

institucion demokratik legjitim dhe si “promotor i ligjit”, i cili ka rol të definuar çartë dhe vlera morale dhe etike. Nuk ka dyshim se në një ambient të tillë bashkëkohor e civilizues edhe sistemi policor do të heqë dorë nga instrumentalizimi i rreptë i zbatimit të dhunës dhe do të shërbejë vetëm si organ shtetëror i dëgjueshëm dhe i autorizuar për zbatimin e detyrimit. Pikërisht për këtë është e nevojshme një marrëdhënie reciproke e balancuar, ku vijnë në shprehje të gjitha elementet që mund të kontribuojnë për avancimin e marrëdhënieve të arritura.

Por, policia duhet të dëshmojë gatishmëri dhe aftësi të madhe që t’i pranojë kritikën qëllimshme, të cilat do t’i ndihmojnë shumë për tejkalimin e tendencave animuese ndaj policisë dhe për vendosjen në plan të parë të modeleve pozitive të ndryshimeve të formës së bashkëpunimit, ku secili zyrtar do të jetë i përgjegjshëm maksimalisht. Në bazë të marrëdhënieve të tilla kooperative në opinion krijohet besimi i fortë në funksionin e policisë, e cila shndërrohet në personifikimin të shtetit, i cili në mënyrë shumë konstruktive e modifikon dhe e përshtat veprimtarinë e saj me situatën e përgjithshme të sigurisë në hapësirën e bashkësive lokale.

### **Ndikimi i opinionit në hartimin e përbashkët të programeve sociale-preventive në bashkësitë lokale**

Perceptimi i rëndësisë së njohjes së opinionit me veprimin e forcave të policisë, si shprehje dhe garanci e proceseve dhe sjelljeve demokratike në marrëdhëniet reciproke, përveç tjerash, nënkupton nevojën që operacionet policore të jenë të hapura për opinionin dhe mediat, përveç nëse kjo ndikon negativisht në procesin e kryerjes së detyrave policore ose në rastet kur për shkak të efikasitetit është e nevojshme ruajtja e sekretit. Informimi i detajuar mbi rrjedhën e aktiviteteve të policisë do të nxisë opinionin që të përfshihet më shumë në problemet e policisë, nevojën dhe interesin që të raportojë në polici për të gjitha problemet dhe çështjet me karakter preventiv. Në këtë mënyrë, praktikisht, ushtrohet veprimtaria shërbyese e policisë ndaj qytetarëve, të cilëve u sigurohet e drejta e drejta që, nëpërmjet mendimeve, propozimeve dhe përvojave të tyre, të kontribuojnë në hartimin e planeve për veprimin e policisë. Është e qartë se policia është vënë në pozitë që, në mënyrë të përhershme, në kontaktet e saj të përditshme me qytetarët, të prezantojë organizatën policore dhe profesionin e policit në përgjithësi. Policia duhet të kuptojë se ligji dhe zbatimi i tij, para së gjithash, ka për qëllim mbrojtjen e lirive demokratike në shoqëri. Në këtë kuptim, është shumë e rëndësishme që, në kontaktet e përditshme me qytetarë, policia të krijojë imazhin e vet, i cili është shumë i rëndësishëm për krijimin e besimit tek qytetarët, sepse asnjë profesion tjetër nuk është në eksponim gjykimit të opinionit sa policia. Në qoftë se policia

e dëmton autoritetin e saj, është shumë vështirë që të rikthejë besimin dhe kredibilitetin e qytetarëve. Për të evituar këtë situatë, në punën e saj të përditshme, policia duhet të dëgjojë mendimet e përshtypjet e opinionit, në mënyrë që të ndërtojë marrëdhënie të mira me qytetarët. Marrëdhëniet e mira janë faktor i rëndësishëm për formësimin e filozofisë së policisë.

Nevoja e opinionit për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në veprimtarinë e policisë, nëpërmjet të modelit të ri të organizimit për zbatimin e ligjshmërisë, i cili bazohet në garantimin e lirive, kërkon që policia t'i kryejë detyrat e veta sipas kërkesave, dëshirës dhe nevojave të shoqërisë në përgjithësi. Kështu arrijmë deri te përfundimi se policia nuk e bën ligjin, por i nënshtrohet ligjit. Marrëdhëniet e policisë me opinionin e zgjerojnë dhe begatojnë strategjinë e policisë. Kjo është bazë për aktivitete të suksesshme të policisë në zgjidhjen e problemeve themelore të sigurisë, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës në bashkësi.

Përpjekjet për zhvillimin e marrëdhënieve me opinionin, duke u çliruar nga kontaktet formale rutinore, bëjnë që opinionin ta trajtojë policinë si institucion shumë të interesuar të përfshijë qytetarët në procesin e hartimit të programeve sociale e preventive, sidomos në fushën e përcaktimit të prioritetëve. Kjo i nxit qytetarët që të japin propozime për shkatërrimin e kriminalitetit në hapësirën e bashkësisë lokale.

Pra, për hartimin dhe zbatimin e strategjisë dhe të objektivave të veprimit efikas, policia duhet të fitojë besimin e opinionit. Besimi mund të fitohet vetëm nëse policia, nëpërmjet angazhimit të vet, ndikon në zgjerimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit me qytetarë. Këto marrëdhënie ndërtohen dhe fitojnë marrëdhënie të reja në pluralizmin e sigurisë (rendi publik e qetësia, kriminaliteti, komunikacioni, etj.), nëpërmjet të cilave eliminohen tendencat e fetishizmit dhe të gjitha tezat e pranishme mbi aparatën policor, si organ ekskluzivisht represiv. Marrëdhënia kooperative për sigurimin e parakushteve të sigurisë për zbatimin e ligjit nëpërmjet demonstrimit të drejtësisë absolute në veprimet operative kërkojnë që policia në shoqërinë e sotme bashkëkohore të jetë inteligjente, e arsimuar, me vlera morale, e përgatitur, profesionale, e arsyeshme, e qetë në situata konfliktuale, me vetëbesim, e hapur, e sinqertë, diskrete në pajtim me procedurën policore, e kujdesshme, të mos e përdorë forcën apo kërcënimin psikik ndaj qytetarëve, në secilën situatë, gjatë aktiviteteve të saj të rregullta, t'i zgjedhë problemet, t'i eliminojë sjelljet negative, të jetë e paanshme, etj.

## **Puna demokratike e policisë si parakusht për afirmimin dhe autoritetin e saj në opinion**

Siç kemi thënë, suktesi dhe puna e organizatave policore varet shumë nga mbështetja e opinionit, jo vetëm kur bëhet fjalë për komponente shkencore dhe profesionale e operative, por edhe për veprimin e policisë në shoqërinë demokratike. Prandaj, do të përkujtojmë shkurt edhe disa pikëpamje të rëndësishme të cilat duet ta karakterizojnë praktikën policore konkrete: autoriteti dhe imazhi i policisë në opinion varet kryesisht nga veprimi i tërësishëm i saj, i cili duhet të bazohet në standardet e formësuar dhe të gjithë-pranueshme të punës së policisë në shtetin demokratik. Për këtë arsye duhet të përmendim shtatë parime themelore të cilat janë miratuar nga policia ndërkombëtare e OKB mbi punën e demokratike të policisë:

Policia duhet të udhëhiqet nga parimet demokratike dhe të punojë sipas tyre;  
Policia e cila gëzon besimin e opinionit duhet të jetë profesionale dhe veprimet e saj duhet të bazohen në kodeksin e sjelljes profesionale;  
Prioriteti kryesor i policisë duhet të jetë mbrojtja e jetës;  
Policia duhet t'i shërbejë opinionit dhe t'i përgjigjet atij;  
Mbrojtja e jetës dhe pasurisë është detyrë themelore e forcave policore;  
Gjatë kryerjes së funksionit të saj, policia gjithmonë duhet të kujdeset për respektimin e dinjitetit njerëzor dhe të drejtave themelore të njeriut;  
Policia duhet t'i kryejë të gjitha obligimet e saj pa diskriminime.

Midis këtyre shtatë parimeve themelore është edhe marrëdhënia e policisë me opinionit, e cila nuk mund ta sigurojë autoritetin, mbështetjen dhe ndihmën e opinionit me kurrfarë dekreti, as duke e konsideruara vetveten si instrument për mbrojtjen e shtetit dhe as me sjellje jo-korrekte ose me keqpërdorime të individëve brenda policisë. Sjelljet e tilla, përveç tjerash shkaktajnë ngarkesa të theksuara morale të zyrtarëve të policisë që i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të përgjegjshme dhe shembullore. Duhet të tërhiqet vëmendja se policia, me veprimet e saj të pamatura, e sidomos me tejkalimin e autorizimeve të përcaktuara me ligj, gjatë veprimtarisë së saj mund të rrezikojë liritë e njeriut më shumë se sa mund t'i mbrojë ato me masat e veta. çdo sjellje e paarsyeshme e policisë dhe udhëheqje sipas sintagmës “filozofia e vetëmbrojtjes”, pashmangshëm shpie deri të situatat konfliktuale. Për këtë arsye bashkëpunimi i suksesshëm me opinionin varet nga fakti se sa i zhvillon dhe i avancojnë policia standardet pozitive gjatë punës së saj të përditshme. Përveç kësaj aftësia e komunikimit të saj apo “politika e detyrës të hapura” i ndihmon policisë që të sigurojë dhe të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nga veprimet e paligjshme dhe arbitrare. Në anën tjetër, kjo kontribuon që strukturat policore të kujdesen me përgjegjësi të plotë mbi veprimet e

saj zyrtare dhe jozyrtare, të cilat duhet të jenë në pajtim me normat e përcaktuara të sjelljes.

Vetëm qasja korrekte, e ndërgjegjshme dhe e ligjshme e ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me etikën profesionale i bënë të respektueshme për opinionin detyrat e policisë, prandaj që operacionet e sigurisë që ndërmerren nga policia kërkojnë nivelin e nevojshme të transparencës për opinionin. Në këtë kuptim standardet etike në sistemin policor, për shkak të vet natyrës së veprimtarisë së saj, janë shumë më të rëndësishme se për cilëndo strukturë organizative të një shoqërie. Organizata policore që gëzon besimin e opinionit duhet të jetë profesionale dhe veprimet e zyrtarëve të saj duhet të bazohen në kodeksin e sjelljes profesionale. Me këtë duam të themi se policia nuk është vetëm profesion. Në shoqërinë demokratike ajo është shumë më tepër. Në të vërtetë besimi i opinionit ndaj policisë kërkon që ajo, në konceptin e saj mbi politikën shoqërore dhe praktikën konkrete policore, përveç analizës së konstantës së suksesit të veprimtarisë së saj duhet t'i kushtojë kujdes rëndësishëm diagnostifikimit të problemeve të sigurisë dhe sidomos që veprimtarinë e saj në perspektivë ta vështrojë si “ofrim të shërbimit” dhe jo si “përdorim të dhunës”. Në punën e saj të përditshme, nëpërmjet këshillave, veprimeve, udhëzimeve, vërejtjeve, propozimeve lidhur me çështje sociale preventive, policia avancoi afirmimin dhe autoritetin e saj, pa të cilin nuk mund as të mendohet planifikimi i suksesshëm i pjesëmarrjes së opinionit në formësimin e doktrinës dhe strategjisë konkrete të policisë. Vetëm duke ndërtuar marrëdhënie të mira me opinionin, organizata policore ka shans që ta përfitojë besimin e plotë dhe mbështetjen e opinionit. Pra, nevoja për ndërtimin e marrëdhënieve të dëshiruara të policisë me opinionin buron nga fakti se policia, si shërbim publik në funksion të mbrojtjes së sigurisë publike, dhe opinionin duhet të kuptojnë se vetëm në bazë të besimit reciprok krijohen mundësi dhe shanse që policia t'i zbatojë në mënyrë efikase detyrat e saj të përcaktuara me ligj, duke pasur mirëkuptimin e plotë të bashkësisë shoqërore.

Në të njëjtën kohë, opinionin pret që policia, duke respektuar normat e përgjithshme të demokracisë dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut gjatë kryerjes së operacioneve të veta duhet t'i japë prioritet qasjes preventive, e cila krijon parakushtet e nevojshme për iniciativë të reja reciproke midis policisë dhe opinionit. Duke aplikuar metodat moderne të rendit publik, veprimi policor fiton besimin e opinionit, gjë që është faktorë kyç për parandalimin e të gjitha dukurive dhe sjelljeve negative në shoqëri.

## **Marrëdhëniet strategjike të policisë dhe mjeteve të komunikimit masiv**

Komunikimi (latinisht *communicare*-shpërndaj, përhap), në kuptimin e përgjithshëm, përfshin çdo lidhje me kumtimin, njoftimin dhe qarkullimin e njoftimeve midis njerëzve, si edhe çdo akt të komunikimit, proces të komunikimi, përmbajtje dhe formë të lajmërimit dhe mjet për komunikim. Komunikimi nënkupton dy forma të tij: material dhe shpirtëror-politik. Në vet përcaktimin terminologjik dhe konceptin e mjeteve të komunikimit publik si edhe mënyrën e realizimit dhe shfrytëzimit hasen qasje teorike mjaft të ndryshme të shumë autorëve. Sociologjia, psikologjia sociale, politologjia, kibernetika dhe shkencat tjera përpiqen që të japin shpjegime përkatëse për këtë fenomen. Meqenëse objekti i interesimit tonë është marrëdhënia e policisë me mjetet e komunikimit publik (mediat), ne do të përmendim shkurtimisht vetëm disa pikëpamje që janë relevante për kuptimin e marrëdhënieve reciproke midis policisë dhe medias. Komunikimet kanë rëndësi të madhe për shoqërinë në tërësi. Pa komunikim të lirë mund të thuhet se shoqëria nuk do të mund të ekzistonte. Në kuptimin e saj funksional, mediat janë një prej faktorëve qenësor për formimin dhe ruajtjen e bashkësisë shoqërore. Siç ka theksuar Viener, duke siguruar vetëm veprim interaktiv të njerëzve, "komunikimi është bërë çimento në krijimin e organizatës". Sipas Robert North-it, "të gjitha organizatat, shoqëritë dhe shtetet janë ngritur mbi komunikime dhe ekzistojnë me ndihmën e tyre". Në përcaktimin terminologjik të komunikimit në masë të konsiderueshme vijnë në shprehje karakteri biheavioristik i kësaj shkolle të mendimit i cili është i orientuar sidomos në bashkimin e më shumë qasjeve bashkëkohore me sjelljen njerëzore, gjegjësisht në formësimin e modelit të sjelljes në marrëdhënie interaktive brenda shoqërisë bashkëkohore. Funksioni themelor i mjeteve të komunikimit publik duhet të jetë informimi i saktë, objektiv, me kohë, i përgjegjshme dhe kompetent i opinionit. Përveç kësaj, mjetet e informimit publik (mediat) duhet të krijojnë të gjitha parakushtet e nevojshme për lirinë dhe të shprehjes, për përhapjen dhe ngritjen e qëndrimeve përmbajtjeve kreative, për shkëmbimin e mendimit kritik të përvojave dhe të qëndrimeve si të shoqërisë ashtu edhe të qytetarëve. Mediat duhet të krijojnë kushte për afirmimin e transparencës politike ndaj qytetarëve dhe të transparencës së qytetarëve ndaj politikës. Në çdo shoqëri demokratike dhe shtet juridik respektimi i të drejtave themelore të njeriut dhe autonomia e individit janë të padiskutueshme dhe vlera të rëndësishme të civilizimit bashkëkohor. Informimi me kohë, shkëmbimi dhe qarkullimi i mendimeve i mundësojnë qytetarëve që si struktura të lira të ndikojnë në masë të konsiderueshme në ndryshimet e gjithmbarshme të shoqërisë. Këto ndryshime nënkuptojnë opinionin publik të bazuar në sistemin informativ bashkëkohor me harmonik. Mediat (radio, televizioni dhe shtypi) zakonisht konsiderohen si transmetues themelor të informacioneve më të rëndësishme.

Në shoqërinë bashkëkohore, komunikimi apo rrjeti i komunikimit të njerëzve është nevojë themelore për njohjen e koncepteve dhe nevojave të njerëzve të hapësirës demokratike, të hapur e të civilizuar nëpërmjet postulateve objektive dhe të pavarura dhe me kontrollin e nevojshëm publik të veprimit të tyre. Pra, mediat kanë për detyrë që të kontribuojnë ëpr krijimin e opinionit publik me qëllim të veprimit harmonik të njerëzve, i cili është karakteristikë themelore e të gjitha shoqërive. Po të mos ekzistonin nevojat për interaksion, vështruara në kuptimin më të gjerë, njerëzit nuk do të mund të harmonizonin veprimtarinë e tyre. Kjo do të kishte për pasojë zgjidhjen jo efikase të problemeve bashkëkohore politike, ekonomike, kulturore, etj. në shoqërinë bashkëkohore. Gjithë kjo tregon rëndësinë dhe karakterin e mediave, të cilat kanë edhe fuqi dhe aftësi të konsiderueshme për aktivizimin e mekanizmave social-psikologjik të shoqërisë, duke pasur parasysh se ato kanë ndikim të llojllojshëm tek qytetarët, pa edhe te opinionit publik në përgjithësi. Pikërisht për arsyet që u përmendën, mediat duhet të kenë përgjegjësi të madhe në shoqëri, gjë që shtron nevojën për dije përkatëse, për etikë profesionale e qytetare deh për transparencë të mediave ndaj mjedisit shoqëror, opinionit dhe qytetarëve. Në ndërtimin e shoqërisë civile bashkëkohore mediat duhet të krijojnë kushte demokratike e transparente për formësimin dhe krijimin e raporteve të tilla në shoqëri, në të cilat opinionit publik dhe mjete e komunikimit bëhen nevojë e patjetërsueshme për informimin e lirë, të pavarur dhe të përgjegjshëm të opinionit publik. çdo lajthitje e qytetarëve dhe opinionin, përmes propagandës dhe manipulimit të njerëzve mund të shkaktojë një sërë problemesh politike, sociologjike, psikologjike, etj. në shoqëri. Përpjekjet për krijimin e monopolit mbi mediat, me qëllim të krijimit artificial të opinionit dhe të transmetimit dhe interpretimit të njëanshme dhe tendencioz të dukurive dhe ngjarjeve shkakton edhe degradimin e vlerave individuale e kolektive të opinionit publik. Përpjekjet për vendosjen e formave të tilla të drejtimit në media janë të papranueshme për shoqërinë moderne. Kjo nënkupton vendosjen e kontrollit të përgjegjshëm publik dhe autonominë e mediave pa ndërhyrjen e organeve shtetërore, grupeve të interesit ose individëve të caktuar. Ruso ka thënë se “asgjë nuk është më e rrezikshme sesa ndikimi i interesave private në punët publike, madje edhe keqpërdorimi i ligjit në shoqëri.

### **Rëndësia e marrëdhënieve të policisë me mediat**

Në shoqërinë demokratike, policia e kryen funksionin e saj themelor duke u shërbyer qytetarëve ose duke ruajtur sigurinë e tyre. Pothuaj të njëjtin rol e kanë edhe mediat, sepse ato janë të obliguara që qytetarëve tu ofrojnë informacione të sakta, objektive, të vërteta dhe me kohë, në vëllimin dhe formën që është më e

përshtatshme për opinionin publik dhe qytetarët. Pra, bëhet fjalë për dy institucione të fuqishme, të forta dhe profesionale, objektivat e të cilave janë identike, sepse janë në shërbim të publikut, prandaj edhe ndikojnë në njëra-tjetrën. Bëhet fjalë për një simbiozë dhe antagonizëm që shpie deri te konfliktet e theksuara në marrëdhëniet reciproke. Por, vështruar nga aspekti historik, marrëdhëniet e policisë me media kanë marrë shpesh karakter armiqësor, gjë që ka quar në situatë që policia të evitojë bashkëpunimin me përfaqësuesit e mediave dhe në uljen e interesimin e saj për të dhënë informata. Policia ka reaguar në këtë mënyrë vetëm në raste kur përfaqësuesit e mediave janë përpjekur të arrijnë deri të informacioni me çdo çmim. Mirëpo, nevoja për ndërtimin e shoqërisë së hapur demokratike impono edhe krijimin e kanaleve të tilla, nëpërmjet të cilave realizohet ndikimi i lirë i njohur me ligj, formimi dhe shprehja e lirë e opinionit publik, i cili ka mundësinë që në mënyrë të pavarur të gjykojë punën e institucioneve të ndryshme dhe bartësve të funksioneve publike. Sa më i zhvilluar që të jetë ambienti demokratik, aq më shumë do të bëhen policia dhe mediat komponenta të rëndësishme të procesit të funksionimit të demokracisë dhe zhvillimit të personalitetit. Për kryerjen e funksionit të tyre mediat duhet të kenë qasje në informacione, të cilat ato kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë në pajtim me dispozitat kushtetuese. Objektivi i mediave është informimi në emër të qytetarëve të cilëve u shërbejnë, gjë që është funksioni themelor i tyre. Kjo duhet të theksohet për shkak se liria e mediave dhe qasja e tyre tek informacionet është një prej treguesve themelor të demokracisë. Së këndejmi, për policinë dhe mediat mund të thuhet se kanë objektiva të përbashkëta, sepse të dy palët punojnë në interes të qytetarëve. Në të vërtetë, policisë i nevojiten mediat për të fituar autoritetin respektiv në shoqëri, pasi ajo nuk ka mënyrë tjetër më të shpejt që të depërtojë në publik sesa nëpërmjet mediave dhe as mënyrë tjetër më efektive për krijimin e opinionit publik. Mediat i nevojitet policia për ofrimin e informacioneve nga fusha e sigurisë publike, sidomos mbi kriminalitetin, të cilat zgjojnë interesim të madh te shikuesit, dëgjuesit dhe lexuesit.

Sot, në shoqërinë bashkëkohore, falë mjeteve të komunikimit publik çështjet e sigurisë zënë vend të rëndësishëm. çdo institucion, pra edhe policia përpiqet që nëpërmjet mediave të prezantojë tema dhe probleme të shumta operative, duke vlerësuar se media mund të ndikojnë dukshëm në publik dhe në shoqëri, kështu që do t'i sigurojnë edhe vetes dhe punës së saj publicitet të mirë tek qytetarët, i cili do të shërbejë si forcë themelore dhe si nxitje në veprimin e mëtutjeshëm operativ.

Vlerësimi i mediave si institucione të fuqishme nuk është asgjë e re. Gazetari amerikan Valter Lipman, qysh në fillim të shekullit XX ka theksuar se mediat e sidomos shtypi “krijojnë bindjen ën kokat tona”. Mediat nuk është e thënë të ndikojnë në mënyrë direkte në orientimin e sjelljes njerëzore, por ato mund të kenë



ndikim të rëndësishëm në opinionin publik dhe të kontribuojnë në marrjen e informacioneve përmbajtjesore mbi veprimin e përgjithshme dhe punën e forcave të policisë në bashkësitë lokale. Është e njohur se mediat krijojnë “terma të ditës” politike, duke ndikuar në publik, sidomos kur bëhet fjalë për tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me aspekte të qenësishme të jetës shoqërore. Gjithsesi, këtu përfshihen edhe çështjet e sigurisë së qytetarëve, të cilat paraqesin parakushtet kanë rëndësi të veçantë për zhvillimin e marrëdhënieve të përgjithshme në bashkësi. Vetëm qytetari i lirë i cili është i informuar në mënyrë objektive, të saktë, të plotë dhe me kohë, mund të jap mendimin e tij dhe të marrë qëndrimin e tij lidhur me opinionin publik, gjë që është vlera më e lartë e shoqërisë demokratike. Midis lajmeve kryesore gjatë procesit të zhvillimit të bashkësisë shoqërore dhe civilizimit të saj janë edhe ato për forma të ndryshme të kriminalitetit. Edhe në dokumentet historike religjioze gjenden tekste që flasin për krimet. Në rrethanat e sotme shoqërore ndikimi i mediave në dukuritë e ndryshme kriminale dhe në ngjarjet e sjelljet e papranueshme ndonjëherë mund të kenë karakter shkatërrues. Mediat që vendosin të transmetojnë informacione kërkojnë edhe treg masiv, pasi informacionet janë prodhim i tyre për qytetarët që kanë të drejt të jenë të informuar. Mirëpo, përfaqësuesit e mediave dhe gazetarët duhet të kenë kujdes që gjatë kryerjes së detyrave të tyre t’u përmbahen normave dhe standardeve të tyre etike e profesionale. Pavarësisht prej këtij obligimi. Logjika e prodhimit të lajmeve, kërkesat që dalin nga tregu masiv, nevoja e prodhimit dhe përgatitjes së informacioneve të ndryshme, rivaliteti ndërmjet shtëpive mediave në planifikimin dhe realizimin e objektivave mediave ndonjëherë, sjellin edhe deri te “përpunimi” dhe “zbukurimi” i informacioneve para publikimit të tyre. Kështu vjen deri te shtrembërimi i disa fakteve, vështirësimi i informimit të saktë dhe, shpesh, edhe deri të senzacionalizmi.

Mediat, gjithnjë e më shumë dhe gjithnjë e më me sukses, shërbejnë edhe me informacione nga fusha e sigurisë së sidomos nga lufta kundër kriminalitetit, kështu që luajnë një rol të rëndësishëm të rendit publik dhe të sigurisë. Megjithatë, kërkesat e mëdha të mediave ndonjëherë bëjnë që informacionet të shfrytëzohen në mënyrë shumë rutinore. Temat mediatike mbi krimet, zbulimin e tyre dhe punën e policisë zgjojnë vëmendje të madhe tek opinioni, kështu që rubrikat për punën e policisë po bëhen gjithnjë e më të çmueshme për qytetarët. Kërkesa e pangopshme për informacione mbi kriminalitetin i ka shtyrë përfaqësuesit e mediave që të hulumtojnë të dhëna të cilat kanë ndikim të caktuar në qëndrimin e opinionit mbi policinë dhe punën e saj në luftimin e kriminalitetit. Kështu vijmë deri të marrëdhëniet më të ndjeshme të cilat policia duhet t’i ketë me mediat, nëpërmjet të cilave komunikon me publikun. Por kjo, shumë shpesh bëhet nga qëndrime

diametralisht të kundërta, gjë që po ashtu shumë shpesh shpie deri te mosmarrëveshjet, te humbja e besimit, madje edhe te situatat konfliktuale.

### **Konfliktet midis policisë dhe mediave**

Në marrëdhëniet midis policisë dhe mediave ka pasur dhe ka edhe sot e gjithë ditën keqkuptime dhe rivalitetet, të cilat shprehen sidomos në vështirimin e dinamikës së rëndësishme të tyre të dyanshme në opinion dhe në shoqërinë në përgjithësi. Përkundër faktit se policia dhe mediat janë në shërbim të publikut, punojnë në interes të qytetarëve dhe funksionet e tyre i kryejnë në një ambient ku liria e mediave dhe policia profesionale paraqesin bazën e demokracisë parlamentare, të cilat plotësohen reciprokisht në realizimin e objektivave globale, ndonjëherë vjen edhe deri te tensionimi i marrëdhënieve midis tyre. Organizata policore e ka shumë të qartë se veprimtaria dhe fuqia e mediave është jashtëzakonisht e madhe dhe se niveli i marrëdhënieve e bashkëpunimit me publikun, në instancë të fundit, varet se si e vështrojnë publiku policinë dhe cili është reputacioni i saj në shoqëri. Po ashtu, policia e ka të qartë se imazhi i saj varet nga mënyra e prezantimit të informacioneve të karakterit të sigurisë në opinionin publik. Nga ana tjetër, qytetarët e shoqërisë demokratike e kanë të garantuar të drejtën e informimit, privacinë dhe dinjitetin njerëzor. Sot, nuk mund të trajtohet një temë në media e të mos flitet mbi problemet e sigurisë. Kështu, qytetarët shohin në media skena të ndryshme të kriminalitetit dhe forma e aspekte të ndryshme, përfshirë edhe format më komplekse të dhunës. Është e drejtë e ligjshme e mediave që të publikojnë informacione të tilla. Gama dhe lloj-llojshmëria e ndikimit medial ndikon dukshëm në formimin e opinionit publik, madje edhe në orientimin dhe ndikimin e tyre negativ në zhvillimin e kriminalistikës (Kegels, 1982, f. 212). Ndikimi i mediave në opinionin publik mund të shkaktojë edhe probleme të caktuara në marrëdhëniet midis shërbimit për zbatimin e ligjit (policisë) dhe mediave. Informimi i publikut nga mediat dhe formësimi i mendimit të tij, pra edhe përshtypja për veprimin e policisë, ka shkakuar njëfarë klime mosbesimi. Në situata të caktuara kjo mund të shkaktojë probleme shumë më të thella në fushën e sigurisë, sidomos kur bëhet fjalë për forma komplekse të krimit të organizuar. Në media, sidomos në shtyp, ndonjëherë publikohen në formë shqetësuese çështje që kanë të bëjnë me kriminalitetin. Ato publikojnë edhe informacione spektakulare, intriguese e shokuese, duke vlerësuar se do të pranohen nga publiku. Është e qartë se në këso rastesh bëhet fjalë për qëllime komerciale të mediave. Gjatë raportimit, shpesh bëhen teprime dhe policia akuzohet pa të drejtë se nuk është efikase apo se është e pafuqishme për mbrojtjen e sigurisë.

Në këtë mënyrë krijohet ndjenja se qytetarët më shumë i blejnë gazetat për të lexuar informacionet që u sjellin gazetave përfitime materiale, por te policia kjo krijon marrëdhënie animoziteti ndaj mediave. Me këtë pikëpamje nuk duam të mbrojmë policinë. Përkundrazi, duam që nga aspekti shkencor të nxjerrim në shesh disa çështje të rëndësishme, të cilat ndikojnë dukshëm si në kryerjen e funksioneve si të medias ashtu edhe të policisë. Ndikimi i mediave në krijimin e ndjenjës së pasigurisë nuk duhet të vështrohet ekskluzivisht si problem i kohëve të sotme. Kërkesa për informacione senzacionaliste nga fushëveprimi i policisë shkakton tek qytetarët gjithnjë e më shumë ndjenjës e frikës nga krimet. Këtu nuk vëmë në pikëpyetje nevojën e qytetarëve për mbrojtje përkatëse nga të gjitha format e rrezikut të rendit publik dhe qetësisë. Por, “frika dhe manipulimi me të mundësojnë shitjen e ideve, shtimin e fondeve dhe zgjerimin e programeve të shtëpive mediatike (Andre Lemaitre, *Revue Internationale de criminologie et de police technique*, nr 2, 1989, f. 185-195). Pikërisht për këto dhe për arsye të tjera mbi të cilat do të bëjmë fjalë edhe më tutje, frika dhe mosbesimi është pasojë e mungesës së komunikimit të mirëfilltë dhe e mungesë së mirëkuptimit, të cilat janë obligime të secilës palë (policisë dhe mediave), me qëllim të informimit me kohë e objektiv të publikut. Në këtë kuptim, duhet të përmendim edhe disa aspekte të rëndësishme për pasqyrimin e marrëdhënieve konfliktuale ndërmjet policisë dhe mediave.

Policia mendon se, ndonjëherë, gjatë kryerjes së detyrës së tyre, përfaqësuesit e mediave janë radikalë dhe agresivë në kërkimin e informacioneve dhe plasimin e tyre në publik. Synim i tyre kryesor është që të punojnë shpejt e me efikasitet për të plasuar të parët informacionet në shumësinë e shtëpive mediatike. Në këtë garë përfaqësuesit e mediave ndonjëherë shërbejnë edhe me raporte të pasakta, publikojnë informacione të ndjeshme dhe e keqpërdorin besimin e zyrtarëve të policisë, duke i publikuar si zyrtare bisedat dhe raportet jozyrtare.

Policia, sidomos përfaqësuesit e policisë kriminalistike, të cilat janë përgjegjës për kryerjen efikase dhe me kohë të veprimeve të ndryshme operative-kriminalistike lidhur me veprat penale, i vështrojnë përfaqësuesit e mediave dhe reporterët e tyre si pengesë që frenon përmbushjen e obligimeve të tyre ndaj publikut. Për këtë arsye, policia kriminalistike është e detyruar të mos i japë disa informacione, publikimi i të cilave mendon se do ta vinte në pikëpyetje angazhimin e saj për realizimin e masave dhe aktiviteteve konkrete që i ka planifikuar më parë. Përveç kësaj, policia mendon se informacionet e publikuara mund t’u shërbejnë kriminaleve si paralajmërim për arrestimin eventual, gjë që do të rrezikonte sekretin e masave operative. Kështu, do të vihej në pikëpyetje arrestimi i kriminelëve dhe, rrjedhimisht, do të shfaqej rreziku për sigurinë e viktimës ose të dëshmitarëve. Duke kujtuar përvojat e mëhershme negative me media, policia mendon se hapja

më e madhe ndaj publikut do të dobësonte strategjinë e saj të përgjithshme të veprimit, sepse, për shkak të këtyre marrëdhënieve, shumë shpesh kanë dhënë përgjegjësi para niveleve më të larta të hierarkisë.

Konflikti interesave dhe objektivave të policisë dhe mediave mund të shkaktojë antagonizma të thella midis tyre, sidomos kur policia i mban me të drejtë informacionet që kanë të bëjnë me informimin e familjes së ngushtë apo janë në interes të sigurisë së publikut, me qëllim që në mënyrë efikase të mbrojnë hetimet. Gjithashtu, policia mendon se mediat kanë paragjykime të trashëguara për policinë dhe se përfaqësuesit e mediave, në disa raste, kur duhet të manifestohet ndjenja e solidaritetit me viktimën e krimit, publikojnë informacione të paverifikuara or materie të ndjeshme, kështu që vënë në pikëpyetje besimin e policisë.

Në veprimet hetimore, të cilat kanë dimension kompleks e të ndjeshëm si edhe komponentë shumë të rëndë operativo-taktike e teknike, reporterët e mediave ngulmojnë të sigurojnë të dhëna të vlefshme, për ta ofruar publikut si sensacione. Mënyra se si mediat e informojnë publikun mbi kriminalitetin, rendin publik e qetësinë, etj., krijon bindjen e policisë se ato, shpesh, përpiqen të japin pamje të shtrembëruar e senzacionaliste të gjendjes së fushës së veprimit të policisë.

Mjaft shpesh, në sytë e policisë, mediat stërmadhojnë, dramatizojnë dhe shtrembërojnë informacionet, me qëllim të arritjes së efekteve komerciale. Këtë e arrijnë duke bërë një përzgjedhje shumë të përgjithshme të incidenteve apo ngjarjeve kriminale dhe duke vënë në plan të parë aktet e dhunshme apo pasojat e tyre (dhunën, brutalitetin, vrasjet, etj.), të cilat tërheqin shumë më tepër vëmendjen e publikut.

### **5.9. Vështrim kritik në konfliktet midis policisë dhe mediave**

Në tekstin më sipër përmendëm disa vatra të marrëdhënieve konfliktuale midis policisë dhe mediave, si edhe konfliktet më serioze që kanë shkaktuar implikime negative në disa segmente të punës së policisë. Duke u nisur nga dispozitat kushtetuese, mediat, si institucione publike juridike, të cilat kanë para së gjithash karakter komercial, kanë të drejtë dhe janë të obliguara të informojnë drejt opinionin. E drejta e sigurisë është një prej faktorëve kryesorë për garantimin e lirisë, barazisë dhe të drejtave tjera të qytetarëve. Konfliktet e përmendura më sipër, shtrojnë nevojën për trajtimin kritik të marrëdhënieve reciproke midis policisë dhe mediave. Është e qartë se në të gjitha shtetet demokratike, me demokraci pluraliste dhe sundimin e ligjit, sidomos më etnitete të ndryshme, nuk ekziston një opinion

homogjen, i cili do të kishte një vlerësim të harmonizuar të vlerësimit në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Përkundrazi. Në shoqërinë civile moderne e të hapur, në të cilën mediat janë shumë të zhvilluara, është reale të pritët shfaqja e vlerësimeve antagonistë, e cila është shprehje e të drejtës demokratike dhe të lirisë së mendimit e të artikullimit të qëndrimit të opinionit publik. Kjo është rezultat i respektimit të postulateve themelore të kulturës demokratike politike e të sigurisë.

Mediat e vështrojnë policinë si strukturë tradicionale të mbyllur e mjaft të pakapshme dhe me sistem të tejkaluar burokratik e soldatesk të marrëdhënieve dhe sjelljeve, si brenda organizimit ashtu edhe ndaj opinionit. Mediat konsiderojnë se policia, edhe në procesin e transformimit të vet, ka ruajtur një dozë të mosbesimit dhe jokooperativitetit ndaj mediave, se është ende jo mjaft transparente dhe se manifeston një shkallë të caktuar cinizmi, gjë që shkakton një frymë gare në marrëdhëniet midis policisë dhe mediave. Sipas qëndrimit të mediave, në veprimin e policisë është ende ka „fshehtësi“, gjë që është problemi kryesor për punën e mediave, pasi ato nuk mund të marrin informacionet e kërkuara, të cilat kanë të drejtë t'i kenë. Së këndejmi del se policia nuk shpreh ende interes të mjaftueshëm për bashkëpunim me mediat. Shikuar globalisht, policia zakonisht merr qëndrim reaktiv ndaj mediave. Mediat ankohen shpesh se reporterët e tyre nuk informohen qëllimisht për situata të caktuara të sigurisë, gjë që konsiderohet si një „ndëshkim“ i tyre për shkrimet e tyre negative për policinë.

Me këtë nuk duam të themi se policia është përgjegjëse për krijimin e kësaj gjendjeje, por duam të apostrofojmë disa çështje të cilave policia nuk u ka kushtuar kujdes sa duhet, gjë që në masë të konsiderueshme ka ndikuar në mospajtime dhe mendime jofunksionale, të cilat i kemi trajtuar më sipër. Arsytet duhet të vështrohen në kontekst të proceseve organizative dhe në mënyrën e fundme objektive, sepse edhe mospajtimet në këtë fushë mund të kenë efekte shumë pozitive, në qoftë se ato janë parimore. Këtë e theksojmë posaçërisht me që përfaqësuesit e mediave kanë përshtypjen se policia nuk i pranon kritikën e arsyeshme për zhvillimin e saj dhe as nuk pajtohet me faktin se nëpërmjet mediave bëhet verifikimi i ligjshmërisë dhe keqpërdorimeve të mundshme të policisë, si organ legjitim i pushtetit shtetëror. Këtu mund të përmenden edhe shumë akuza reciproke, por këtu vetëm i kemi prekur disa situata konfliktuale, të cilat mund të shërbejnë si motiv për të konstatuar se në bazë të analizave kritike të marrëdhënieve reciproke, të theksojmë nevojën për vendosjen e marrëdhënieve të reja, si lidhje simbioze, pasi edhe policia edhe mediat janë në shërbim të realizimit të objektivave të njëjta në shoqëri.

Në punën e deritashme të policisë nuk i është kushtuar kujdes i mjaftueshëm mjeteve të informimit publik, e të mos flasim për arsimimin e kuadrit për kryerjen e

këtyre punëve shumë të përgjegjshme, prej të cilave varet shumë edhe autoriteti i policisë në shoqëri. Në të vërtetë, marrëdhëniet me mediat or shumë kohë kanë qenë në margjina të veprimit të policisë dhe janë trajtuar si çështje të dorës së tretë. Kjo ka ndodhur për shkak se policia nuk ka qenë e përgatitur as me kuadro dhe as mjete teknike e materiale për prezantimin e problematikës së saj nëpërmjet mediave. Se çfarë kujdesi i është marrëdhënies me publikun, pra edhe me mediat, flet fakti se zyrtarët e policisë e kanë konsideruar këtë si punë dytësore e të parëndësishme, për shkak se, natyrisht, është dashur t'i kushtojnë kujdes të veçantë detyrave të tyre të rregullta themelore. Marrëdhëniet me media janë trajtuar si aktivitete shtesë, jo të obligueshme, vullnetare dhe, ndonjëherë, janë konsideruar edhe si barrë shtesë dhe si veprimtari që nuk është me interes për pjesëtarët e policisë. Policia nuk ka qenë fare e njoftuar me mënyrën e punës me mediat, sidomos kur bëhej fjalë për çështje lidhur me forma komplekse të kriminalitetit. Kështu, të paudhëzuar, të ngarkuar me obligimet e tyre dhe me qëndrim tepër reaktiv ndaj përfaqësuesve të mediave, policët është dashur të japin informata. Natyrisht, kjo ka shkaktuar marrëdhëniet konfliktuale me mediat. Detyrë prioritare e policisë ka qenë kryerje e efikase dhe me kohë e detyrave të përcaktuara operative, prej të cilave është varur edhe reputacioni i saj në shoqëri. Në punën e policisë ka munguar nevoja për një prezantim sa më të mirë të aktiviteteve të saj në publik, pra edhe për fitimin e besimit dhe autoritetit të saj te qytetarët. Për shkak të qëndrimit të tillë, puna me publikun dhe, sidomos, me përfaqësuesit e mediave ka marrë konotacione negative, prandaj edhe paraqitja në sytë e publikut ka qenë shpesh edhe reklamë negative për kryerjen e detyrave të saj shumë komplekse dhe me përgjegjësi. Pikërisht për shkak të mosnjohjes së rolit të marrëdhënies me media për krimin e imazhit të saj në shoqëri, si edhe për shkak të mungesës së kuadrit të përgatitur e të aftë, ka pasur situata të tilla që policia të informojë mjetet e informimit për ndërmarrjen e veprimeve para-hetimore, gjë që është reflektuar negativisht në ndërmarrjen e aktiviteteve tjera tekniko-teknike e të tjera. Për shkak se punëve mbi marrëdhëniet me mediat u është kushtuar rëndësi e pamjaftueshme dhe prezantimin e informacioneve në media e kanë bërë zyrtarë të policisë që nuk kanë qenë mjaft të informuar e as mjaft të përgatitur për këtë punë, ka ndodhur që të dilet edhe me të dhëna jo të plota, madje edhe të publikohen të dhëna që u kanë shkaktuar dëme të paarsyeshme njerëzve, dyshimi i bazuar ndaj të cilëve është konstatuar si i paarsyeshëm, gjatë procesit të mëvonshëm. Ndërkaq, vonesa e panevojshme dhe e paarsyeshme e shpërndarjes së informacioneve apo fshehja pa paramendim e informacioneve i ka intriguar përfaqësuesit e mediave që me vetiniciativë të fillojnë hulumtimet e tyre, të cilat kanë pasur rezultate joprofesionale. Por, edhe në rrethana të tilla, për shkak të mungesës së kuadrit që do ta përcillte këtë fushë në mënyrë permanente, kanë munguar demantet, madje edhe kur janë publikuar përmbajtje të pasakta. Kjo shpie në konstatimin se policia

nuk i ka kushtuar rëndësi analizës përmbajtjesore të atyre të dhënave që u janë kumtuar qytetarëve, nëpërmjet mediave.

Po ashtu, midis policisë dhe mediave nuk i është kushtuar rëndësi e mjaftueshme marrëveshjes, madje as në rrethana të jashtëzakonshme, kur, në bazë të vlerësimeve kriminalistiko-taktike, të dy palët mund të obligoheshin të respektonin “moratoriumin” e dhënies të informacioneve. Situata konfliktuale do të shkaktojë edhe në të ardhmen tensione, të cilat do të çojnë në humbjen e besimit midis policisë dhe mediave, në qoftë se ato depërtojnë në publik, kështu që mund të ndodhë që qytetarët të kenë qëndrim negativ ndaj policisë. Me qëllim të tejkalimit të vështirësive në marrëdhëniet midis policisë e mediave është e domosdoshme që t’i kushtohet vëmendje e madhe hartimit dhe hartimit të strategjisë së re të marrëdhënieve të policisë me mediat.

#### **5.10. Arsyet e sigurisë për hartimin e strategjisë së re të marrëdhënieve midis policisë e mediave**

Sot, në shtetin modern, i cili është shkalla më e lartë e realizimit të të drejtave të njeriut, që burojnë nga të drejtat themelore, vlerë themelore është liria e mendimit, e cila ka një ndikim të madh në sistemin e tërësishëm politik e juridik dhe në sistemin e sigurisë. Objektivi kryesor i çdo shteti modern është garantimi i shkallës së lartë të sigurisë. Si mjet kryesor për realizimin e këtij objekti janë normat juridike. Këtu bëjnë pjesë edhe marrëdhëniet midis policisë dhe opinionit publik si edhe marrëdhëniet e policisë me mediat. Në veprimtarinë e saj të përditshme në komunikim me zyrtarët, policia i veshon qytetarët si individë të mbrojtur me një numër të madh ligjesh, ndërsa qytetarët e vështrojnë policinë si shërbim për zbatimin e ligjeve të shtetit të lirë demokratik. Detyrë fundamentale e policisë është që të kujdeset për sigurinë e të gjithë qytetarëve. Në zbatimin e kësaj veprimtarie, strukturat shtetërore përpiqen që objektivat e tyre t’i shpjegojnë edhe në mënyra të tjera e sidomos nëpërmjet mediave, në formë të këshillave dhe propozimeve të ndryshme, me qëllim të parandalimit të situatave konfliktuale. Policia po lirohet gjithnjë e më shumë nga praktika e kërcënimeve me sanksione për shkak të shkeljes së akteve të ndryshme normative. Format be përmendura të veprimit shtetëror janë dëshmuar shumë efikase dhe efektive, me që qytetarët gjithnjë e më shumë po binden se organet shtetërore të ngarkuara me çështje të sigurisë po lirohen nga praktika e mëhershme dhe po aplikojnë praktika të reja që me ndihmën e qytetarëve të krijojnë parakushtet për marrjen e vendimeve. Mirëpo, pavarësisht nga hapësira e lirë e veprimit, duhet të themi se asnjë shtet modern demokratik nuk mund të heqë dorë nga funksioni i tij, e ky është monopoli legjitim i përdorimit të dhunës, me që në situata të caktuara organet për ruajtjen e sigurisë personale të pasurisë nuk mund

të mbështeten në metodat e bindjes së qytetarëve pasi kjo do të kishte implikime për sigurinë. Në këso rrethanash, policia duhet të reagojë dhe të marrë vendime të shpejta me qëllim të parandalimit të prishjes së segmenteve të caktuara të sigurisë. Të gjitha këto aktivitete duhet të zhvillohen publikisht, në sy të publikut dhe opinionit. Të gjitha institucionet publike, pra edhe policia, në kuadrin e fushëveprimit të saj, duhet të veprojnë në mënyrë permanente dhe të bashkëpunojnë për paraqitjen e saj të jashtme. Kjo është detyrë e mjeteve masive të komunikimit.

Sot, të gjitha institucionet e një shteti, duke u udhëhequr nga parimi themelor i transparencës, përpiqen që veprimtarinë dhe shërbimet e tyre ndaj qytetarëve t'i prezantojnë sa më mirë, në mënyrë që të ndërtojnë imazhin e vet dhe të kenë ndikim në sjelljen shoqërore. Policia ka qenë për një kohë të gjatë në prapavijë, gjë që ka shkaktuar mosbesim dhe marrëdhënie konfliktuale me mediat. Është e rëndësishëm të thuhet këtu se të gjitha shërbimet publike, për dallim nga industria dhe degët tjera, kanë një rol krejtësisht tjetër me këtë ambient. Shteti nuk mund të bëjë reklamë për shërbimin e vet – policinë, as të ndikojë në ngritjen e autoritetit të saj në opinion, sepse krijimi i një pamjeje objektive mbi punën e policisë është shumë detyrë delikate, e vështirë dhe specifike. Siç kemi thënë, veprimet e policisë sot janë të dukshme për publiku gjë që krijon mundësinë për shqyrtimin e veprimeve të saj. Në rrethanat e mëhershme dhe në marrëdhëniet midis policisë dhe mediave ka qenë i pamundur zhvillimi i komunikimit reciprok midis policisë dhe publikut, kështu që policia nuk ka arritur t'i informojë qytetarët në mënyrë të përshtatshme mbi çështje shume të rëndësishme. çdo informatë drejtuar publikut paraqet fundament për demokracinë e vërtetë. Në këtë kontekst mund të theksohet se objektiv themelor i punë së policisë është siguri i ndihmës dhe besimit të qytetarëve, si edhe pjesëmarrja e tyre në hartimin e programeve sociale-preventive, të cilat sigurojnë njëkohësisht kontroll më të madh të publikut me punën e policisë. Ndryshimet demokratike, ndërtimi i institucioneve që ka ndikim relevant në punën e policisë dhe kërkesat për qasje në veprimin e saj e ka detyruar policinë që të ndryshojë pikëpamjet dhe t'i kushtojë rëndësi më të madhe hartimit të politikës së informimit të qytetarëve dhe shoqërisë në përgjithësi. Punën me publikun dhe marrëdhëniet me publikun, pra edhe me mediat, policia e kupton gjithnjë e më shumë si një prej postulateve themelore për fitimin e besimit dhe mirëkuptimit të opinionit publik për objektivat dhe detyrat e përcaktuara, për problemet e manifestuara, etj.

Siç kemi theksuar më sipër, roli i punës me përfaqësues të mediave është perceptuar dhe konceptuar në mënyra të ndryshme. Por, kjo fushë ka rol aq të rëndësishëm sa në kushtet e sotme bashkëkohore polica do të mbetet vetëm një instrument i ngurtë i piramidës shtetërore pa një strategji përkatëse të ndërtimit të marrëdhënies me mediat. Kjo do të thotë se edhe policia duhet të formësojë marketingun e vet, i cili



do të mund të quhej “marketing social preventiv”. Sipas autorëve të shumtë, togfjalëshi “marketing social preventiv” mund të përdoret pasi që shpreh premisën e ndryshimit të marrëdhënieve. Në këtë kuptim, sistemi policor i një shteti ofron shërbim me rëndësi të veçantë shoqërore për qytetarët – sigurinë e tyre. Në anën tjetër, si kundër-shërbim për ruajtjen e sigurisë së tyre, qytetarët i paguajnë shtetit taksa të ndryshme nga të cilat sigurohen edhe mjetet materiale për punën e sigurisë. Aftësia e formësimit të marrëdhënieve të reja dhe mirëkuptimit të tyre hap horizont dhe mundësi për veprimin e përditshëm të policisë në uljen e situatave konfliktuale dhe për ngritjen e autoritetit të policisë në opinion. Për shkak të marrëdhënieve jo mjaft të zhvilluara me mediat, diskutimi publik mbi veprimin e policisë është ende në nivel shumë të ulët, prandaj në opinion ekzistojnë ende paragjykime. Kjo nxjerr në shesh nevojën e një komunikimi sistematik dhe të përhershëm të policisë me opinionin publik, të bazuar në objektivat strategjike për realizimin e funksionit të policisë në shoqëri. çdo institucion publik, pra edhe policia, synon të formësojë objektivat e veta, nëpërmjet realizimit të të cilave përpiqet të arrijë gjendje ideale të sigurisë, e cila është synim i sanksionuar me kushtetutat dhe ligjet e të gjitha shteteve moderne demokratike.

#### **5.11. Politika e re e marrëdhënieve midis policisë dhe mediave**

Në punën e saj, policia duhet të lirohet nga marrëdhëniet e deritashme stereotipe me mediat, në çoftë se dëshiron të reagojë shpejt dhe në mënyrë efikase ndaj disa ngjarjeve dhe ta informojë publikun për këtë, policia duhet tua jap informacionet përkatëse përfaqësuesve të mediave, nga publikimi i të cilave varet në masë të konsiderueshme raporti i qytetarëve me policinë. Shumë hulumtime të kryera lidhur me temën e parandalimit të prishjes së rendit publik e qetësisë dhe të aktiviteteve kriminale tregojnë se mediat “e shtojnë rrezikun nga krimet”, se ndikojnë në rritjen e kriminalitetit, sidomos të të miturve, se gjeneratat e reja, nën ndikimin e mediave dhe pasqyrimit të dhunës “ndikojnë në rritjen e delikuencës së të miturve”, sidomos në qoftë se ata në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet mediave shohin forma të ndryshme të dhunës. Shfaqja e akteve të dhunshme, me elemente të egërsisë dhe sadizmit ndikon shumë negativisht te të rinjtë në procesin e socializmit. Kjo ka ndikim shkatërrues në sistemin psikologjik të të miturve, gjë që shprehet edhe në procesin e zhvillimit të tyre psiko-social. Sipas disa autorëve të tjerë, pasqyrimi i dhunës në media nuk është faktori kryesor për formimin e rrethanave për kryerjen e veprave penale, por faktorë që ndikon në shtimin e mundësive që disa persona të ndikuar nga mediat të sillen në mënyrë agresive, gjë që mund të shpije në situata të padëshirueshme shumë shpesh. Pavarësisht nga këto pikëpamje të papajtueshme është e padiskutueshme se mjetet masive të komunikimit të cilat, në formë të

veçantë të komunikimit shoqëror, krijojnë lidhjen e qytetarëve me shoqërinë, kështu që mund të bëhen partnerë i rëndësishëm i policisë dhe mund të pasqyrojnë në mënyrë objektive rolin dhe punën e saj. Ndërtimi i marrëdhënieve të policisë me mediat është imperativ, sepse mediat janë faktorë i fuqishëm ndikimi, sidomos në kushtet e hartimit të strategjisë së re të veprimit të policisë në bashkësitë lokale. Së këndejmi, policia duhet të jetë shumë e interesuar që mediat, nëpërmjet informacioneve të tyre të zhvillojnë konceptin e sigurisë së përgjithshme dhe perceptimin e formave të ndryshme të rrezikut të segmenteve të ndryshme të sigurisë. Njëkohësisht, ato afirmojnë nevojën e domosdoshme të veprimit të përbashkët të policisë dhe publikut për eliminimin e rreziqeve dhe parandalimin e sjelljeve dhe dukurive kriminale.

Komunikimi i gjithanshëm në relacionin polici – media, në njëfarë mënyre, është edhe problem social – psikologjik, ku dallimet themelore të karaktereve mund të jenë një prej arsyeve për kundërshti dhe konflikte. Në bazë të hulumtimeve të deritashme mund të konstatohet se policia mbështetet në mendimin dhe arsyen e qytetarëve gjatë marrjes së vendimeve, ndërsa redaktorët dhe reporterët mbështeten në ndjenja dhe në intuitë. Për të evituar dhe eliminuar raportet stihike, spontane, sporadike dhe jo të obligueshme, në të ardhmen shtrohet domosdoshmëria për formësimin e parimeve themelore, në mënyrë që qytetari i rëndomtë të jetë i informuar me punën e policisë dhe të ketë pasqyrë të caktuar për objektivat e saj, nëpërmjet mjeteve masive të komunikimit. Për këtë arsye, policia duhet t'i drejtohet opinionit nëpërmjet mediave, në mënyrë të organizuar e të planifikuar. Në këtë rast, aktivitetet e policisë nuk mund të ketë më funksion të tërthortë dhe joobligues. Përkundrazi, nëpërmjet zyrtarëve të ngarkuar për punë me publikun dhe policëve të përgatitur mirë, policia do të ndërtojë raporte të mira më përfaqësuesit e mediave në situata të ndryshme. Policia, sikurse edhe çdo sistem tjetër shtetëror, përcakton mënyrën e realizimit të objektivave të saj. Një prej faktorëve të rëndësishëm për këtë është edhe shkalla e njohjes së opinionit me veprimet e policisë, e cila bëhet nëpërmjet mediave. Kështu arrijmë të konstatimi qendror se informimi me kohë i publikut mbi masat për mbrojtjen e sigurisë dhe luftën kundër kriminalitetit është një prej segmenteve të rëndësishme për mbrojtjen e sistemit të sigurisë. Pra, duke ndërtuar strukturën e besimit mbi postulatet harmonike me ndihmën e mediave, policia do të jetë në gjendje që të jetë bartëse e krijimit të atmosferës së mirëkuptimit, besimit dhe respektimit reciprok.

Parakusht themelor është që mediat ta kuptojnë përgjegjësinë e tyre shoqërore ndaj qytetarëve, sepse përfaqësuesit e mediave edhe më tutje vënë në plan të parë interesin material, kështu që janë të prirur të transmetojnë informacione spektakulare që do të sillnin përfitime. Në këtë mënyrë ata bëhen madje edhe akterë

të sjelljeve korruptive. Për këtë arsye, shtrohet nevoja për një transmetim shumë efikas, interno dhe ekstern, të shumë informacioneve të sakta, objektive dhe të paanshme, me qëllim të informimit të qytetarëve. Kështu, policia kontribuon në afrimin e saj me publikun dhe në krijimin e imazhit të mirë në publik.

Është detyrë e mediave është që ta informojnë publikun në mënyrë të saktë dhe të shprehin mirëkuptim për mbrojtjen e interesave në zbulimin dhe parandalimin e të gjitha formave të kriminalitetit dhe jo që të plasojnë informacione bombastike dhe të paverifikuara, të cilat në situata të caktuara rrezikojnë punën operative të policisë për hetimin e krimeve. Gjithashtu, funksion i policisë dhe mediave është veprimi i shpejtë, prandaj është e nevojshme që midis tyre të ketë kundërshti funksionale, të cilat mund të stimulojnë pjesëtarët e policisë që të heqin dorë nga politika joaktive e reaktive dhe të përvetësojnë politika aktive që do t'i kontribuojnë shërbimit të përbashkët të publikut. Së këndejmi, del se në komunikimin reciprok të policisë dhe mediave ekzistojnë mundësi të mëdha të pashfrytëzuara. Në të ardhmen këto marrëdhënie nuk mund të bazohen në raste individuale, por në kontakte të planifikuara, interaktive e kontinuitive, të cilat do të krijojnë mundësinë që publiku të bëhet pjesëmarrës aktiv në zgjidhjen e çështjeve relevante të sigurisë me qëllim të parandalimit të kriminalitetit. Nëpërmjet mediave, publiku duhet të njoftohet në mënyrë përmbytëse se detyrë kryesore e forcave të policisë është ruajtje e sigurisë së brendshme të shoqërisë dhe shtetit. Kështu, policia, në pajtim me ligjin vepron për ruajtjen dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes së sigurisë, duke i shërbyer shoqërisë dhe duke i mbrojtur të gjithë qytetarët nga veprat e paligjshme, nëpërmjet punës së përgjegjshme e profesionale. Gjithashtu opinioni duhet të njoftohet se ruajtja e disa segmenteve të sigurisë varet nga shkalla e informimit të policisë dhe mbështetja e tyre me propozimet e qytetarëve, sidomos kur bëhet fjalë për parandalimin e kriminalitetit. Së këndejmi, zgjidhja me kohë e problemeve të sigurisë, efikasiteti dhe cilësia e punës së policisë. Varet edhe nga transparenca e saj ndaj publikut.

Policia ka një interes të vetëm në aspektin e krijimit dhe përmirësimit të marrëdhënieve me individë dhe me grupe të ndryshme politike, etnike, religjioze dhe sociale. Është shumë e rëndësishme që në bazë të njohurive të përgjithshme për mjedisin në të cilin vepron, për qytetarët, doktet e zakonet, vendet e grumbullimit, etj., policia “të formësojë, planifikojë dhe ofrojë shërbime, të cilat, nëpërmjet mediave, duhet të rezultojnë me nivelin e dëshirueshëm të infraksionit dhe besimit”. Ato duhet të zhvillohen në harmoni me pritjen e qytetarëve dhe të bashkësisë në tërësi. Kjo nënkupton se policia duhet të reagojë shumë shpejt ndaj të gjitha ndryshimeve që kanë të bëjnë me sigurinë dhe, nëpërmjet informimit me kohë të publikut të mundësojë përfshirjen e qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve

për kryerjen e operacioneve policore me interes të dyanshëm, sidomos në rrethana specifike dhe komplekse të sigurisë, të cilat mund të kenë implikime të theksuara negative.

Në të njëjtën kohë, publiku duhet të dijë se policia, nëpërmjet kryerjes me përgjegjësi dhe me autoritet të detyrave me veprim të vendosur, korrekt dhe të paanshëm, me aftësitë, dijen, arsyen dhe sjelljet e saj në çdo situatë, është e aftë të ofrojë ndihmën e nevojshme, duke shprehur gatishmërinë për përkrahje dhe mirëkuptim dhe duke respektuar mendimin dhe qëndrimin e publikut.

Pra, pjesëmarrja e publikut në hartimin e strategjisë së re të veprimit të policisë sëre ndihmon në uljen e shkallës së kriminalitetit në shoqëri. Krijimi i urave të komunikimit reciprok midis policisë dhe mediave ndikon edhe në rritjen e mbështetjes politike ndaj policisë dhe programeve të saj sociale e preventive, si edhe ndaj legjislacionit penal.

Por, këto marrëdhënie megjithatë duhet të mbeten në një distancë e cila do të lë të hapur mundësinë e kritikës së arsyeshme reciproke që nuk do të cenojë efektet pozitive të komunizmit. Nëpërmjet mediave policia mund të kuptojë lehtë qëndrimet e publikut, gjë që i mundëson asaj që me kohë të eliminojë dobësitë dhe lëshimet në punën e saj të përditshme. Kjo paraqet parakusht themelor që planifikimi dhe parashikimi i lëvizjeve të mbështet gjithnjë e më shumë në të dhënat shkencore dhe objektive.

## **5.12. Organizimi i punës me media**

Nisur nga vetë natyra e punës së policisë dhe specifikën e saj, të cilën e karakterizon shumëllojshmëria operative, reagimi i shpejtë e efikas, përshtatja me rrethanat dhe situatat e sigurisë, specifikë që është garant i sigurisë së brendshme me të cilën duhet ta njoftojë publikun në mënyrë objektive, shtrohet domosdoshmëria e formimit urgjent të zyrës së policisë për marrëdhënie me publikun. Me themelimin e zyrave për marrëdhënie me publikun, policia do të orientojë punën e saj në dy drejtime, ndaj vetes dhe ndaj publikut. Puna me publikun, nëpërmjet mediave, nënkupton edhe krijimin e një programi konsistent, sepse kjo është pikë fillestare për krijimin e pasqyrës së policisë në publik. Në këtë kuptim, puna me publikun duhet të zë vend të rëndësishëm më programet e arsimimit, sepse në ndërtimin e imazhit të policisë nuk ndikojnë vetëm udhëheqësit e policisë, por edhe secili punëtor operativ i saj. Më në fund, policia e ka kuptuar se mediat janë pjesë e “aparatis policor” të shoqërisë dhe se ato mund të përdoren në

funksion të informimit të publikut me objektivat e realizuara të policisë, se ato janë mjet kryesor për krijimin e “pasqyrës për policinë, për zhvillimin e pranimi ose refuzimit të saj” (R. Reiner: The Politics of the Police). Shumë shërbime informative e kanë kuptuar shumë moti se çfarë ndikimi kanë mediat për pasqyrimin publik mbi kriminalitetin dhe policinë, prandaj kanë rekomanduar që të krijohen sektorë për marrëdhënie me publikun, të cilët do të kujdeseshin për ndërtimin e marrëdhënieve të mira me mediat. Qysh në vitin 1915 në Scotland Yard ishte hapur “dhoma e shtypit”, e cila publikonte informacione dy herë në ditë.

Duke parë rëndësinë e marrëdhënieve me publikun, zyrat për marrëdhënie me publikun kanë marrë gradualisht tiparet e agjencive policore të lajmeve, të cilat janë karakterizuar për marrëdhënie simbioze me mediat. Kështu të dyja këto institucione kanë realizuar objektivat e tyre. Mund të thuhet se “efikasiteti i forcave policore varet në masë të madhe nga vullneti i mirë dhe mbështetja e publikut, i cili njoftohet për problemet, sukseset dhe interesat e policisë nëpërmjet mediave”. “Zyrat për marrëdhënie me publikun kanë për detyrë që të zhvillojnë dhe të ruajnë marrëdhënie të mira pune me mjetet e informimit publik dhe që mbi punën e policisë të raportohet në mënyrë të plotë dhe të ndershme” (J. Vwoodcook: Annual General Report: South Wales Constabulary).

Për të njoftuar me sukses opinionin me aktivitetet e saj dhe për ta bërë atë shërbim profesional të pranuar e të respektuar nga qytetarët, policia duhet të zhvillojë maksimalisht edhe komunikimin e brendshëm të punëtorëve të saj. Vlera më e madhe e çdo organizate policore janë bashkëpunëtorët. Pa bashkëpunëtorë të mirë hartimi i strategjisë dhe përcaktimi i objektivave të policisë mbetet vetëm në nivel të planifikimit. Në qoftë se kësaj i shtohen edhe tendencat konfliktuale, të cilat janë edhe më tutje të pranishme, domosdoshmërisht shfaqet nevoja për hartimin e përbashkët të konceptit të marrëdhënieve midis policisë e mediave. Marrëdhëniet e tyre të ardhshme duhet të mbështeten në lidhjet interaktive, në dhënien e informacioneve objektive e të verifikuara dhe në përgjegjësinë e të dy palëve, e cila është parakusht për zbatimin e parimeve demokratike civilizuese në punën e policisë dhe të mediave. Informacione që publikohen në media, përveç komponentës informative e të sigurisë, duhet të hapin rrugë për krijimin e lidhjeve simbiotike reciproke dhe për njohjen e publikut me operacionalizimin e programeve sociale-preventive të policisë, me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit dhe përmirësimit të punës së segmenteve të policisë. Për t’i liruar nga koncepti i deritashëm, i cili në praktikë është dëshmuar tërësisht joefikas dhe jo i besueshëm përballë kompleksitetit të të gjitha formave të kriminalitetit, para sistemit policor shprehet si kërkesë imperative shqyrtimi dhe analiza e të arriturave të deritashme në këtë fushë. Në bazë të analizave përmbajtësore, duhet të bëhet verifikimi kritik i

strategjisë së komunikimit dhe zbatimit të saj. Kjo do të thotë se policia duhet të analizojë shkallën e zhvillimit të marrëdhënieve pragmatike me mediat si dhe formën e kontrollit të deritashëm të veprimit në realizimin e detyrave që kanë të bëjnë me këtë sferë. Duhet të pranohet se ndërtimi i shpejtë i marrëdhënieve pozitive midis policisë e mediave është shumë vështirë të bëhet, pas një sërë situatash konfliktuoze midis tyre. Prandaj, ky proces do të shoqërohet me vështirësi të shumta.

### **5.13. Orientimet themelore për punë me përfaqësues të mediave**

Me qëllim të tejkalimit të vështirësive të përmendura, në sektorin e marrëdhënieve me publikun duhet të organizohet një formë funksionale të edukimit për kontakte proaktive midis policisë e mediave. Për punë të suksesshme janë më se të domosdoshme aktivitete të përshtatshme interne dhe eksterne, sepse çdo informacion nuk varet vetëm nga përmbajtja e tij dhe hapësira që i jepet, por edhe nga informimi me kohë e publikut me përmbajtjen e tij si edhe me obligimet që duhet t'i marrin qytetarët, të cilat kanë rëndësi kyçe për grumbullimin e informacioneve shtesë mbi kriminalitetin dhe aktivitetet kriminale. Qytetarët në bashkësinë lokale duhet të ndjejnë këtë obligim si kontribut për sigurinë dhe jo si barrë. Kështu, në kuptimin funksional, edhe zbatimi i ligjit nga policia shndërrohet gradualisht e gjithnjë e më shumë në veprimtari humane dhe si kontribut për ruajtje e vlerave demokratike të shoqërisë.

Shumë organizata policore i kanë zhvilluar orientimet në punë me përfaqësues të mediave, të cilat bazohen në korniza të interesit të dyanshëm për informim publik.

Në këtë kontekst do të përmendim vetëm disa karakteristika të përbashkëta themelore. Objektivi themelor i informimit është realizimi i të drejtës kushtetuese të qytetarëve që të jenë të informuar mbi problemet qenësore të karakterit të sigurisë. Me këtë rast duhet t'i kushtohet kujdes mbrojtjes së personalitetit të qytetarit dhe mbrojtjes së interesit operativ të policisë, krijimit të kushteve për punë të sigurt të policisë në grumbullimin e të dhënave dhe në ndriçimin e krimeve. Për këtë arsye, duhet t'i kushtohet kujdes edhe respektimit të obligimeve ndaj mediave, por edhe pengimin e pasqyrimin jo objektiv të krimeve të caktuara, sepse kjo mund të shkaktojë shqetësim dhe pasiguri midis qytetarëve. Policia nuk bën të japë informacione që mund të komprometojnë hetimet, sepse në këtë mënyrë ajo e ruan kredibilitetin dhe autoritetin në publik.

Koncepti i ri i marrëdhënieve me media duhet të ketë primesa të filozofisë së veprimit zyrtar të policisë, objektiv i të cilit është “shërbimi policor progresiv”, gjegjësisht fitimi i besimit të qytetarëve për bashkëpunim, gjë që është çështje fundamentale për punën e policisë në të ardhmen. Në bazë të njohurive dhe përvojave të deritashme që kanë shkaktuar marrëdhënie konfliktuale, policia duhet të institucionalizojë ide të reja, të cilat do të reflektojnë atmosferë të mirë për prezantimin e suksesshëm të punës së policisë në publik. Këto marrëdhënie kërkojnë që zyrtarët përgjegjës të respektojnë rregullat e sjelljes reciproke dhe interesim përkatës të dyanshëm për kontakte të vazhdueshme dhe për komunikimi në procesin e krijimit të marrëdhënieve optimale. Për këtë qëllim, përveç konceptit të komunikimit për punën e policisë është e domosdoshme që në vazhdimësi të grumbullohen dhe të analizohen në mënyrë korrekte përshtypjet për policinë, të cilat sigurohen nga mediat, në mënyrë që të mund të reagohet me kohë të dobësive subjektive në punën operative të policisë.

Policia, gjatë punës së saj, duhet të tregojë gatishmëri të lartë të përkrahjes ndaj përfaqësuesve zyrtarë të mediave. Në këtë gjitha kontaktet e drejtpërdrejta duhet të jetë e gatshme të japë përgjigje të sinqerta dhe të drejta. Policia nuk guxon të shërbehet me gjysmë të vërteta ose me të dhëna ta pasakta, sepse kjo do të vinte në pikëpyetje autoritetin e saj. Pra, përgjegjësit e policisë duhet të jenë të saktë, në mënyrë që, me deklaratat e tyre, të mos i shpien në drejtim të gabuar përfaqësuesit e mediave. Për këtë arsye, janë të qëndrueshme deklaratat e përfaqësuesve të mediave se do t’ia falnin policisë në qoftë se tash për tash nuk do të jetë në gjendje të japë përgjigje në pyetjet e parashkruara. Ky qëndrim duhet të shërbejë si këshillë e rëndësishme për mënyrën e sjelljes së policisë ndaj mediave.

Strukturat policore duhe të kenë kujdes për faktin se publiku nuk është i interesuar vetëm për ngjarjet që ndodhin në sferën e sigurisë, por është i interesuar të dije se si punon policia për ndriçimin e problemeve kriminale për të cilat janë shumë të interesuar qytetarët. Po ashtu, policia duhet t’i kushtojë kujdes edhe vendit dhe rolit të qytetarëve, me qëllim të ofrimit të ndihmës përkatëse. Në këto raste policia ka shansë të marrë iniciativën maksimale, me që përfaqësuesit e mediave ndonjëherë, për shkak të njohjes së pamjaftueshme të problemeve ose kufizimeve kohore (pasi kanë të bëjnë me afate) dhe nevojën që në mënyrë sa më të thjeshtë t’i prezantojnë problemet, mund të dëmtojnë autoritetin e policisë në shoqëri.

Policia duhet të ketë qasje në media dhe në procesin e këmbimit të lirë të informacioneve, duhet të veprojë në po atë mënyrë që do të dëshironte të vepronin të tjetër me të. Kjo do të thotë se policia duhet të sigurojë bazën themelore të informacioneve, duke evituar zhargonin e ngurtë dhe terminologjinë policore. Pra,

policia duhet të sigurojë, të sistemojë, të analizojë dhe të ofrojë të dhëna shumë të qarta dhe të thjeshta. Policia nuk bën të preferojë përfaqësuesit e ndonjëres prej mediave, duke u dhënë informacione ekskluzive, ndërsa të tjerëve jo. Kjo sigurisht do të shkaktonte probleme të mëdha me mediat të cilave nuk u është dhënë informacioni.

Në qoftë se përfaqësuesit e policisë janë të informuar më parë dhe përgatiten për takim me mediat, atëherë është e domosdoshme që të verifikojnë përmbajtjen e fakteve, njohurive mbi informacionet që mund të publikohen, dhe sipas mundësisë të parashikojnë edhe pyetjet që mund t'i shtrojnë përfaqësuesit e mediave. Në bazë të kësaj ata duhet të planifikojnë strategjinë e përgjigjeve. Për prezantimin e policisë në publik është shumë e rëndësishme dhe pamja fizike, mënyra e të folurit, sjellja gjatë dhënies së përgjigjeve, etj. kjo do të thotë se ata duhet të kenë stil normal, të qetë e të rehatshëm të bisedimit, me ç'rast gjithmonë duhet të kenë kujdes që para tyre të vendosen kamerat dhe mikrofonat. Është sidomos e rëndësishme që të dëgjohen me kujdes pyetjet e reporterëve dhe të jepen përgjigje të shkurtra, të çarta dhe precize. Secila fjalë e shqiptuar ose e ofruar në formë të shkruar paraqet një pjesë të opinionit publik.

Informimi i publikut, në disa rrethana, ka edhe karakter të drejtpërdrejt operativ, sidomos kur bëhet fjalë për verifikimin e identitetit të personave, i cili mund të bëhen nëpërmjet publikimit të fotografive në media. Të shumtën e herës kjo jep rezultate pozitive në zbulimin e kryerësve të veprave të rënda penale, me ç'rast manifestohen multidisiplinariteti apo përfshirja e qytetarëve në sistemin e sigurisë dhe në luftën kundër kriminalitetit. Bashkëpunimi i policisë dhe mediave, nëpërmjet zyrave për marrëdhënie me publikun, siguron informacione precize, kështu që krijohet një lidhje e përhershme pune që shkakton edhe disa kufizime dhe veprime joprofesionale. Policët të cilët nuk janë të përgatitur për lidhje me publikun duhet të nxirren në mënyrë profesionale nga situatat e diskutueshme. Policia duhet të jetë gjithmonë e hapur për media, të sigurojë lajmet për to dhe me lehtësi të mbajë konferenca shtypi, kur kjo është e mundur dhe kur e kërkojnë rrethanat. Në marrëdhëniet e tilla duhet të dominojë parimi për lidhje të përhershme optimale vepruese proaktive, i cili është një prej komponentave themelore për suksesin ose dështimin e sistemit policor gjatë shërbimit të saj për publikun.

Si përfundim, mund të theksohet se të gjitha format e informimit publik nëpërmjet mediave janë shumë të ndjeshme, pasi kanë karakter publik. Për këtë arsye, në rrethana të reja, nuk mund të jetë vetëm çështje e policisë, por ajo duhet të zbatohet nëpërmjet mediave dhe me pëlqimin dhe përkrahjen e bashkësisë shoqërore në pajtim me nevojat e saj. Kështu, dukë ndërtuar marrëdhënie të mira me bashkësinë



lokale, policia fiton ën tërësi besimin dhe përkrahjen e qytetarëve, si edhe gatishmërinë e tyre për bashkëpunim. Policia duhet të zhvillojë aftësitë komunikuese me qytetarët, sepse puna e saj në parandalimin e krimeve, aksidenteve dhe ruajtjes së rendit publik e qetësisë varet shumë nga përfshirja e bashkësisë lokale. Kështu, në mënyrë të tërthortë realizohet mbikëqyrja e tërthortë demokratike e veprimtarisë së policisë.

## **6. TRENDET E REJA TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE SFIDAT BASHKËKOHORE PËR SIGURINË**

### **6.1. Veprimtaria kriminalistiko-informative në funksion të luftës efikase kundër krimit të organizuar**

Organizimi dhe roli i ri i policisë, sidomos i policisë kriminalistike, si edhe vet procesi i përshtatjes me parimin dhe vlerat e shoqërisë demokratike, e ka vënë në pikëpyetje qasjen e mëparshme mbi procesin e hartimit dhe zbatimit të planeve për hulumtime kriminalistike dhe informative. Pra, kërkesat e shoqërisë në rrethanat e reja politike dhe kushtet tjera të reja shtrojnë domosdoshmërinë që këto shërbime të bazohen në postullate krejtësisht të tjera, gjë që kërkon ridefinimin e plotë të filozofisë dhe praktikës së policisë. Roli dhe pozita e re e sistemit policor në shoqëri, pra edhe e veprimtarisë kriminalistike informative kushtëzon një qasje sistemore shkencore e profesionale për hartimin e konceptit të ri, i cili ka të bëjë me sferën e planifikimit. Për sistemin policor vlen po ajo që vlen për institucionet tjera kriminalistike informative, në mënyrë që puna kriminalistike e policisë t'i përshtatet qenies së re shoqërore. Kjo do të thotë se ajo duhet të organizohet dhe zhvillohet gjithnjë e më shumë si sistem me bazë shkencore i orientuar drejt depolitizimit dhe punës profesionale, më qëllim të mbrojtjes preventive të bashkësisë shoqërore. Në këtë kuptim, planifikimi ka rëndësi të veçantë me që ai kërkon parakushte shumë të theksuara respektive, intelektuale e profesionale gjatë planifikimit. Pra, edhe planifikimi i hulumtimeve kriminalistike informative duhet të bazohet në rezultatet shkencore hulumtuese, të cilat paraqesin parakushtin themelor të hartimit të strategjisë së re të veprimit konkret kriminalistiko-informativ.

Lëshimet eventuale në këtë aspekt, sidomos lëshimet në orientimin konkret të grumbullimit të të dhënave, dhe mosnjohja e fushën së hulumtimeve informative mund të shkaktojnë pasoja politike të sigurisë etj. dhe të vënë në pikëpyetje orientimin profesional, sidomos lidhur me opinionin publik dhe marrëdhëniet e brendshme. E gjithë kjo tregon se planifikimi është një aktivitet i organizimit të shumë të përgjegjshëm dhe kompleks në cilëndo fushë të zhvillimit shoqëror, qysh

prej kohëve më të hershme e deri më sot, ai paraqet një prej proceseve dinamike kontinuitive më të rëndësishme. Për këtë arsye sot është vështirë të paramendohet çfarëdo organizate që mund të ekzistojë dhe të realizojë me sukses objektivat e veta pa plane të menduara mirë dhe të zbatueshme. Planifikimi, në esencë, është proces dinamik, sistemor dhe kontinuitiv i parashikimeve, gjegjësisht i detyrave të planifikuara që më parë, të cilat është e domosdoshme të realizohen nëpërmjet zgjedhjes së veprimeve adekuate të hulumtimeve dhe metodave adekuate të punës. Në këtë kontekst rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet përcaktimit të modelit dhe kriterëve të kontrollit, sikur edhe vet vlerësimit të rezultateve të arritura. Duke pasur parasysh fushën e veprimit, komponenta e kontrollit parqet një instrument dhe një kusht të rëndësishëm të kryerjes së detyrave zyrtare. Funkcioni i kontrollit është që të krahasojë, shqyrtojë, kritikojë, stimulojë planifikimin, të thjeshtësojë, të forcojë organizimin, të shtojë suksesin e udhëheqjes, të kontribuojë për lidhjen më të lehtë të proceseve vepruese, etj.

Në anën tjetër, politika e verifikimit apo e vlerësimit të rezultateve të punës kriminalistike informative shtron edhe nevojën e përpunimit permanent shkencor e profesional të orientimeve themelore, me qëllim të gjetjes së metodave më të mira për vlerësimin objektiv dhe kompetent të rezultateve të arritura. Pra, sistemi i vlerësimit dhe verifikimi i objektivave, rezultatet e punës dhe vlerësimi i shërbimit kriminalistiko-informativ në tërësi është një prej faktorëve më të rëndësishëm për përcaktimin e nevojave të përgjithshme, të cilat do të kontribuojnë që aftësitë profesionale dhe njohuritë e pjesëtarëve të policisë kriminalistike të hapin shtigje për verifikim shkencor gjatë formësimit të objektivave strategjike globale të hulumtimeve kriminalistike informative. Së këndejmi, çdo planifikim është vetëm mjet për arritjen e objektivave të caktuara shoqërore dhe kurrë nuk mund të jetë objektiv për veten e tij ( E. P. Shkenca mbi drejtimin, f. 276), që ka të bëjë edhe me shërbimin policor. Këto qëndrime tregojnë qartë gjithë seriozitetin e miratimit të planeve, sidomos në ato fusha që kanë rëndësi të veçantë për ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetin e shoqërisë.

## **6.2. Krijimi i kornizës së planit konceptual në fushën kriminalistiko-informative**

Mendimi shkencor e profesional të krijimit të planit kriminalistiko-informativ vë në pah disa premisa të domosdoshme për orientimin dhe kuptimin e vet rrjedhës së hartimit, verifikimit të planeve për hulumtime kriminalistiko-informative. Interpretimet e ndryshme terminologjike dhe definicionet e shumta me qasje të ndryshme tregojnë gjithë seriozitetin dhe njohjen e pamjaftueshme shkencore e

profesionale të fushës informative, si edhe kompleksitetin, specifikat dhe përgjegjësinë e theksuar të detyrave të përmendura.

Në hulumtimin kriminalistiko-informativ, hartimi dhe verifikimi i planit konceptual ose planit strategjik, siç quhet zakonisht në praktikë, përbën një prej fazave më të rëndësishme dhe më me përgjegjësi të sferës së informimit. Siç kemi theksuar më parë, natyra e transformimit të shoqërisë demokratike dhe sfidat dhe kërcënimet gjithnjë e më të pranishme shtrojnë nevojën e rikonceptimit të filozofisë dhe praktikës informative. Analizat kanë treguar se modeli tradicional i organizimit të mekanizmave të sigurisë dhe vetë qasja nuk mund t'u përgjigjen kërkesave të kohëve të sotme lidhur me probleme të caktuara të karakterit të sigurisë. Pra, nga shërbimi policor kërkohet që në vazhdimësinë e veprimit të tij të gjejë metodat më të mira dhe më të zbatueshme, me qëllim të vështirimit objektiv të të gjitha vatrave të rreziqeve.

Mungesa e pasjes së planifikuar dhe ushtrimi i veprimtarive kriminalistiko-informative në mënyrë rutinore e pa përcaktimin e prioriteteve të hulumtimeve domosdoshmërisht do të shpie në tendenca për improvizime në punën e përditshme. Në këtë kontekst, rëndësi të jashtëzakonshme ka procedura metodologjike e procesit të miratimit të planeve strategjike.

Ato duhet të formësohen dhe të miratohen sipas metodologjisë përkatëse të informimit, me të gjitha elementet e domosdoshme përmbajtësore dhe me zbatimin e vazhdueshëm e të përhershëm të metodave objektive shkencore, zbatimin profesional e autonom të planeve taktike operative në të gjitha fazat e hulumtimeve informative, me qëllim të arritjes së objektivave të planifikuara në këtë fushë. Pra, planifikimi është proces dinamik që kërkon pjekuri të nevojshme dhe aftësi intelektuale e profesionale të kuadrit që merr pjesë në krijimin e përmbajtjeve të përmendura.

Nga sa u tha mund të përfundohet se plani strategjik është dokument konceptual shkencor e profesional që ka rëndësi fundamentale për shërbimin kriminalistiko-informativ apo për sektorët që përfshijnë përcaktimin e sistemit të mënyrave, metodave, mjeteve dhe resurseve të operacionalizimit më efikas dhe më profesional apo arritjes së objektivave të përcaktuara me politikën informative, si prioritet që përcaktohet nga shfrytëzuesit dhe bartësit e orientimit në pajtim me ligjin.

Prandaj, plani strategjik nënkupton bazat e veprimit me të gjitha premisat relevante për implementimin e tij. Edhe plani duhet të përmbush të gjitha funksionet teorike e praktike. Pa këto përkufizime asnjë shërbim nuk mund të shprehë përshtatjen

informativo-operative dhe strukturale sipas kërkesave të qenies bashkëkohore të sigurisë. Definimi i objektivave bazë të planit strategjik të grumbullimit të të dhënave informative është pjesa më me përgjegjësi, më delikate dhe më e ndjeshme e formësimit dhe veprimit të mekanizmave të përmendur mbrojtës të shtetit. Krijimi dhe operacionalizimi praktik i tyre duhet të jetë shprehje e njohurive shkencore e profesionale dhe praktikës, duke pasur parasysh karakterin multidisiplinar dhe karakterin kriminalistiko-informativ të hulumtimeve. Në këtë kuptim, duhet të njihen faktorët determinues, të cilët janë faktor crucial për realizimin e detyrave të përmendura. Por, nuk eksiton një plan unik për të gjitha fushat dhe prioritetet e hulumtimeve informative, sikurse nuk ekziston as kritere të njësuara metodologjike për arritjen e objektivave të dëshiruara. Në këtë kuptim, rëndësi të veçantë ka kuptimi i drejtë shkencor e profesional i vetë përmbajtjes së planit të përmendur.

Për këtë arsye, është e mundur të hartohen vetëm plane operative e taktike reale dhe të zbatueshme, zbatimi i të cilave ka rëndësi të konsiderueshme për parandalimin e kërcënimeve për sigurinë e shoqërisë.

Para hartimit të konceptit të tillë të planit strategjik vjetor, duhet të ndalemi në disa momente që është e nevojshme të shqyrtohen. Bëhet fjalë për disa rekomandime të rëndësishme, të cilat është e domosdoshme të vështrohen nga strukturat më të larta drejtuese të shërbimeve kriminalistiko-informative.

Është e domosdoshme analiza e saktë përmbajtjesore e rezultateve të përgjithshme të planifikuara dhe të realizuara më parë, duke u çliruar plotësisht nga konotacionet dhe animoziteteve politike. Kjo nënkupton analizën e shkallës së realizimit të aktiviteteve të përcaktuara nga nivelet më të larta të hierarkisë së policisë kriminalistike dhe analizën e lëshimeve eventuale që kanë pasur ndikim më efikasitetit e punës kriminalistiko-informative të shërbimit kriminalistik;

Me që bëhet fjalë për dokumentin themelor të shërbimit kriminalistik, plani orientues duhet të konceptohet ashtu që, si pjesë komplementare e objektivave, bartësve, metodave, orientimeve, mjeteve, etj., t'i mundësojë sektorit kriminalistiko-informativ të perfeksionojë punën në zbatimin e veprimeve koherente, sistemore e metodologjike, zhvillimin e potencialeve të përgjithshme informative, grumbullimin e të dhënave dhe analizave informative, si edhe përpunimin e vlerësimeve dhe parashikimeve të të dhënave kriminalistiko-informative mbi forma të ndryshme të krimit të organizuar. Për këtë arsye është e domosdoshme analiza paraprake e metodologjisë së hulumtimeve informative, me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të metodave të reja, të cilat duhet të japin përgjigjet përkatëse për kërcënimet dhe sfidat eventuale, kështu që policinë kriminalistike ta bëjnë të jetë me efikase dhe më proaktive. Orientimi drejt veprimit proaktiv preventiv ka rëndësi kruciale, me që zbatimi i këtyre masave dhe informim me kohë

(informatat, analizat, verifikimet dhe vërejtjet mbi të gjitha format e krimit të organizuar) ofrojnë mundësi për reagim me kohë dhe për aktivizimin e të gjithë mekanizmave mbrojtës në parandalimin e kërcënimeve për sigurinë e shtetit;

Planet strategjike duhet të mundësojnë zhvillimin optimal organizativo-informativ sipas postullateve të larta shkencore e profesionale, praktike e operative dhe njohurive tjera relevante, të cilat janë faktorë të rëndësishëm të veprimit të suksesshëm në të gjitha fazat e hulumtimeve kriminalistiko-informative, gjë që paraqet faktorin vendimtar të kryerjes me sukses të detyrave të planifikuara. Në këtë mënyrë, eliminohen dobësitë eventuale në punën konkrete hulumtuese informative; Plani strategjik përfshin edhe mënyrën e zbatimit të rregullave të përgjithshme operative të procesit kriminalistiko-informativ, i cili, siç kemi theksuar, bazohet në parimet ekzakte shkencore, me aspektet specifike të veprimit të brendshëm informativ. Me këtë rast rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të aktiviteteve të përmendura në kuadrin e veprimeve të lejuara me ligj;

Për arritjen e të objektivave të përcaktuara, të gjitha aktivitetet dhe operacionet e fazës së hulumtimit informativ duhet të zhvillohen në mënyrë sistemore e profesionale. Ky është një prej parakushteve të rëndësishme, në të cilat duhet të fokusohet interesimi i kuadrit më të lartë drejtues, i cili duhet të shqyrtojë paraprakisht të gjitha elementet qenësore, ku përfshihen vlerësimet e sigurisë, vlerësimet e rrezikshmërisë dhe parashikimet e sigurisë;

Plani strategjik vë në pah edhe nevojën e përshtatjes dhe perfeksionimit organizativ, funksional e teknologjik, strategjisë së veprimit informativo-operativ me theks të veçantë në mbrojtjen e potencialit informativ dhe kanaleve të komunikimit, duke respektuar mendimet dhe njohuritë paraprake dhe prioritetet, me qëllim që në mënyrë adekuate të kryhen detyrat e planifikuara. Në këtë kuptim, duhet të përcaktohen standardet organizativo-drejtuese, operative-praktike dhe të komunikimit reciprok, me theks të veçantë në format dhe modalitetet e mbrojtjes së burimeve dhe metodave informative nga personat e paautorizuar.

Është e domosdoshme që hulumtimet të fokusohen në ato fusha që, nga pozicioni i përcjelljes së situatës së sigurisë dhe rrethanave për sigurinë, përbëjnë substratin e mbrojtjes së interesave vitale nacionale të shoqërisë, gjegjësisht parandalimin efikas të të gjitha formave të krimit të organizuar.

Nga sa u tha deri më tash, mund të theksohet se plani strategjik është postullat fundamental për hartimin e planit të veprimit kriminalistiko-informativ dhe të orientimit të shërbimit kriminalistik. Kahet e veprimit strategjiko-informativ të shërbimit kriminalistik përcaktohen në bazë të përvojave dhe rezultateve të deritashme. Pra, me planin strategjik përcaktohen objektivat strategjike, të cilat bazohen në modalitetet e manifestimit të krimit të organizuar me të gjitha sfidat dhe kërcënimet që mund të kenë ndikim në situatën e sigurisë së shtetit. Në këtë

kontekst përcaktohen bazat e planit me kërkesa të reja, gjë që kushtëzon edhe ridefinimin e nevojshëm të detyrave të përcaktuara më parë. Prandaj, format e ndryshme të pasigurisë ndikojnë dhe përcaktojnë karakterin dhe modalitetet e veprimtarisë kriminalistiko-informative.

Dokumenti strategjik konceptual zakonisht miratohet për vitin në vijim. Hartimi i këtij dokumenti, sikur edhe i çdo dokumenti të rëndësishëm të kësaj natyre, bëhet në dy nivele: në nivel të përgjithshëm dhe në nivel të pjesshëm. Për realizimin me sukses të detyrave që dalin nga plani strategjik, në procesin e hartimit të tij përfshihen të gjitha resurset funksionale, kadrovike, organizative etj. të shërbimit kriminalistik.

Pjesa hyrëse (e përgjithshme) e planit duhet të përmbajë të gjitha orientimet relevante të zbatimit të veprimtarisë së tërësishme kriminalistiko-informative. Në këtë pjesë përcaktohen objektivat kriminalistiko-informative, bashkë me prioritet, hapësirat, kronizat, format dhe metodat e veprimit. Në këtë kuptim, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet mënyrës së orientimit dhe përcjelljes së punës së shërbimit, të fokusuar në fusha të ndryshme të veprimit, sidomos në organizatat kriminale transnacionale dhe subnacionale dhe në kërcënime të tjera për sigurinë. Së këndejmi mund të nxirret përfundimi relevant se krijimi dhe operacionalizimi i politikës kriminalistiko-informative, veçanërisht zbatimi i saj në praktikë, pa asnjë dyshim kërkon organizim dinamik, edukim dhe pajisje teknologjike, me qëllim të realizimit të detyrave globale strategjike. Kështu arrijmë deri te pjesa e dytë e planit, konkretizimi i tij. Në këtë fazë është e domosdoshme që veprimi i përgjithshëm të bazohet në hulumtimet shkencore e profesionale dhe në përvojat e mëparshme. Po ashtu, është i domosdoshëm një mobilizim i plotë i pjesëtarëve të shërbimit, sidomos i kuadrit drejtues, me qëllim të zbatimit me kohë dhe efikas të të gjitha detyrave të përcaktuara ose të ridefinimit të ndryshimeve organizative. Prandaj, ata duhet të përcjellin me kujdes rrjedhën e aktiviteteve të planifikuara dhe të gjitha ndryshimet eventuale, në mënyrë që të krijohet klimë për ndryshime të pranueshme organizative e funksionale.

Në planin strategjik nuk është e nevojshme të përfshihen fushat e shërbimit, të cilat nuk janë përcaktuar me ligj në mënyrë decitive, për shkak se ky është obligim ligjor i tyre, kur bëhet fjalë për fushën e veprimit informativ.

### **6.3. Hartimi i planeve operative**

Vështruar nga aspekti etimologjik, shprehja “operativë” rrjedh nga fjala latine *operari* që do të thotë *punoj, veproj*. Në këtë kuptim përmenden fjalët *operacion*,

*operativ, operativitet, etj*, të cilat përdoren në punën e përditshme të agjencive që merren me zbatimin e ligjit. Meqenëse lëndë e trajtimit tonë është “plani operativ” ose planifikimi i punës së policisë në fushën informative të kriminalitetit, këtë shprehje do të definojmë si plan me të cilin përcaktohen në mënyrë të qartë e konkrete veprimtaritë për një periudhë të shkurtër kohore, sipas detyrës zyrtare, të miratuara në bazë të objektivave të përcaktuara më parë me definimin e planit strategjik të punës. Pra, planet operative hartohen në pajtim me hulumtimet e mëparshme informative dhe rezultatet e tyre, të cilat pasqyrojnë spektrin e kërcënimeve dhe rreziqeve të formave dhe intensiteteve të ndryshme, me filozofi drejtuese dhe me të gjitha resurset që duhet të jenë në funksion të raportimit të strukturave kompetente dhe ofrimit të mbështetjes përkatëse edhe për agjencitë tjera qeveritare që merren me zbatimin e ligjit.

Pra, në bazë të analizave paraprake përmbajtjesore, ekzakte dhe precize, vlerësimeve të rrezikshmërisë së sigurisë, parashikimeve e përcaktimit të objektivave, planet operative duhet të hartohen sipas parimeve profesionale-operative që bëjnë të mundshëm realizimin e fazës së hulumtimeve, me qëllim të arritjes së objektivave të planifikuar. Pa planifikim sistematik e kontinuitiv të zbatimit të tyre në hapësirë, është e pamundur të bëhet grumbullimi i të dhënave objektive, precize dhe të tërësishme.

Plani operativ i punës duhet të bazohet në metodologjinë e përpunuar saktë të masave dhe veprimeve në ciklin informativ. Bëhet fjalë për kauzalitetin midis strategjisë dhe vetë zbatimit të planeve operative-taktike, sipas metodave, mjeteve dhe teknikave dhe të gjitha aspekteve të nevojshme të mbrojtjes. Kjo paraqet fondamentin e ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve konkrete në këtë fushë. Improvizimi, spontaniteti ose planifikimi ad hoc, i cili nuk është shprehje e vlerësimeve dhe parashikimeve të përmendura shpie detyrë në punë në formë fushate, e cila shprehet në uljen e efikasitetit dhe në rezultatet e punës së shërbimit kriminalistik. Është sidomos i rëndësishëm përcaktimi kohor të grumbullimit të të dhënave për disa fusha të hulumtimit, si edhe analiza e vazhdueshme dhe kreative e ciklit informativ, si edhe përcaktimi i prioriteteve. Në këtë mënyrë, shërbimet e kriminalitetit, me veprimin e tyre informativo-operativ, sigurojnë njohuri përmbajtjesore për fenomenologjinë dhe të gjitha aspektet tjera relevante të kërcënimeve dhe rreziqeve. Kështu ato krijojnë mundësi për gjetjen e mënyrave, metodave dhe mjeteve më të përshtatshme për kryerjen e operacioneve, me qëllim të përballimit efikas të të gjitha formave specifike të sfidave shumëdimensionale për sigurinë. Por, me që bëhet fjalë për veprim specifik, kjo shtron nevojën për gjetjen e indikatorëve shumë më kompleksë dhe më specifikë, në bazë të të cilëve bëhet edhe planifikimi dhe hulumtimi operativ. Me këtë rast duhet të theksojmë përsëri se

premisë fundamentale dhe komponentë qendrore e planifikimit të të gjitha aktiviteteve operative, informative, taktiko-teknike e të tjera të shërbimeve të policisë është fenomenologjia analitike, precize dhe e qartë e kriminalistiko-informative e sfidave për sigurinë, me të gjitha elementet dhe indikatorët relevantë. Vetëm mbi këtë bazë mund të vështrohen e të analizohen në mënyrë precize dhe të vlerësohen aktivitetet e deritashme dhe organizimi i përgjithshëm i potencialit efektiv të shërbimit për përballimin e këtyre sfidave. Njëkohësisht, kjo është mënyrë dhe udhërrëfim që nëpërmjet hulumtimit konkret në fushën informative (me grumbullimin e të dhënave) të arrihet deri te rezultatet përkatëse, të cilat kanë vlera heuristike për planin strategjik konceptual dhe postullatet teleologjike.

Planet e aktiviteteve që zhvillohen sipas detyrës së shërbimit janë divergjente si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga metodologjia e veprimit konkret, në të gjitha fazat e hulumtimit informativ.

Në këtë kuptim, njësitë organizative të nivelit të ulët miratojnë plane, të cilat përbëjnë segmente të planit global operativ në nivel të shërbimit. Planet që miratohen në këtë nivel duhet të jenë përmbajtjesore e të analizuara në mënyrë precize dhe të miratohen nga kuadri më i lartë drejtues i shërbimit, i cili është i obliguar që të përcjellë operacionalizimin e tyre me aktivitete operative profesionale, të cilat duhet të rezultojnë me arritjen e objektivave të përcaktuara. Këtu është shumë e rëndësishme lidhja hipotetike-kauzale që do të thotë se vetë rrjedha e hulumtimeve informative vendoset në korrelacion me hipotezat dhe prognozat e bëra që më parë, të cilat ndikojnë në situatën e sigurisë në shoqëri. Për këtë arsye kemi theksuar rëndësinë e zgjedhjes së metodave dhe mjeteve optimale dhe adekuate, duke pasur parasysh të gjitha aspektet shkencore e profesionale, të cilat janë vendimtare për marrjen e vendimeve të qëndrueshme gjatë hartimit dhe orientimit të proceseve informative, me ç'rast kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet pengesave eventuale në realizimin operativ e taktik të aktiviteteve të planifikuara. Suksesi në këtë fushë varet shumë nga sistemi koherent i veprimit informativ e metodologjik, për shkak se “metoda duhet t'i përgjigjet lëndës në të cilën zbatohet” (Hegeli).

Nëpërmjet vetë operacionalizimit të detyrave strategjike gjegjësisht aktiviteteve në planin operativ, taktik, metodologjik, teknologjik, etj., në marrëdhënie interaktive me mekanizmat tjerë të sigurisë dhe mbrojtjes, më së miri mund të caktohen dhe të realizohen objektivat e sistemit policor. Kështu mund të vlerësohet se a ofron plani operativ premisat optimale dhe mundësinë e formësimit të politikës së sigurisë globale në shoqëri.



Planifikimi dhe grumbullimi i të dhënave është fazën më delikate, më komplekse, më me përgjegjësi, më dinamike dhe kontinuitive në ciklin informativ. Në këtë kuptim rëndësi themelore ka udhëheqja, koordinimi, orientimi dhe kontrolli i grumbullimit të të dhënave. Për këtë arsye duhet të krijohen të gjitha premiset menaxheriale, operative, komunikuese, informative, materiale e teknike me qëllim të grumbullimit efikas të të dhënave. Kjo fazë e ciklit informativ mund të cilësohet si nerv të hulumtimit informativ. Heqja dorë nga qasja konvencionale-klasike në veprimtarinë informative dhe zbatimi i teorisë shkencore-hulumtuese e praktikës së re, gjë që kushtëzohet nga sfidat dhe kërcënimet bashkëkohorë për sigurinë transnacionale, kushtëzojnë edhe organizime të reja menaxheriale dhe zbatimin e standardeve më të larta profesionale, të cilat janë të domosdoshme për përcjelljen e vazhdueshme dhe orientimin e rrjedhës së hulumtimeve informative.

Një qasje sistemore në vështirimin e marrëdhënieve interaktive në nivel të shërbimit dhe të niveleve më të ulëta të hierarkisë (sektorëve, njësive, reparteve, etj.) në nivel analitik funksional, praktik e operativ e komunikativ, me theks të veçantë që në rast të pengesave dhe vështirësive të natyrave dhe karaktereve të ndryshme të eliminohen në mënyrë efikase problemet në operacionalizimin e detyrave të planifikuara. Kjo mund të bëhet vetëm duke shfrytëzuar njohuritë dhe metodat shkencore e profesionale. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet një informim më i mirë, më efikas dhe më depërtues, duke shfrytëzuar në mënyrë racionale resurset e shërbimit.

Veprimi në këtë fushë pa përcaktimin paraprak të objektivave realiste dhe të realizueshme, me sublimimin e të gjitha premisave tjera, pa dyshim, shkakton probleme të shumta. Për këtë arsye, në strategjinë bashkëkohore të realizimit të objektivave dhe detyrave të planifikuara operative, prej të cilave burojnë edhe objektiva specifike konkrete dhe prioritete, është e domosdoshme një qasje ekzakte inter-disiplinare, me një metodologji të përcaktuar të grumbullimit të të dhënave. Në këtë pikëpamje, përgjegjësi të plotë kanë udhëheqësit e sektorëve për grumbullimin e të dhënave. Na këtë rrafsh duhet të vijmë në shprehje aftësitë menaxheriale dhe specializimet e veçanta për këto punë. Çdo sektor ka fushën e vet të veprimit, për çka është i nevojshëm një specializim përkatës. Kjo nxjerr në pah nevojën e perfeksionimit intensiv për aplikimin e njohurive dhe praktikave shkencore e profesionale. Kështu sigurohet funksionaliteti dhe operativiteti dhe efikasiteti i nevojshëm i çdo pjesëtari të shërbimit në realizimin e objektivave konkrete strategjiko-operative.

Por, “pavarësia” e përmendur funksionale-operative në punën e sektorëve, njësive, reparteve, etj., nuk guxon të vë në pikëpyetje koordinimin e nevojshëm në të gjitha

nivelet e udhëheqjes, duke pasur parasysh sistemin e centralizuar të udhëheqjes në punën e policisë kriminalistike, e cila është pjesë e sistemit policor në tërësi.

#### **6.4. Përcaktuesit relevantë të veprimtarisë kriminalistiko-informative**

Në të gjitha organet e shërbimit të sigurisë, pra edhe në strukturat e policisë, veprimtaria operative përbën bazën e veprimit të tyre. Kështu, në bazë të të dhënave të grumbulluara në praktikën e përditshme, të cilat i dorëzohen shërbimit policor, krijohet hapësira për hulumtime të formave të përshtatshme të veprimit dhe gjetjes së zgjidhjeve më optimale për realizimin e problemeve operative. Pa shpejtësinë, saktësinë dhe efikasitetin e nevojshëm të grumbullimit të të dhënave, si edhe pa grumbullimin me kohë të tyre, ato e humbin çdo vlerë operative apo vlerë tjetër. Prandaj, pa komponentë të zhvilluar operative nuk ka garanci për aktivitet të planifikuar në të gjitha nivelet e hierarkisë, nuk ka disiplinë të nevojshme operative për shfrytëzimin e njohurive, metodave dhe mjeteve më të reja, dhe as pasqyrë të situatës operative, e cila shërben si bazë për vlerësim cilësor e të saktë të veprimeve të deritashme operative, me të gjitha aspektet që mund të ndikojnë në hulumtimet e mëtejshme kriminalistiko-informative. Në rast të mungesës së operativitetit në funksionimin e kësaj pjese të shërbimit, nxirret përfundimi se asaj i mungon komponenta e organizimit, udhëheqjes, profesionalizmit, specializimit dhe edukimit permanent shkencor e profesional. Kjo e shndërron sektorin e hulumtimeve kriminalistiko-informative në një aparat inert, joinventiv, jokreativ dhe burokratik, me botëkuptim shumë të ngushtë, të kufizuar dhe të njëanshëm për rëndësinë e operativitetit.

Në përcaktimin e fushë-veprimit të njësive të hulumtimeve kriminalistiko-informative rol i veçantë i kushtohet shfrytëzimit të mjeteve më bashkëkohore teknike, sepse zhvillimi i teknologjisë informative kërkon që veprimi konkret operativ të bazohet në postullatet shkencore e profesionale ekzakte. Vetëm në bazë të kësaj mund të bëhet orientimi adekuat i aktiviteteve sipas obligimeve të punës dhe niveleve të ndryshme hierarkike.

Për këtë arsye, korrelacioni i zhvillimit të fushave të ndryshme të të arriturave shkencore bashkëkohore nënkupton dhe krijimin dhe përshtatjen me kohë të forcave, metodave dhe mjeteve të punës. Thënë më qartë, në kushtet bashkëkohore nuk mund të arrihen rezultate optimale me mënyra të vjetra, tradicionale e të klishezizuara të veprimit. Prandaj, pa njohjen e të arriturave më bashkëkohore shkencore, teknike e informatike dhe të premisave tjera relevante, asnjë shërbim nuk mund të përmbushë obligimet e veta dhe kjo manifestohet gjithsesi në sigurinë

e shtetit. Pra, në qoftë se shërbimet e përmendura janë të specializuara, profesionale, të pajisura teknikisht, me udhëheqje përkatëse dhe me elemente të tjera relevante për kryerjen e detyrave të tyre, ato mund të realizojnë objektivat e planifikuara.

Për këtë arsye, në policinë kriminalistike sot zbatohen modele të tilla organizative, të cilat mund të përballen me të gjitha sfidat që mund të shkaktojnë jostabilitet në disa segmente të shoqërisë. Mirëpo, specializimi nuk është i mjaftueshëm, në qoftë se nuk ka kuadër përkatës që do të drejtojnë të gjitha aktivitetet në mënyrë shumë profesionale, operative e profesionale, për të arritur rezultatet e nevojshme të hulumtimeve informative sa më shpejt dhe në mënyrë sa më racionale. Në këtë kuptim mund të flitet edhe për nacionalitetin në aspektin e angazhimit të forcave dhe mjeteve. Ndarja e specializuar e punës, bashkë me tiparet tjera (profesionalizmi, përvoja, operativiteti, vlerat morale) dhe me korrigjimet e nevojshme shkencore e profesionale gjatë hulumtimeve operative, rezultojnë me kualitet të lartë të të dhënave dhe informacioneve të grumbulluara. Por, edhe specializimi ka kufizimet e vete, prandaj duhet t'i kushtohet rëndësi, kështu që në kushtet e specializimit të lartë në fusha të ngushta të veprimit konkret duhet të vijë në shprehje postullati fundamental mbi respektimin e të drejtave themelore dhe lirive të qytetarëve.

Ndonjëherë, specializimet e ngushta mund të shpien deri te tejkalimi i autorizimeve dhe deformimi i sjelljeve, gjë që ndikon në komponentin operative dhe në punën e përgjithshme. Kjo manifestohet sidomos gjatë veprimit praktik, kur shfaqen probleme jashtë kornizës së specializimit të ngushtë, prej zgjidhjeve të të cilave varet puna e mëtejme në këtë fushë. Zgjidhja e çështjeve të rëndësishme përcjellëse kërkon arsimim shumë më të gjerë sesa specializimi i ngushtë për një fushë. Zbatimin e strategjisë për kryerjen e aktiviteteve konkrete kriminalistiko-informative, nuk guxon ta vë në pikëpyetje asnjë shpërputhje me objektivat e përcaktuara globale. Për këtë arsye kuadrot e specializuara duhet t'i shfrytëzojnë njohuritë e tyre profesionale dhe operative, në mënyrë adekuate. Në qoftë se bëhet fjalë për hulumtime komplekse është e nevojshme që kuadri të ketë përgatitje shumë më të lartë profesionale dhe përvojë për zbatimin e detyrave të caktuara. Përvoja e përmendur funksionale, sistematike dhe specialistike orientohet në realizimin e aktiviteteve të planifikuara informative. Në qoftë se bëhet fjalë për hulumtime informative që konsiderohen si komplekse, delikate dhe të përgjegjësishë së lartë, që do të thotë se duhet të përcaktohen objektivat përmbajtjesore të faktorëve orientues për arritjen e rezultateve optimale, është shumë më i nevojshëm kuadri i subspecializuar profesional, sidomos i atyre që i udhëheqin operacionet.

Me zhvillimin e shoqërisë bashkëkohore në tërësi, shfaqet gjithnjë e më shumë nevoja për transformim dhe për aplikimin e përmbajtjeve kreative si dhe metodave bashkëkohore në punën e shërbimit kriminalistik. Qasja kreative bën të mundur që në një atmosferë shumë profesionale operative të planifikohen me sukses detyrat operativo-taktike me hulumtimin dhe vështtrimin e gjithanshëm të varësisë reciproke. Këtu përfshihen analizat ekzakte të situatës së sigurisë dhe vlerësimet e shkallës së rrezikshmërisë, sidomos zhvillimi i dinamikës së hulumtimeve informative në të gjitha nivelet e strukturës organizative. Duke shfrytëzuar të arriturat e disiplinave të tjera shkencore krijohen mundësi që punëtorët e operativës të njihen me metodat dhe teknikat bashkëkohore të hulumtimit informativ dhe të aplikohen parimet e metodologjisë bashkëkohore të udhëheqjes në situata të ndryshme. Në bazë të kriterëve ekzakte shkencore e profesionale bëhet perfeksionimi i punës së pjesëtarëve të strukturës organizative, ndërsa nëpërmjet aktiviteteve konkrete gjenden zgjidhjet më optimale, sidomos kur bëhet fjalë për orientimin operativo-teknik dhe taktiko-metodologjik të veprimit. Në këtë kuptim, detyrë imperative del koncepti i modelit bashkëkohor të veprimtarisë kriminalistiko-informative, shprehja e iniciativave dhe propozimeve kreative e profesionale dhe komunikimi reciprok. Kështu krijohen mundësi për vlerësime dhe analiza kritike permanente të organizimit të vendosjes së strukturës organizative kriminalistiko-informative. Kjo nënkupton vlerësimin se a është organizuar kjo strukturë në mënyrën më racionale, më praktike dhe a është organizuar në përshtatje me të gjitha rrethanat e sigurisë, në dritën e ndryshimeve të reja shoqërore.

Punëtorët e operativës që janë të ngarkuar në punën e analitikës, kanë rol të rëndësishëm në ciklin kriminalistiko-informativ. Ata janë të ngarkuar me grumbullimin seleksionimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave të dorëzuara nga organi operativ. Këtu bëhet fjalë ëpr detyra shumë delikate dhe me përgjegjësi të lartë. Për këtë arsye edhe në shërbimet analitike duhet të punojnë kuadrat më të përgatitura të cilat kanë edhe njohuri të mëdha praktike. Për ruajtjen e kontinuitetit dhe intensitetit përkatës në punën e policisë kriminalistike kuadri profesional angazhohet për punë të planifikuar, ofensive dhe ekipore dhe për zbatimin me sukses të masave operativo-analitike. Kjo ndihmon që nga maja e piramidës udhëheqëse të orientohen dhe të përcillen aktivitete e planifikuara operative. Por, duhet të theksohet se vetëm të dhënat dhe informacionet e verifikuara dhe cilësore operative mund të shërbejnë si fundament për përpunim e llojeve të ndryshme të dokumenteve sintetizuese si dhe për udhëheqjen e punës në përpunimin kriminalistik dhe në revidimin eventual të vlerësimeve ekzistuese. Për këtë arsye, çdo e dhënë informative e hulumtimeve informative i nënshtrohet një vlerësimi dhe verifikimi të rreptë dhe të shumëfishtë. Prandaj, këtu duhet të shprehet aftësia e analistëve që në bazë të njohurive shkencore, profesionale dhe operative dhe të

praktikave më të avancuara të analizohen dhe studiohen të gjitha të dhënat, në mënyrë që të bëhet vlerësimi i drejtë i rëndësisë së tyre dhe i shfrytëzimit të tyre në aktivitetet e ardhshme të sektorit apo njësisë për hulumtime kriminalistiko-informative. Hulumtimi informativo-kriminalistik në fusha të ndryshme është një orientim shumë specifik. Nëpërmjet zbatimit të metodave dhe mjeteve adekuate në kuadrin e planit të përcaktuar të hulumtimit informativ, duhet të manifestohen elementet operativo-hevioristike.

Kjo mënyrë specifike e grumbullimit të të dhënave dhe informacioneve në pajtim me planin e përcaktuar dhe verifikuar të hulumtimeve kontribuon në hulumtimin preciz të atyre fushave që zënë vend qendror në punën e policisë kriminalistike. Mirëpo, duhet të theksohet se studimit të metodave të veprimit kriminalistiko-informativ nuk i është kushtuar rëndësia e nevojshme. Pasojë e kësaj është efikasiteti i pamjaftueshëm operativ. Format ekzistuese të grumbullimit të të dhënave gjatë operacioneve informative dhe mungesa e qasjes sistemore ndaj analizës, përpunimit dhe vlerësimit të vërtetësisë së tyre ka shkaktuar zbrazëti në punën shkencore e profesionale. Mënyrë dhe rrugë e vetme për eliminimin e të gjitha këtyre mangësive është simbioza specifike shkencore e profesionale, njohuritë praktike operative, zbatimi i mënyrave të besueshme të verifikimit të ciklit informativ dhe vlerësimi i të dhënave të grumbulluara. Këtu nuk guxon të gabohet sepse çdo gabim, sidomos kur bëhet fjalë për detyra komplekse informative, mund të ketë implikime të mëdha negative. Për këtë arsye studimi i metodave në kushtet e sotme, në të gjitha sfidat e sigurisë është domosdoshmëri, nëse synohet të arrihen rezultatet e kërkuara gjatë veprimit kriminalistiko-informativ.

Pra, njohja e themeltë e përmbajtjeve dhe metodave shkencore që kanë të bëjnë me lëndën e hulumtimeve informative është parakusht themelor për qasje sistematike dhe për analizë dhe përpunim të të dhënave relevante. Për shkak të fushës specifike të hulumtimit të informacioneve ekzistojnë edhe qasje të ndryshme hulumtuese dhe mjete të ndryshme hulumtuese teknike. Kjo kërkon edhe integrimin e nevojshëm të të gjitha metodave që kanë karakteristika të përbashkëta, të cilat i bëjnë ato komplekse në kuptimin hulumtues specifik. Procesi i lidhjes midis metodave nuk mund të zhvillohet ad hoc, në mënyrë spontane apo stihike. Kjo është metodë shumë e rëndësishme metodologjike, prej së cilës varet shumë suksesi i hulumtimeve kriminalistiko-informative. Ky parim duhet të jetë në funksion në të gjitha fazat e hulumtimit, por mund të realizohet vetëm nëse personeli ka njohuri shkencore e teorike për lëndën e hulumtimit informativ, mbi veprimet ideologjike dhe burimet ekzistuese të të dhënave mbi problemin e caktuar, i cili është objekti i punës informative të policisë kriminalistike.

## **PËRMBAJTJA:**

1.	POLITIKA E SIGURISË DHE STRATEGJIA E SIGURISË.....
1.1.	POLITIKA E SIGURISË.....
1.2.	STRATEGJIA E SIGURISË.....
1.3.	METODAT DHE MJETET E STRATEGJISË SË SIGURISË..
2.	ZHVILLIMI I STRATEGJISË SHOQËRORE TË KUNDËR-VËNIES NDAJ KRIMINALITETIT.....
3.	STRATEGJIA KRIMINALISTIKE.....
3.1.	Nocioni, metodat dhe mjetet e strategjisë kriminalistike.....
3.2.	Analitika kriminalistike si parakusht për efikasitetin e strategjisë kriminalistike.....
3.3.	Planifikimi operativo-strategjik si segment i strategjisë kriminalistike.....
3.4.	Kontrolli kriminalistik si segment i veprimit kriminalistiko-strategjik.....
4.	STRATEGJIA KRIMINALISTIKE DHE SHKENCAT TJERA ANALITIKE TË SIGURISË.....
5.	PLANIFIKIMI STRATEGJIK I MARRËDHËNIEVE TË POLICISË ME „RRETHINËN“.....
5.1.	Planifikimi strategjik i marrëdhënieve të policisë me publikun.....
5.2.	Disa çështje të hapura të marrëdhënieve të policisë me publikun.....

5.3. Çlirimi nga marrëdhëniet tradicionale dhe nevoja për krijimin e marrëdhënieve të reja.....	
5.4. Doktrina dhe strategjia e veprimit të policisë në funksion të publikut.....	
5.5. Ndikimi i publikut në hartimin e programit të përbashkët social-preventiv në bashkësinë lokale.....	
5.6. Puna demokratike e policisë si parakusht për afirmimin dhe autoritetin e saj në publik.....	
5.7. Marrëdhëniet strategjike të policisë dhe mjeteve të komunikimit publik.....	
5.8. Rëndësia e marrëdhënieve midis policisë dhe mediave.....	
5.9. Konfliktet ndërmjet policisë dhe mediave.....	
5.10. Vështrim kritik në marrëdhëniet konfliktuale midis policisë dhe mediave.....	
5.11. Arsyet e sigurisë për hartimin e strategjisë së re të marrëdhënieve midis policisë dhe mediave.....	
5.12. Policia e re e marrëdhënieve midis policisë dhe mediave.....	
5.13. Organizimi i punës me media.....	
5.14. Orientimet themelore për punë me përfaqësues të mediave.....	
6. TRENDET E REJA TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE SFIDAT BASHKËKOHORE TË SIGURISË.....	
6.1. Veprimtaria kriminalistiko-informative në funksion të luftës më efektive kundër krimit të organizuar.....	
6.2. Krijimi i planit konceptual në fushën kriminalistiko-informative.....	
6.3. Hartimi i planeve operative.....	
6.4. Përcaktimet themelore të veprimtarisë kriminalistiko-informative.....	

## LITETARTURA

- Dvoršek, A., (2001), Kriminalistička strtegija, Zbornik radova, I Dani kriminalističkih nauka, FKN, Sarajevo
- Horvatić, Ž., Cvitanović, L., (1999), Politika suzbijanja kriminaliteta, MUP RH, Zagreb
- Krivokapić, V., (2006), Prevencija kriminaliteta, FKN, Sarajevo
- Masleša, R., (2004), Organizaciono-funkcionalno prilagođavanje policijskih struktura savremenim sigurnosnim izazovima, Dnevi varstvoslovlja, FPVV, Ljubljana
- Masleša, R., (1999), Policija - organizacija i funkcioniranje u demokratskom društvu, FKN, Sarajevo
- Masleša, R., (2002), Teorije i sistemi sigurnosti, Magistrat, Sarajevo
- Masleša, R., (2004), Kriminalističko-obavještajna djelatnost u finkciji efikasnije borbe protiv organiziranog kriminaliteta, Zbornik radova, Pravni fakultet Niš i VŠUP Beograd, VŠUP, Beograd
- Meško, G., (2002), Preprečavanje kriminalitete, FPVV, Ljubljana
- Modly, D., Korajlić, N., (2004), Kriminalistički rječnik, Planjax, Tešanj
- Muratbegović, E., (2003), Magistarski rad: „Policija u prevenciji kriminaliteta – studija slučaja Kanton Sarajevo“, FKN, Sarajevo
- Stojanović, Z., (1991), Politika suzbijanja kriminiliteta, Pravni fakultet Novi Sad, Novi Sad